

**TAKVIM
1445-1446**

**KALENDAR
2024**

Boton:

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182

Tel & fax: 038 / 224-001

www.bislame.net

e-mail: takvimi@hotmail.com

Për botuesin:

Myftiu, Naim ef. Tërnavë

Kryeredaktor:

Ahmet Sadriu

Redaksia:

Resul Rexhepi

Sabri Bajgora

Ramadan Shkodra

Lektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor teknik & kopertina

Nuhi Simnica

Shtypi:

"Printing press" - Prishtinë

© Copyright:

Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.

Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

**TAKVIM
1445-1446**

**KALENDAR
2024**

Prishtinë



Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

NË VEND TË PARATHËNIES

Falënderimet, lëvdatat dhe madhështia janë vetëm për Allahun, Krijuesin e botëve. Vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje. Ai është Një dhe tjetër nuk ka. Ai është i Cili na u drejtua në librin e Tij me porosinë për lexim.

Salavatet dhe selamet qofshin mbi Muhamed Mustafanë, i cili gjithashtu nxiti për lexim dhe dituri. Përshëndetjet tona shkojnë edhe për familjen e tij të pastër, shokët e tij besnikë dhe mbi të gjithë ata, të cilët e ndoqën dhe do ta ndjekin rrugën e tij deri në ditën e fundit.

Të nderuar lexues,

Revista “Takvimi” po vazhdon me misionin e saj për të cilin është nisur që nga themelimi, duke dhënë kështu mesazhin te çdo besimtar, pa marrë parasysh peripecitë dhe vështirësitë, të cilat kohë pas kohe paraqiten në rrugëtimin e saj. Falë angazhimit të palodhshëm të redaksisë dhe bashkëpunëtorëve, edhe këtë vit kemi arritur që lexuesit t’ia ofrojmë revistën tonë, ku si zakonisht, përveç pjesës kalendarike, kemi përmbledhur një mori temash nga lëmi i fesë, shkencës, historisë dhe kulturës sonë fetare dhe shpirtërore.

Derisa ne kemi hyrë në dekadën e shtatë të botimit të “Takvimit”, dihet mirëfilli se kjo revistë ka bërë emrin dhe historinë e saj duke depërtuar te çdo familje myslimane, kur

dihet mirëfilli se është një nga revistat e para islame në gjuhën shqipe. “Takvimi” si i tillë, përveç se na ofron kalendarin e kohëve të namazit dhe festave fetare, në të, gjithherë janë trajtuar edhe tematika fetare, dhe si i tillë ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e besimtarëve myslimanë në Kosovë e më gjerë. “Takvimi” ka qenë një dritare e rëndësishme e përhapjes së mësimave fetare te ne.

Nëse i hedhim një shikim revistës “Takvimi”, që nga dalja e saj e deri më sot, temat të cilat janë trajtuar në të, janë të një rëndësie të veçantë, filluar nga ato më elementaret, baziket e fesë islame, siç janë: akaidi, tefsiri, hadithi-suneti, fikhu, etika islame, kultura islame, trashëgimia, historia dhe fusha të tjera.

Numrin e këtij viti e kemi filluar me dy tema të njëpasnjëshme nga lëmi i akaidit, nga dy autorë tanë, njohës të mirë të kësaj fushe, myftiu Naim Tërnavë dhe hoxha ynë shumë i respektuar, rahmetliu, myderrizi, haxhi Sherif Ahmetit. Tema e myftiut ka të bëjë me lirinë e besimit. Mundësia e njeriut që i vetëm ta gjejë të vërtetën e të drejtën, si në besim ashtu edhe në adhurim, pa ndihmën e shpalljes, nuk është reale, për shkak të kufizimeve në kapacitetin intelektual që posedon njeriu. Për të ardhur deri tek e vërteta, Zoti, xh.sh., e ndihmoi njeriun me pejgamberë dhe me shpallje, pejgamberë të cilët u dërguan te të gjithë popujt, për të dhënë mesazhe dhe porosi të qarta. Mohimi shpeshherë është rezultat i arrogancës, i kryeneçsisë, i inatit dhe i refuzimit të fakteve e të dëshmimeve. Mohim konsiderohet edhe besimi i pjesshëm, kjo sepse patjetër duhet besuar tërësisht, se ndryshe besimi nuk vlen. Kurse tema në vijim nga hoxha ynë shumë i respektuar, Sherif Ahmeti, shtjellon domethënien e fjalës “Itaat”, që në gjuhën tonë do të thotë, të respektosh, të dëgjosh dhe t’i përgjigjesh.

Pra, fjala është për respekt dhe përgjigje thirrjes së të Dërguarit të Zotit xh.sh..

Tema në vazhdim trajton çështjen e lënies së vakëfit, si duhet të trajtohet dhe a lejohet tjetërsimi i tij, duke i ofruar kështu dispozitat rreth kësaj problematike, të cilën na e sjell profesori i nderuar, Resul Rexhepi.

Kadaja dhe Kaderi është tema në vazhdim, të cilën na sjell profesori i nderuar Ajni Sinani, domethënien e tyre dhe çka nënkuptojmë me to, për çka besoj se lexuesi do të ketë mundësi të përfitojë shumë. Se çfarë ndikimi ka feja në formimin shpirtëror, e gjejmë në shkrimin e autorit dhe dijetarit shqiptar me famë botërore, Vehbi Sylejman Gavoçi, me origjinë nga Shkodra, të përkthyer nga Ekrem Simnica. Në vazhdim, Orhan ef. Bislimaj, trajton hadithin e Resulullahut mbi përkohshmërinë e të jetuarit në këtë botë. Besoj se kjo thënie e Resulullahut na jep shumëçka të kuptojmë, arsyen e ardhjes sonë në këtë botë, misionin, si dhe sa është e përkohshme kjo jetë. Ramadan Shkodra këtë herë na vjen me një temë rreth manifestimit të mevludit te ne, ku përveç përkujtimit të figurës së Pejgamberit a.s. dhe misionit të tij, me këtë manifestojmë dashuri, zotim dhe besatim për rrugën e tij. Në vazhdim kemi lutjet që Muhamedi a.s. ia drejtoi Krijuesit të Gjithësisë për ymetin e tij, në të cilat përshkruhen lidhjet emocionale të Profetit a.s. me ymetin. Nga kjo mund të konstatojmë se dashuria e Profetit a.s. dhe lidhja e tij me pasuesit janë të veçanta. Ai ka dhënë nga vetja çdo gjë dhe ka sakrifikuar me çdo gjë, madje edhe me gjërat më ekskluzive, vetëm e vetëm për të mirën e ymetit. Tema e radhës ka të bëjë me format dhe veçoritë e mesazhit dhe ligjërimit fetar drejtuar auditoriumit në kohën e sotme, të cilën na e sjell Rexhep Suma. Husein Gjozo, është një prej dijetarëve më eminent të Is-

lamit në shekullin e kaluar në trojet e ish-Jugosllavisë, i cili ka lënë shumë shkrime dhe vepra, të cilat janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe të cilat kanë pasur ndikim pozitiv te besimtarët e besimit islam. Më gjerësisht rreth personalitetit të tij dhe prezencës së tij në shtypin tonë, e gjejmë në shkrimin, të cilin në këtë numër na e sjell Azmir Jusufi. Dhe krejt në fund, këtë numër e përmbylлим me jetën dhe krijimtarinë letrare të një prej figurave shumë të njohura me origjinë shqiptare, i cili jetoi dhe veproi në Turqi, e i cili njihet edhe si autor i himnit të shtetit turk, Mehmet Akif Ersoji, të cilin na e sjell Besir Neziri.

Redaksia e “Takvimit” jo domosdoshmërisht pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që boton.

Lexues të nderuar, me këtë rast po ua rikujtojmë se revista “Takvimi”, në brendinë e saj, përmban ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., prandaj luteni që gjatë përdorimit të tij, të keni kujdes.

Dhe krejt në fund, e lusim Fuqiplotin të na ndihmojë që amanetin ta kryejmë me përgjegjësinë më të lartë, të na i falë gabimet dhe jemi nën mbrojtjen e Tij përgjithmonë!

Vetëm me ndihmën e Allahut arrihen qëllimet dhe ia dilet mbanë.

و الحمد لله على نعمته العظيم

Vel hamdulil-lahi ala niametihî el adhijm.

*Prishtinë,
dhjetor 2023*

Ahmet Sadriu

Naim ef. TËRNAVA

LIRIA E BESIMIT

Kapacitetet e kufizuara të njeriut që si i vetëm ta gjejë të vërtetën

Allahu, xh.sh., e veçoi njeriun prej krijesave të tjera duke ia dhuruar mendjen dhe veçoritë e tjera dalluese, përmes së cilave ia mundësoi edhe që ta arrijë atë që nuk kanë mundësi për të arritur krijesat e tjera, në raport me organizimin e jetës dhe përkushtimin në besim dhe adhurim të Zotit Një të Vetëm, Krijuesit të kësaj gjithësie.

Shumë herë kemi thënë se mendja e njeriut është e kufizuar, e për këtë arsye edhe njohuritë e tij janë të kufizuara. Edhe arritjet e njeriut, përkundër se janë të mëdha dhe mbresëlënëse, dhe të cilat gjithsesi se duhen vlerësuar e pasur në konsideratë, megjithatë janë të kufizuara. Po ashtu, edhe çdo gjë që e posedon njeriu në veten e tij është e kufizuar dhe ka nevojë për ndihmë në raport me qëllimin që njeriu synon ta arrijë.

Të gjitha veçoritë (cilësitë) e njeriut janë të kufizuara, siç janë: shikimi, dëgjimi, fuqia, dëshira, vullneti, jeta e kështu me radhë.

Mendja e njeriut, e cila edhe e veçon njeriun prej gjallesave të tjera, është për t'u respektuar për përpjekjet e vazhdueshme në zbulimin e fshehtësive të kësaj bote dhe shpikjet për lehtësimin e jetës së njeriut, pra që njeriu të jetojë sa më në re-

hati dhe sa më mirë. Megjithatë, horizonti i studimit është i kufizuar, edhe pse në sytë tanë njeriu në këtë kohë vetëm se e ka arritur atë që nuk e ka ëndërruar ta arrijë në të kaluarën e afërt. Sot jemi dëshmitarë të zbulimeve të njëpasnjëshme që bëjnë njerëzit, dëshmitarë të studimeve në hapësirë, përpjekje e rezultate që trokasin në rizgjimin e mëtutjeshëm të ndërgjegjes së njeriut në raport me Krijuesin, që patjetër të arrihet deri tek ajo që urdhëron Kurani. Dhe, kështu duhet të vazhdohet derisa mendja të lirohet nga iluzioni, nga epshi, nga humbja, e ta dijë atë për çfarë asnjëherë nuk ka pasur dije, dhe përmes saj të triumfojë ndaj të keqes, ndaj epsheve, ndaj çdo gjëje që njeriun e largon nga qëllimi i ardhjes së tij në këtë jetë.

Zoti, xh.sh., e udhëzoi dhe e begatoi babanë e njerëzimit, Ademin, a.s., kur atë e krijoi nga toka dhe i mundësoi ta organizojë jetën në Tokë, ta zbukurojë atë dhe të jetë në vazhdimësi me urdhrat dhe adhurimin ndaj Tij. Ai që nuk dëgjon dhe nuk i përfill këto urdhra të Allahut, xh.sh., këto shpallje të dërguara prej Tij, i tilli do të jetë në humbje.

Mohimi si reflektim i dobësimit shpirtëror, jo i fakteve

Pjesa më e madhe e njerëzve, të prirë nga egoja dhe të mishëruar me intrigat e shejtanit, megjithatë e refuzuan dhe nuk e besuan Tevratin, Inxhilin, Zeburin, dhe njësoj gjer më sot vazhdon historia edhe me Kuranin, si fjalë të Zotit, xh.sh. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿ وَمَا قَدَرُوا اللَّهَ حَقَّ قَدْرِهِ إِذْ قَالُوا مَا أَنْزَلَ اللَّهُ عَلَيَّ بَشَرًا مِّنْ شَيْءٍ ۚ قُلْ مَنْ أَنْزَلَ الْكِتَابَ الَّذِي جَاءَ بِهِ مُوسَىٰ نُورًا وَهُدًى

لِّلنَّاسِ ۚ تَجْعَلُونَهُ قَرَاطِيسَ تُبْدُونَهَا وَتُخْفُونَ كَثِيرًا ۖ وَعَلَّمْتُمْ مَا لَمْ
تَعْلَمُوا أَنْتُمْ وَلَا آبَاؤُكُمْ ۚ قُلِ اللَّهُ ۖ ثُمَّ ذَرْهُمْ فِي خَوْضِهِمْ يَلْعَبُونَ ﴿٩١﴾
“Ata (mohuesit) nuk e njohën Allahun sa duhet njohur
Atë kur thanë: “Allahu nuk i shpalli gjë asnjë njeriu.”
Thuaj: “Kush e zbriti librin me të cilin erdhi Musai, e
që ishte dritë e udhërrëfytes për njerëz, e të cilin ju e
bëni të shpërndarë në letra, që disa i prezantoni kurse
shumicën i fshihni?! Dhe u mësuat çka nuk e dinit ju
e as prindërit tuaj?!” Thuaj: “Allahu (e zbriti).” Ma-
ndej lëri ata që luajnë në atë kotësinë e tyre!” (Enamë:
91)

S’ka dyshim se Kurani është begati për mbarë botën, ngase Allahu, xh.sh., na e bën me dije se Kurani dhe Muhamedi, a.s., ishin dërguar mëshirë për mbarë njerëzimin, përkundër asaj që mohuesit e Zotit Një e refuzojnë këtë qasje.

Me këtë ajet dhe të ngjashëm si ky Allahu, xh.sh., na e bën me dije se mohuesit nuk e njohën dhe nuk e besuan Zotin Një, sa dhe si duhet. Ata e mohuan edhe dërgimin e pejgamberëve dhe zbritjen e librave të shpallur, si dhe i thoshin Muhamedit, a.s., se Zoti nuk i ka zbritur njeriut asgjë nga librat e shpallur. Pra, ndodhte ashtu siç po ndodh edhe sot, kur shumica e njerëzve i refuzojnë mësimet e Kuranit. Mirëpo Allahu, xh.sh., po e urdhëron Muhamedin, a.s., që t’u thotë atyre mohuesve, e me këtë ngjan sikur na drejtohet edhe ne sot, t’u themi mohuesve se, kush është Ai që e zbriti Tevratin te Musai, shpjeguesin dhe udhëzuesin për popujt ku u dërgua, duke urdhëruar në të mirë dhe duke urdhëruar për largim nga e keqja?! Pra, librin për të cilin ju (çifutë) nuk treguat kurrfarë respekti, sepse e shpërndatë në fletë, duke i

paraqitur disa e duke i fshehur disa, pastaj në atë që e lexonit duke paraqitur çka dëshironit vetë, pra, duke ndërhyrë dhe duke e devijuar dhe duke e fshehur atë që dëshironit ju nga fjala e Allahut, xh.sh.?!

Në fakt çifutët besuan dhe nuk e refuzuan Tevratin. Prandaj, tani me rastin e Kuranit, si është e mundshme që ata e refuzojnë Kuranin dhe të thonë se “Allahu nuk i shpalli gjë asnjë njeriu”, ndërsa e besuan shpalljen e Tevratit të Musai, a.s.?! Pra, si refuzojnë tash kur dihet se ata mësuan nga shpallja atë që nuk e dinin, as ata e as prindërit e tyre, për çështje të kësaj bote dhe për çështje që kanë të bëjnë me fenë?! Zoti, xh.sh., i thotë Muhamedit, a.s., që t’u drejtohet atyre e t’u thotë se “Allahu është Ai që e zbriti edhe Tevratin, edhe Kuranin.”¹

Kurani, ky libër përplot me begati për universin mbarë, e në veçanti për njeriun, me të mira pa kufi, i zbriti Muhamedit, a.s., duke mos bërë kurrfarë dallimi në shpallje me atë që ka zbritur apo që është shpallur më herët, siç qenë librat e shenjtë: Tevrat, Inxhili, Zeburi, apo edhe fletushkat.

Për këtë kemi edhe ajetin kuranor nga sureja Nisa:

﴿ إِنَّا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ كَمَا أَوْحَيْنَا إِلَى نُوحٍ وَالنَّبِيِّينَ مِنْ بَعْدِهِ ۗ

وَأَوْحَيْنَا إِلَى إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ

وَعِيسَىٰ وَأَيُّوبَ وَيُونُسَ وَهَارُونَ وَسُلَيْمَانَ ۗ وَآتَيْنَا دَاوُدَ زَبُورًا ۗ

“Ne të frymëzuar ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe pejgamberët pas tij; e patëm fry-

¹ Ebu Fadl Shihabudin Sejjid Mahmud el Alusi el Bagdadi, *Ruhul Meani*, (Dar El Fikr: p.v.b.), 4/218.

mëzuar Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit ia patëm dhënë Zeburin.” (Nisa: 163).

Zoti, xh.sh., ua bënë me dije ithtarëve të librave, përmes Muhamedit, a.s., pra në përgjithësi, se ata ishin që e bënë dallimin mes pejgamberëve, duke i besuar disa, dhe duke i mohuar disa. Kuran përkthyer qendrimet e çifutëve, ngase ata, bazuar në mendjemadhësinë dhe zilinë e tyre të madhe, i thoshin Muhamedit, a.s., që t'ua zbresë përnjëherë një libër nga qielli në mesin e tyre, libër prej Zotit, xh.sh., në mënyrë që ata të binden në atë që thërriste Muhamedi, a.s. Zilia dhe mendjemadhësia e çifutëve nuk ishte diçka e re. Ata edhe më herët kishin pasur kërkesa dhe pyetje të tilla, të cilat i kishin bërë edhe para Musait, a.s. Ata bënë vepra të liga dhe e mohuan edhe Isain, a.s., të cilin, për më tepër edhe u munduan ta vrisnin.²

Muhamedit, a.s., iu shpall revelata sikurse edhe pejgamberëve të tjerë para tij. Allahu, xh.sh., në Kuran na bën me dije se e frymëzoi me shpallje edhe Muhamedin, a.s., si pejgamber i fundit. Në Kuran është përmbledhur çdo gjë. Kuran është libër që përfshin përmbajtjen në vija të trasha të tërë shpalljeve, nisur prej Ademit, a.s. Kjo sepse edhe ata që ishin para Muhamedit, a.s., u frymëzuan po nga i njëjti burim, përmes engjëllit Xhibril. Allahu, xh.sh., ashtu siç e frymëzoi Nuhun, Ibrahimin, Imailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, Davudin, të

² Muhamed Mahmud Hixhazi, *Et tefsir el vadih*, (Kajro; Universiteti i Az'harit, b. 9, 1978), f. 87.

cilit edhe ia zbriti librin Zeburin, po ashtu e frymëzoi edhe Muhamedin, a.s. Allahu, xh.sh. thotë në Kuranin fisnik në shenjë të Isait, a.s.:

﴿ثُمَّ قَفَّيْنَا عَلَىٰ آثَارِهِم بِرُسُلِنَا وَقَفَّيْنَا بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ وَآتَيْنَاهُ
الْإِنْجِيلَ وَجَعَلْنَا فِي قُلُوبِ الَّذِينَ اتَّبَعُوهُ رَأْفَةً وَرَحْمَةً وَرَهَابَنِيَّةً
ابْتَدَعُوهَا﴾

“Pastaj vazhduam pas tyre me të dërguarit Tanë, e pas tyre e dërguam Isain, të birin e Merjemes, dhe atij ia dhamë Inxhilin, e në zemrat e ithtarëve të tij dhuruam butësi e mëshirë, ndërsa murgërinë e shpikën ata vetë...” (Hadid: 27)

I zgjedhuri i fundit për pejgamber nga mesi i beni Israilëve ishte Isai, a.s., i cili lajmëroi edhe për ardhjen e Muhamedit, a.s., pas tij si pejgamber. Allahu, xh.sh., ia shpalli Inxhilin Isait, a.s., dhe në zemrat e ithtarëve të tij dhuroi butësi e mëshirë, e këta ishin *havarijunët* - apostujt, të cilët e kishin frikë Zotin, xh.sh., dhe ishin të mëshirshëm e me moral të lartë.³

As Musai, a.s., nuk ishte pejgamberi i fundit të cilit iu shpall libër prej Zotit, xh.sh., libër i shenjtë, siç pretendojnë hebrenjtë. Shpallja e Allahut, xh.sh., vazhdoi edhe pas tij, te pejgamberët e tjerë me radhë, ngase shumë popuj kishin devijuar nga ajo që kishte zbritur e urdhëronte Tevrati. Allahu, xh.sh., e dërgoi Isain, a.s., për pejgamber të parafundit, duke ia dhuruar (shpallur) edhe librin e shenjtë, Inxhilin, i cili kishte të njëjtin qëllim sikurse Tevrati: që njerëzit të largohe-

³ *Tefsir El Kurani*l adhim të Ibën Kethirit, botuar në Bejrut, 1969, f. 314.

shin nga besimet e kota dhe ta besonin Zotin Një, duke u përkushtuar në tërë atë që Allahu, xh.sh., ka zbritur (shpallur) brenda librave të shenjtë. Për këtë na mëson edhe Kurani, përmes ajetit kuranor që e përmendëm më lart.

Isai, a.s., biri i Merjemes, u zgjodh peygamber i parafundit, dhe atij iu shpall libër i shenjtë, iu shpall Inxhili, që kishte po të njëjtin qëllim që kishin edhe shpalljet e mëhershme te peygamberët e mëparshëm: thirrjen e popullit beni Israil për besim në Zotin Një dhe adhurim të Tij, si dhe zbatimin në praktikë të tërë asaj që ishte shpallur në Inxhil. Mirëpo, shumica e popullit nuk e dëgjoji dhe nuk e besoi atë për të cilën u dërgua Isai, a.s., pra, nuk besuan në shpalljen e Allahut, xh.sh., me përjashtim të një numri të vogël besimtarësh.

Në Inxhil Allahu, xh.sh., kishte lajmëruar edhe për ardhjen e të dërguarit të fundit, Muhamedit, a.s. E tërë shoqëria njerëzore, përafërsisht për gjashtë shekuj, po priste momentin se kur do të vinte peygamberi i premtuar prej Isait, a.s., dhe të merrnin fund edhe shumë padrejtësi. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿ تَبَارَكَ الَّذِي نَزَّلَ الْفُرْقَانَ عَلَىٰ عَبْدِهِ لِيَكُونَ لِلْعَالَمِينَ نَذِيرًا ﴾

“I Madhëruar qoftë Ai që ia shpalli Furkanin (Kurandin, dalluesin e të vërtetës nga e pavërteta) robit të vet (Muhamedit) që të bëhet peygamber i botës (këshillueses)!” (Furkan: 1)

Kurani i vërteton shpalljet dhe librat e mëparshëm hyjnorë

Falënderimi gjithherë i takon Allahut, xh.sh. i Cili e zbriti Kuranin fisnik te njeriu më fisnik e më bujar, i cili jetoi dhe veproi me Kuran për sa ishte gjallë! Allahu, xh.sh., këtë libër ia shpalli pa asnjë të metë. Pra, në të nuk mund të ketë apo të gjendet ndonjëherë ndonjë mungesë, kontradiktë apo kundërthënie. Shpallja është e plotë dhe origjinaliteti i saj është ruajtur me saktësinë, vërtetësinë, qëndrueshmërinë dhe përhershmërinë më të madhe ashtu siç ka zbritur. Dhe pikërisht kjo e bën dallimin mes të vërtetës dhe të pavërtetës, udhëzimit dhe humbjes, asaj që sot gjendet në librat e shpallur dikur dhe asaj që sot gjendet në Kuran. Këtë Kuran Allahu, xh.sh., ia shpalli, siç thotë Ai “Robit të Vet”, duke e cilësuar dhe duke e nderuar Muhamedin, a.s., me këtë atribut, se ai ishte adhures i Allahut, xh.sh., dhe i zgjedhur i Tij i veçantë.

Allahu, xh.sh., e shpalli Kuranin si dallues i së mirës e i së vërtetës nga e pavërteta e gënjeshttra. Ai këtë ia shpalli robit të vet, Muhamedit, a.s., dhe e delegoi si shpallje për botën mbarë, pa dallim vendi, race apo gjuhe. Dhe, më e rëndësishmja, me këtë shpallje merr fund dërgimi i pejgamberëve, si dhe mbyllet dera e shpalljeve dhe e pejgamberisë. Allahu, xh.sh., thotë:

نَزَّلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَأَنْزَلَ التَّوْرَةَ
وَالْإِنْجِيلَ ﴿٣﴾ مِنْ قَبْلُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَأَنْزَلَ الْفُرْقَانَ ۗ إِنَّ الَّذِينَ
كَفَرُوا بِآيَاتِ اللَّهِ هُمْ عَدَابٌ شَدِيدٌ ۗ وَاللَّهُ عَزِيزٌ ذُو انتِقَامٍ ﴿٤﴾

*“Ai ta ka shpallur ty Librin me të vërtetën e saktë,
duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai e ka zbritur*

Tevratin dhe Inxhilin, udhërrëfim për njerëz; e zbriti edhe Furkanin (dalluesin e së vërtetës nga gënjeshtria). Ata që i mohojnë argumentet e Allahut s'ka dyshim se i pret ndëshkim i rreptë. Allahut është Ngadhënjyes, Shpagimtar!” (Ali Imran: 3-4).

Kurani me saktësinë e zbritjes vërteton çdo gjë që ka ndodhur më herët. Ai e vërteton edhe zbritjen e Tevratit dhe të Inxhilit, po edhe shpalljet e tjera.

Furkani (Kurani) është dalluesi i së mirës nga e keqja, i së vërtetës nga gënjeshtria e devijimi, si dhe udhëzuesi i vetëm i drejtë për besim në Zotin Një dhe adhurim të Tij. Të gjithë ata që në një apo mënyrën tjetër nuk e besojnë atë që i Madhi Zot, xh.sh., e ka zbritur (shpallur) te pejgamberët e tij, të tillët (jobesimtarët) do të ndëshkohen me ndëshkim të rëndë, kur në Ditën e Gjykimit do të dalin para Allahut, xh.sh., ngase ata i mohuan argumentet e zbritura prej Allahut, xh.sh. Allahu, xh.sh., thotë në Kurandin fisnik:

﴿ قُلْ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِجِبْرِيلَ فَإِنَّهُ نَزَّلَهُ عَلَىٰ قَلْبِكَ بِإِذْنِ اللَّهِ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَهُدًى وَبُشْرَىٰ لِلْمُؤْمِنِينَ ﴾

“Thuaj: “Kush është armik i Xhibrilit (është armik i Allahut), e ai me urdhrin e Allahut e zbriti Kurandin në zemrën tënde, që është vërtetues i asaj që ishte më parë dhe udhërrëfyes e përgëzues për besimtarët.” (Bekare: 97)

Çifutët thonë se Xhibrili është engjëlli që është armik i tyre, ngase ai ka zbritur urdhër për shkatërrim, çarje e plasaritje në mesin e tyre. Në fakt Xhibrili e ka zbritur të vërtetën te Muhamedi, a.s., e vërtetë e cila fakton të vërtetën e shpalljes apo zbritjes së fjalës së Allahut, xh.sh., edhe te Musai, a.s. Asgjë nuk shpallet, apo asgjë nuk mund të vijë pa urdh-

rin e Allahut, xh.sh., dhe çdo gjë e zbritur si nga urdhri, ashtu edhe nga përmbajtja, ka për qëllim udhëzimin e shoqërisë njerëzore për besim të drejtë dhe udhëzim për kryerjen e vep-rave të mira.

Besimi apo mohimi i pjesshëm si formë e mosbesimit

Nuk mund dhe nuk është e drejtë, madje është edhe e pa-pranueshme në çdo kohë dhe çfarëdo rrethane, që Kurani, shpallja e Allahut, xh.sh., të besohet pjesërisht, apo të mohohet pjesërisht. Nëse vetëm një fjalë nga Kurani e mohojmë, duke thënë se nuk është prej Allahut, xh.sh., apo se është e gabuar, atëherë mohuesi konsiderohet jobesimtar. Pra, kush është armik i Xhibrilit, është armik edhe i Allahut, xh.sh. Apo, me një gjuhë tjetër, kush nuk e beson Xhibrilin se është engjëll i shpalljes, ai nuk e ka besuar as Allahun për Krijues të kësaj gjithësie, dhe i tilli ka bërë *kufër* - ka mohuar, prandaj i tilli edhe është jobesimtar.

Duhet ditur se Kurani është vërtetuesi i vetëm i shpallje-ve të mëhershme, dhe se askush nuk mund të dijë rreth tyre më shumë sesa ajo që sjell Kurani. Zoti, xh.sh., thotë:

﴿ مَنْ كَانَ عَدُوًّا لِلَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَرُسُلِهِ وَجِبْرِيلَ وَمِيكَالَ فَإِنَّ اللَّهَ

عَدُوٌّ لِلْكَافِرِينَ ﴾

“Kush është armik i Allahut, i engjëjve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit (ai është jobesimtar). Allahu pa dyshim se është armik i jobesimtarëve.”
(Bekare: 98)

Ata që ishin armiq të Xhibrilit dhe të asaj që ai solli, ata janë edhe armiq të Allahut, xh.sh. E, ata që janë armiq të Allahut, xh.sh., janë edhe armiq të engjëjve, të pejgamberëve, të Xhibrilit e Mikailit. Duhet ditur se Allahu është armik i atyre që mohojnë në atë që thërret Allahu, xh.sh., për t'u besuar dhe për t'u adhuruar, e Ai është Allahu Një i Vetëm. Allahu, xh.sh., thotë në Kuran:

﴿ نَزَّلَ عَلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ وَأَنزَلَ التَّوْرَةَ

وَإِلْإِنْجِيلَ

“Ai ta ka shpallur ty Librin me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai e ka zbritur Teveratin dhe Inxhilin.” (Ali Imran: 3)

Pra, Zoti, xh.sh., është Ai që e zbriti Kuranin te Muhamedi, a.s., drejtuar njerëzimit mbarë, si dhe e zbriti Teveratin e Inxhilin dhe tërë shpalljet e tjera hyjnore, dhe Allahu, xh.sh., ka dashur që këto shpallje (libra të shpallur) prej Tij të jenë në mesin e brezave të shumtë, në mesin e popujve të caktuar dhe vende të caktuara. Këto shpallje e fletushka janë ruajtur e mësuar prej pjesëtarëve të shumtë në popujt ku ishin shpallur. Megjithatë, prapë vërehet se, bazuar në gjendjen dhe rrethanat e krijuara nëpër ato kohë të hershme, po edhe në problemet e shumta në mesin e shoqërive njerëzore, këto shpallje, me përjashtim të Kuranit, e humbën origjinalitetin e zbritjes.

Besimi i disa pjesëve nga libri i Allahut, xh.sh., dhe mohimi i disa pjesëve të tjera jo vetëm që e nxjerr njeriun nga besimi, por ai njeri është edhe i kërcënuar se në botën tjetër do ta ketë një dënim të ashpër, ndërsa në këtë botë do të ketë nënçmim dhe poshtërim. Këto vepra i bënë izraelitët, e që

Allahu, xh.sh., i kërcënoi. Mirëpo edhe besimtarët, nëse besimi i tyre në Kuran është i pjesshëm, do të vlerësohen njësoj.

﴿...أَفْتُؤْمِنُونَ بِبَعْضِ الْكِتَابِ وَتَكْفُرُونَ بِبَعْضٍ فَمَا جَزَاءُ مَنْ يَفْعَلُ ذَلِكَ مِنْكُمْ إِلَّا خِزْيٌ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يُرَدُّونَ إِلَىٰ أَشَدِّ الْعَذَابِ وَمَا اللَّهُ بِغَافِلٍ عَمَّا تَعْمَلُونَ﴾

“...A besoni në një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni?! Ç’mund të jetë ndëshkimi ndaj atij mes jush që punon ashtu përveçse poshtërim në këtë jetë, e në Ditën e Gjykitimit ata hidhen në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj asaj që veproni.” (Bekare: 85)

Madje, disa njerëz devijojnë duke thënë se edhe të tjerët janë besimtarë. Sidomos kur flasin për hebrenjtë dhe të krishterët, duke arsyetuar se edhe ata i besojnë peygamberët siç i besojnë myslimanët, si Musain, a.s. (Moisiun) apo Isain, a.s. (Jezusin)! Mirëpo, duhet ditur se besimi i tyre nuk është i kompletuar edhe ndaj peygamberëve të tjerë të Allahut, xh.sh., sepse ata i besojnë disa peygamberë, e disa jo. Çifutët i besojnë peygamberët deri te Musai, a.s., ndërsa nuk e besojnë Isain, a.s., e as Muhamedin a.s., si peygamberë të Zotit, xh.sh., ndërsa të krishterët i besojnë peygamberët deri tek Isai, a.s., ndërkaq e mohojnë peygamberin e fundit, Muhamedin, a.s. Pra, dëshirojnë të bëjnë dallime ndërmjet peygamberëve, duke i besuar disa, dhe duke i mohuar disa të tjerë. Dhe kështu besimi i tyre i pjesshëm rezulton jo i plotë, përkatësisht mbeten jobesimtarë. Allahu, xh.sh., këtyre dhe të ngjashmëve u thotë:

إِنَّ الَّذِينَ يَكْفُرُونَ بِاللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيُرِيدُونَ أَنْ يُفَرِّقُوا بَيْنَ اللَّهِ وَرُسُلِهِ وَيَقُولُونَ نُؤْمِنُ بِبَعْضٍ وَنَكْفُرُ بِبَعْضٍ وَيُرِيدُونَ أَنْ يَتَّخِذُوا بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا ﴿١٥٠﴾ أُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا وَأَعْتَدْنَا لِلْكَافِرِينَ عَذَابًا مُّهِينًا ﴿١٥١﴾

“S’ka dyshim se ata që nuk e besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij, dhe thonë: “Ne i besojmë disa, e nuk i besojmë disa të tjerë.” E mes këtij duam të marrin një rrugë. Të tillët janë jobesimtarë të vërtetë, e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët.” (Nisa: 150-151).

Mosbesimi i njërit prej pejgamberëve të Allahut që është përmendur në Kuran, për besimtarin mysliman konsiderohet gabim, pra, ai bëhet jobesimtar, siç edhe u pa nga ajeti i lartpërmendur.

Kurani, si libri i fundit i shpallur prej Allahut, xh.sh., na lajmëroi edhe për shumë gjëra të zbritura në librat e mëparshëm, të cilat ose i larguan, ose i zëvendësuan me mendime e propozime prej tyre. Kështu vjen deri te përzierja e shprehjes hyjnore me mendimet e njerëzve të ndryshëm dhe librat e mëparshëm, siç na lajmëron Kurani, dhe e humbin origjinalitetin e zbritjes. Prandaj edhe sot ato shpallje që gjenden te besimtarët e besimeve të tjera, te pasuesit e librave, pavarësisht se cilës fe i takojnë, nuk mund të besohen prej myslimanëve si libra të shenjtë, ngase njerëzit kanë futur mendimet e tyre brenda atyre librave, e kanë devijuar fjalën e Allahut, xh.sh., dhe çfarë nuk u ka pëlqyer ata e kanë larguar nga libri, duke mos e ruajtur në formën origjinale të zbritjes.

Nëse pyetemi për librat e shenjtë, duhet të përgjigjemi në këtë mënyrë: Myslimani beson në librat dhe fletushkat e shpallura dhe të zbritura prej Allahut, xh.sh., pa kurrfarë dallimi në mes tyre. Pra, myslimani beson në librat që kanë zbritur, e jo në librat që sot konsiderohen të shenjtë (zbitur) dhe që gjenden në duart e të krishterëve dhe në duart e çifutëve, e që sipas tyre konsiderohen se janë ruajtur. Besimi në librat e shenjtë është një nga kushtet e besimit në fenë islame. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿ يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ ۖ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ
وَكِتَابٌ مُبِينٌ ﴾

“O ithtarë të librit, te ju erdhi i dërguari Ynë, që jua sqaron shumë nga ato që fshihni nga libri, e për shumë nuk ju jep sqarime. Te ju erdhi dritë dhe libër i qartë prej Allahut.” (Maide: 15)

Pra, Allahu, xh.sh., sikur thotë: O ju ithtarë të librave të mëparshëm, ju ithtarë të Tevratit e të Inxhilit, hebrenj e të krishterë, te ju ka ardhur i Dërguari Ynë i fundit, Muhamedi, a.s., i cili jua shpjegon shumë nga ato që i keni fshehur e devijuar nga librat e mëhershëm e të shpallur prej Allahu, xh.sh.! Te ju, prej Allahut, xh.sh., erdhi drita, e ajo dritë është Kurani, është Islami, është Muhamedi, a.s., që para jush e ndriçojnë rrugën e drejtë e të vërtetë, rrugën e udhëzimit e të ardhmërisë së sigurt. Prandaj, besoni në atë që porosit Allahu, xh.sh., dhe largohuni nga besimet e kota, ngase besimi apo mohimi i pjesshëm në Islam, i fjalës së Zotit, xh.sh., konsiderohet mosbesim!

Haxhi Sherif ef. AHMETI

“ITAAT” ZOTIT xh.sh. DHE TË DËRGUARIT TË TIJ*

“Itaat” do të thotë: me iu përgjigjur kërkesës së atij që prej teje kërkon diçka, ose me iu përgjigjur asaj çka kërkohet. Ajo çka kërkohet mundet me qenë: kërkesë për të punuar një punë, ose kërkesë për të mos punuar një punë pra me iu përgjigjur urdhrat apo me iu përgjigjur ndalesës.

Marrë në tërësi, *itaat* është me iu përgjigjur robu Zotit të vet, me iu përgjigjur krijesa Krijuesit të vet.

Mendoj se fjalën *itaat* mund ta shprehim në gjuhën tonë me fjalën: me respektua, me dëgjua, me iu përgjigjur.

Për respektin të cilin duhet bërë Zotit, nuk ka çka të flitet, kur dihet se ajo është detyrë e çdo krijese në mesin e të cilave është edhe njeriu, por këtu e kemi fjalën për respektin të cilin duhet bërë ndaj Pejgamberit.

Në Kuran hasim në shumë ajete që urdhërojnë respektin të dërguarit si:

“O ju që keni besuar, respektoni Allahun dhe respektoni të dërguarin..” (Nisaë: 59).

“Respektoni Allahun dhe të dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni” (Ali Imran: 132).

* Marrë nga: “Takvim 1407/8-Kalendar 1987”, fq. 50-60.

“Thuaj: Respektoni Allahun dhe respektoni të dërguarin..” (Nur: 54)

“Falni namazin, jepni zeqatin dhe respektoni dërguarit ashtu që të mëshiroheni.” (Nur: 56)

Nëse me vëmendje vështrohen, në të gjitha këto ajete kuptohet se respekti ndaj peygamberit është obligim i besimtarëve, se Peygamberi ka një lloj autorizimi prej Zotit, se ka një kompetencë në hartimin e rregullave dhe të dispozitave të sheriatit, se në bazë të autorizimit që po kuptohet, Peygamberi meriton të respektohet, të dëgjohet, të zbatohet kërkesa e tij.

Me dëgjua Peygamberin, me respektua dhe me iu përgjigjur në atë që e kërkon prej nesh, është edhe gjë e logjikshme, kur kihet parasysh se ai ishte transmetues i urdhrit dhe i porosisë së Zotit.

Kompetenca e Peygamberit duket edhe më i qartë në këtë ajet:

“Kush e respekton të dërguarin, ai e ka respektuar Allahun, e kush refuzon, atëherë Ne nuk të dërguam ty (o i dërguar) roje kundër tyre (nuk të dërguam përdhunues)”. (Nisaë: 80).

Kur flasim për autorizim e Peygamberit tanë, së pari duhet ta dimë se Muhamedi është i vetmi peygamber që mrekullia e tij ishte program jete. Pra Kurani, mrekulli e Muhamedit nuk është si mrekullitë tjera të peygamberëve, të cilat u shfaqën dhe e dhanë efektin e vet për atë kohë, në atë moment, por është mrekulli që ka të bëjë më programin e jetës pra mrekulli e përjetshme, mrekulli që jeton sa të ekzistojë jeta në këtë botë.

Prandaj Muhamedi, transmetuesi i mrekullisë së vet, njëkohësisht është edhe rregullues, programues i jetës sipas udhëzimeve të mrekullisë, sipas udhëzimeve të Kuranit, andaj respekti ndaj Muhamedit është respekt ndaj Kuranit, është respekt ndaj Atij që e shpalli Kuranin, pra respekt ndaj Allahut.

Nuk duhet të na habitë fakti pse Muhamedi e gëzon këtë kompetencë në një mënyrë të veçantë nga pejgamberët tjerë, sepse mrekullitë e pejgamberëve tjerë ishin diçka tjetër, e programi i jetës ishte diçka tjetër. Kur flasim për mrekullinë e Ibrahimit, të Musaut, të Isaut, flasim për çështje që kanë kaluar, i ka parë kush i ka parë, i ka përjetuar kush i ka përjetuar. Ato tashmë nuk ekzistojnë dhe sikur Kurani të mos na njoftonte për to, ne do të heshtnim përkitazi me ekzistimin e tyre. Sot nuk mund të thotë dikush: Ibrahim i dërguar i Zotit, e qe, kjo është mrekullia e tij, sepse ajo vërtet ka ndodhur njëherë, por puna e saj ka marrë fund. Ashtu është edhe me mrekullinë e Musaut të Isait etj. E besimtari i besimit islam edhe tash në këtë kohë të jetës së kësaj dynjaje thotë: Muhamedi i dërguar i Zotit, qe, kjo është mrekullia e tij, Kurani. Siç u kuptua, mrekullia e Muhamedit është e përjetshme, është program i jetës, e Muhamedi është dërguar prej Zotit që ta kumtojë këtë program.

Kur i paraqitej nevoja Muhamedit për të shqyrtuar ndonjë çështje për të cilën nuk kishte ndonjë vendim të prerë e të caktuar, ai i jepte përparësi dhe e ruante respektin ndaj Allahut, edhe nëse ajo shkonte në dëm të vetes së tij. Pra ishte aq besnik, sa që ai qëndrim i tij jepte me kuptua se transmetimi ishte i drejtë, i sigurt edhe kur ishte fjala kundër vetes.

Në ajetin e shënuar në suren *Nisaë*, të cilin e shënuam të fundit, mund të ndodhë që të shtrohet pyetja: a thua më e lojgjikshme ka qenë të thuhet: kush e dëgjon Allahun, ai e ka dëgjuar të dërguarin.. apo si është thënë: kush e dëgjon të dërguarin, ai e ka dëgjuar Allahun.?

Kjo pyetje mund të parashtrohet ngase, nëse nuk analizohet mirë çështja, sipërfaqësisht duket se respekti, dëgjimi ndaj Allahut është në një rreth më të largët, e ai i pejgamberit më drejtpërsëdrejti!

Duhet kuptuar se respekti i drejtpërsëdrejti është ndaj Allahut, e jo ndaj Pejgamberit, pse Kurani i njoftoi besimtarët kur tha: O besimtarë, kur i dërguari u urdhëron diçka ju dëgjoni atë, pse respekti ndaj tij është respekt ndaj Allahut. Këtë më së miri mund ta kuptojmë kështu: Allahu parashtron një çështje me të cilën na obligon, ose prej së cilës na ndalon, por e parashtron në mënyrë të përgjithshme, në mënyrë të tërësishme, fjala vjen: zeqati, haxhi, namazi etj., e Pejgamberi atë çështje e shkoqitë në detaje, atëherë besimtari duke zbatuar atë, e respekton Allahun në atë çështje të përgjithshme dhe e respekton të dërguarin në detajet e asaj çështje, pra përnjëherë i respekton që të dy në një çështje.

Po nëse Allahu nuk ka sjell për ndonjë çështje as vendim të përgjithshëm as vendim të shkoqitur në detaje, atëherë në atë çështje e respektojmë të dërguarin, e respektojmë në bazë të autorizimit të cilin Allahu ia besoi, e neve na tha: **“Atë që u jep i dërguari, pranoni, e nga ajo që ai u ndalon, largohuni prej saj..”** (*El Hashru: 7*).

Sipas këtij ajeti kuptohet se Allahu e autorizoi të dërguarin e vet që ai të nxjerri dispozita, rregulla, t'i shkoqis çështjet që janë thënë në mënyrë të përgjithshme, pra është i vetmi

pejgamber i autorizuar, pse mrekullia i tij ishte program jete, e jeta ka nevojë për rregulla e dispozita të shkoqitura në detaje. Nuk ka dyshim se të gjithë pejgamberët transmetuan vetëm atë që Allahu i obligoi, asnjëri prej tyre nuk kumtoi diçka nga vetvetja e tij, ashtu ishte edhe pejgamberi ynë, por për këtë Zoti na tha: *Çka t'ju jep i dërguari pranone...*

Gjithçka që Pejgamberi urdhëron ose ndalon është brenda rrethit të urdhrit të Allahut, është brenda rrethit të autorizimit, i cili i është dhënë me këtë ajet të Kuranit. Prandaj kur shtrohet pyetja: cili është ai dokument për namazin e sabahut se është dy rekate, për të drekës katra, për të akshamit tri e kështu me radhë edhe për të tjerat namaze, ose cili është ai dokument se zeqati kapë shumën dy e gjysmë për qind të pasurisë që ka *nisabin*, apo cilat janë rregullat, të cilat duhet kryer gjatë haxhit dhe në bazë të cilit dokument? Përgjigja e jonë është: Kurani na ka thënë: *çka t'ju jep i dërguari pranone...*

Atëherë po kuptohet se kompetenca, autorizim i të dërguarit, është brenda Kuranit.

Synneti, hadithi i Pejgamberit është ai i cili çështjet që Kurani i ka thënë në mënyrë të përgjithësuar, i shkoqitë në detaje, andaj nuk mbetet dyshim se synneti është dokument, të cilin lypset respektuar, dëgjuar dhe zbatuar.

Të gjitha qëndrimet e luhatshme përkritazi me fuqinë e synnetit si dokument fetarë, janë të pa baza, janë ose injorante ose tendencioze. Për ata që synnetin e Pejgamberit, hadithin dhe gjykimin e tij nuk duan ta pranojnë si dokument, e as nuk duan ta respektojnë, po sjellim një thënie të Pejgamberit nëpërmjet të cilës na shpjegon dallimin ndërmjet atyre pyetjeve e bisedave që bëhen me qëllim të njohjes së më mi-

rë të parimeve të fesë islame dhe, ndërmjet atyre pyetjeve e bisedave që nuk synojnë kah dituria e shëndoshë islame, por kah lëndimi i parimeve të fesë në përgjithësi e ka thënë: *“Ka gjasa se do të ketë të atillë, që rrinë të mbështetur në kolltukun e vet, dhe flasin e bisedojnë rreth thënieve të mia... e madje edhe thonë: ndërmjet neve dhe juve kemi librin e Allahut... çka dimë në te për hallall, edhe ne e pranojmë për hallall, e çka dimë në te për haram, edhe ne e çmojmë haram... Veni re dhe keni kujdes. Ta dini se atë që e ka ndaluar i dërguari i Allahut, është si me ndalur Allahu!”*

Ky hadith le që na shpjegon për mosdijen e atyre që thonë fjalë të tilla, por edhe na sjell argument që vërteton të dërguarin, pse sikur të mos thotë dikush ndonjë thënie të tillë rreth synetit, sikur të mos thotë dikush se s’ka tjetër pos Kuranit, se hadithi është i papranueshëm etj., atëherë do të thonim: Pejgamberi ka thënë se do të ketë të tillë që do të thonë kështu e kështu, por ne nuk po dëgjojmë se dikush po thotë diçka ashtu?! Prandaj paraqitja e njerëzve të tillë, kudo qofshin në botë, është një argument që vërteton thënien e Pejgamberit.

Këtu, në *itaat* ndaj Pejgamberit, nuk ka ndonjë frikë se po i bëjmë *itaat* edhe dikujt po Zotit, ose sikur dikush po merr guxim e po thotë: po shkojmë në shirk-idhujtari! Jo, kjo çështje është shtruar edhe në kohën e Pejgamberit. Në të vërtetë, hipokritët dhe idhujtarët u përpoqën të shkaktojnë huti ndër njerëz, u përpoqën të gjatojnë diçka kur u shpall ajeti: Kush e respekton të dërguarin e ka respektuar Allahun.. e edhe prej një hadithi: *“Kush më dëgjon mua, ai e ka dëgjuar Allahun, kush më do mua, ai e ka dashur Allahun!”* “Kur mësuani se ç’po thotë ajeti dhe ç’po thotë hadithi ata thanë: “A

dëgjuat për këtë shokun tuaj, fjalën e kishin për Muhamedin... edhe ai iu ka afruar idhujtarisë, pse sa thotë. Mos adhuroni tjetër përveç Allahut, e në anën tjetër, ai do ta bëjë edhe veten zot, derisa thotë se duhet respektuar dhe duhet dashur edhe atë!?

Ata nuk e kishin kuptuar, apo nuk donin ta kuptojnë se respekti ndaj Pejgamberit nuk është respekti drejtuar drejtë atij, është respekt i drejtuar Allahut, pse Pejgamberi ose është kumtues i ndonjë citati të posaçëm, ose kumtues prej Allahut në ndonjë citat me përmbajtje të përgjithshme, e derisa ai është komunikues dhe kumtues prej Allahut, ai shkoqitë atë që Allahu ia ka besuar, andaj njeriu që zbaton urdhrin e Pejgamberit, ai nuk e ka respektuar vetëm Pejgamberin, por e ka respektuar Zotin, pse Ai ia besoi atij shkoqitjen.

Itaati i kërkuar ndaj Allahut ose ndaj Pejgamberit, nuk zbatohet vetëm me fjalë të thata, nuk është *itaat* të thuhet: O Zot të respektoj, *itaat* i vërtetë është kur të gjitha gjymtyrët e trupit zbatojnë atë që e dëgjon veshi dhe që e thotë gjuha. Këtu duhet të bëjmë një dallim në kuptimin e fjalës *itaat* ose respekt, pse ka edhe në jetën e përditshme si: djali respekton prindërit, punëtori mjeshttrin nxënësi profesorin etj por asnjë prej tyre nuk janë në atë nivel të respektit që ka të bëjë ndaj Zotit, pse të parët kanë nevojë për një respekt të kërkuar prej djalit, punëtorit, nxënësit, e Zoti nuk ka kurrfarë nevojë për respektin e robit, andaj kërkesa e respektit prej Atij që nuk ka nevojë për te, ka një (domethënie të madhe, ka domethënie mëshire e bamirësie prej Atij që respektohet, e jo interes, pra respekt i sinqertë është vetëm ai i robit ndaj Zotit.

Ndaj dashurie që njerëzit ushqejnë për Zotin, e për hir të Tij edhe për Pejgamberin, mund të ndodhë që dikush përpi-

qet ta lavdërojë Pejgamberin ose ta ngriti në ndonjë shkallë të lartë, por duhet ditur se as që nuk mund të lavdërohet e as të ngritet më lartë se sa e ka lavdëruar dhe ngritur Zoti. Duhet pasur kujdes që dashuria ndaj Pejgamberit të mos vie në kundërshtim me besimin, imanin sikurse i ndodhi Ymerit të Hatabit kur ndërroi jetë i dërguari, derisa e ktheu në thelbin e besimit, të imanit Ebu Bekri kur ia lexoi ajetin: *Ve ma Muhamedun il-la resulun, kad halet min kabli errusulu.*

Lavdërimi, ngritja dhe mbrojtja në shkallën më të lartë, mund të kuptohet nga pjesa e dytë e ajetit në suren *Nisaë* të cilin e përmendëm më parë: ***Kush e respekton të dërguarin, ai e ka respektuar Allahun, e kush e refuzon...?*** Sipas këtij ajeti po kuptohet se njerëzit janë të ndarë në dy grupe: njeri grup është ai që i përgjigjet urdhrit: puno ose mos puno, pra i është kapur programit të jetës sipas Kuranit, grupi tjetër nuk respekton, refuzon atë program të jetës që e urdhëron Kurani. E shih se çka i thotë Zoti të dërguarit të vet, si e mbron dhe si e udhëzon ndaj atij grupi refuzues? I thotë: ***“Kush... e kush refuzon, Ne nuk kemi dërguar ty roje e tyre!”*** Allahu sikur i thotë: qetësohu e mos e mundo veten, qetësohu se ai që refuzon respektin ndaj teje, ai ka refuzuar respektin ndaj Allahut, pra si respekti si refuzimi kanë të bëjnë me Allahun. E për ta josh Pejgamberin se ai nuk ka përgjegjësi për ata që nuk besojnë i thotë: ***“Fe ma erselnake alejhim hafidha!”*** - *Ne nuk të dërguam te ata t'i detyrosh të besojnë*

Kur i thotë Zoti Muhamedit: ***“Erselnake alejhim”*** ka kuptimin: *Ne të dërguam te ata transmetues, kumtues, përcjellës të porosisë sonë.*

E kur i thot: **“Fe ma erselnake alejhim”** - *Ne nuk të dërguam te ata detyrues, mbizotrues, që t'detyrojsh ta pranojnë besimin me dhunë.*

Zoti po e mbron Pejgamberin kur po i thotë: **Ne nuk të dërguam te ata t'i detyrosh të besojnë, andaj ti nuk je përgjegjës. Ne të dërguam t'u kumtosh njerëzve programin Tim, kush të dojë le të respektojë, kush të dojë le të kundërshtojë, ti mos e ngushto veten, mos e obligo veten me një punë që Allahu nuk të ka obliguar.** Kështu i thotë edhe në suret: *Bekare: 272, Gashije: 21-22, Kaf: 45.*

Allahu e dërgoi të dërguarin e vet për të gjithë njerëzit që t'u kumtojë shpalljen dhe t'i le të lirë të zgjedhin. Me këtë Muhamedit i bëhet lehtësim, pse Zoti nuk do ta marri në përgjegjësi pse nuk besuan. Për arsye se Muhamedi angazhohej dhe përpiquej me të gjitha fuqitë që kishte për t'i sjellur në besim gjithë ymetin (ymmeti dave), e ngarkonte veten përtej mundësie, lakmia e tij ishte barrë që ia këpuste shpirtin, andaj Zoti e qorton dhe të gjitha qortimet që vërehen në Kur'an, nuk janë se ai theu ndonjë rregull, apo kundërshtoi ndonjë dispozitë, por, pse ai e ngarkonte veten më tepër se sa ishte i obliguar, kuptohet ai atë e bënte nga dashuria ndaj Zotit, ndaj fesë të cilën e kishte shpallur Zoti.

Ja, një shembull, kur iu shpall: **“Abese ve ifvel-la...** Edhe idhujtarët u gëzuan e thanë se Zoti e qortoi të dërguarin e vet. Po nuk e kuptuan se Muhamedi në atë moment u ishte drejtuar krerëve idhujtarë, kurejshit, mohuesve të Kur'anit, të fesë, të besimit në një Zot. Në atë moment vjen Ibni Umi Mektumi, besimtarë i besimit islam, njeri i afërt i familjes, pse Hadixheja e kishte birin e dajës, kërkonte diçka që ishte shumë lehtë t'i përgjigjej Muhamedi, e biseda që e kishte me ata aro-

gant ishte e rëndë, ishte e vështirë, e megjithatë, ai e la atë që ishte lehtë dhe iu rrek asaj që ishte e vështirë, atëherë Zoti i tha: pse po e mundon veten, merre të lehtën e mos të vështirën, pse ti nuk je përgjegjës pse ata nuk besojnë, ti atyre u komunikove, u përcolle, ajo është detyrë e jotja, nuk është detyrë e jotja a besojnë ata ose nuk besojnë, pse: **“Ve ma erselnake alejhim hafidha!”**

Kështu Zoti e mbron dhe e ruan të dërguarin e vet. Edhe një rast tjetër. Pejgamberi e kishte emrin Muhamed, e Muhamed do të thotë: *I lavdëruar, i falënderuar*, e kur armiqtë dëshironin ta shanin ose ta mallkonin, nuk e shanin as nuk e mallkonin Muhamedin, pse Zoti e mbron edhe emrin e tij, i largon ata prej sharjes së emrit të tij, i frymëzon që ata ta quajnë me një emër tjetër. Nga inati dhe nga smira, ata e quanin “mudhemim”. E kur e shanin ose e mallkonin, ata e shanin atë emër të cilin vet e kishin zgjedhur. Gruaja e Ebu Lehebit e shante *mudhemimin*, e Pejgamberi qeshte dhe shokëve të vet u thoshte: A po çuditeni se si Allahu i largoi sharjet e kurjeshitve edhe nga emri i im, ata e shajnë *mudhemimin* e unë jam Muhamedi.

Këto ishin disa nga mbrojtja e Zotit, lavdërimi dhe lartësimi që ia bëri robit të vet, të dërguarit të vet, andaj respekti, dëgjimi, përgjigjej ndaj këshillave të tij, janë *itaat* ndaj Allahut.

Resul ef. REXHEPI

DISA DISPOZITA PËR (JO)REVOKUESHMËRINË E VAKËFNIMIT, ANULIMIN DHE TJETËRSIMIN E TIJ

Hyrje

Në historinë njerëzore, asgjë nuk është krijuar dhe as që ka vazhduar të ekzistojë për një kohë të gjatë, pa ndonjë arsye madhore. Nëse diçka ka jetuar me shekuj, atëherë sigurisht që ka një justifikim të plotë për ekzistencën e saj. Kur e them këtë, kam parasysh traditën shekullore të vakëfit në kulturën myslimane, e cila ka vazhduar pandërprerë që nga koha e Pejgamberit a.s., dhe gjatë gjithë gjeneratave të mëvonshme, e deri më sot.

Secili brez i myslimanëve u përpoq, në mënyrën e vet dhe në kapacitetin e tij, për të kontribuar në këtë institucion, i cili është thjesht i pandashëm nga Islami. Islami dhe vakëfi janë thjesht të pandarë, dhe për më tepër, prore e mbështesin dhe e forcojnë njëri-tjetrin. Kur them se ata e forcojnë njëri-tjetrin, dua të them se tekstet e shenjta islame flasin në shumë vende për rëndësinë e vakëfit dhe bamirësisë në përgjithësi. Në Kuran është urdhëruar që, si besimtarë të formuar, të japim, të dhurojmë nga gjërat më të dashura, në mënyrë që të arrijmë pëlqimin e Krijuesit. Allahu xh.sh. në Kuran thotë:

لن نألو البر حتى ننفقوا مما آبون

“Në asnjë mënyrë nuk do të arrini shpërblimin derisa të jepni nga ajo që është më e dashur për ju...”¹

Në këtë kuptim janë edhe shumë hadithe të Resulullahut. Po e përmendim, sa për ilustrim, vetëm këtë rast: Një herë Muhamedi a.s., i pyeti sahabët e tubuar: *“Për cilin prej jush, prona e tij është më e dashur se prona e trashëgimtarëve të tij?”* Ata u përgjigjën: *“O i Dërguar i Allahut, secili prej nesh e do pasurinë e tij më shumë se pasurinë e trashëgimtarëve të tij.”* Pastaj Pejgamberi shtoi: *“Njeriut i takon vetëm ajo që ndan, kurse çdo gjë që ka mbetur pas tij, iu takon trashëgimtarëve të tij.”*

Prandaj, Islami inkurajon themelimin e vakëfeve, sepse ato kontribuojnë dhe ruajnë idenë e Islamit përmes ekzistencës dhe punës së tyre. Çdo vakëf dhe çdo hajrat i ngritur nga shpirti bamirës i besimtarëve e bënë Islamit më të fortë në disa aspekte. Islami u forcua me ndërtimin e xhamive dhe objekteve fetare, por, gjithashtu, edhe atëherë kur u ngritën ndërtesa për të mirën e përbashkët. Të flasësh për vakëfin është të flasësh për Islamit, dhe për këtë arsye për vakëfin duhet folur vazhdimisht, sa më shpesh e sa më shumë.

¹ Ali Imran, 92. Në këtë frymë janë edhe ajetet: Huxhurat, 15; Et Tevbe, 111; El Bekare, 207 etj.. Më gjerësisht: Osman Nuri Topbash, *Vakëfi, dhurimi dhe shërbimi*, Tiranë, pa vit botimi.

Rëndësia e vakëfnimit

Ndonëse për vakëfin është shkruar edhe më parë, megjithatë, gjithmonë ka shumë dimensione të rëndësishme të vakëfeve që duhen të rithuhën e të rishkruhen, sepse lexuesit gjithmonë kanë nevojë t'i freskojnë kujtimet e tyre. Qëllimi ynë është, përveç të tjerash, të vëmë në dukje fenomenin se vakëflënësit në shoqëritë tona janë persona, emri i të cilëve zgjat shumë më gjatë se ekzistenca e tyre biologjike e që është jetëshkurtër. Në të vërtetë, çdo njeri kur arrin vitet e pjekurisë dëshiron të lërë gjurmë në tokë. Ai dëshiron që ekzistenca e tij të mos jetë shkrim mbi ujë, por një gjurmë e vërtetë si një fjalë e bukur e gdhendur në gur. Për këtë arsye, ne iu gëzohemi pasardhësve tanë, sepse, në një farë mënyre, përmes fëmijëve tanë dëshirojmë të vazhdojë të na përmedet emri ynë.

Njerëzit bëjnë shumëçka me qëllim që të lënë ndonjë gjurmë të bukur pas tyre, në mënyrë që emrin e tyre ta bëjnë të përhershëm. Një nga mënyrat më të mira për këtë synim ka qenë institucioni i vakëfit, i cili ruan me vite kujtimin e disa emrave. Këto janë ato *“vepra të mira - “bakijatun salihattun”*, të cilat janë të përjetshme dhe të patejkalueshme. Ato dëshmojnë se e vetmja mënyrë për ta bërë të përhershme pasurinë është ta shpenzojmë atë në hajrate dhe kësisoj të investojmë për përjetësi.

Pejgamberi a.s., në këtë kuptim ka qenë shembulli më i përsosur për ymetin, bashkësinë e vet. Kështu, ai i pati dhuruar në rrugën e Allahut shtatë kopshte hurmash që kishte në Medinë dhe më vonë pjesën e vet nga kopshtet e hurmave të Fedekut dhe Hajberit.

Edhe sahabët, shokët e tij të zgjedhur, duke parë shembullin e tij, i patën dhuruar si vakëf shumë prona të patundshme që sillnin të ardhura të konsideruara. Hasreti Ymerit, në Hajber, i kishte rënë një parcelë me hurma. Pastaj, për tri net rresht iu kishte dëftuar në ëndërr se atë duhej ta vakëfnte, përse e kishte pyetur Pejgamberin. Pejgamberi a.s. i kishte thënë: *“Po dëshirove, dhuroje atë hurmishte për Allahun! Atëherë, ajo as nuk shitet as nuk blihet, nuk dhurohet dhe as nuk lihet trashëgim. Prodhimi i saj vetëm dhurohet!”* Ymeri e dhuroi atë parcelë për Allahun xh.sh.! Kështu kanë vepruar edhe shumë sahabë të Pejgamberit a.s., madje njeriu fiton përshtypje se ata garonin se kush po vakëfnte më shumë.

Ne shohim që shumë njerëz bëjnë hajrate-vepra bamirësie, por pyetja shumë e rëndësishme është pse njerëzit e tjerë i mbajnë mend ata? Pse çdo komunitet i kujton disa njerëz si të mëdhenjtë dhe heronjtë e tij, kurse të tjerët, pavarësisht se sa të fuqishëm kanë qenë në kohën e tyre, i lënë në harresë, sikur të mos kenë ekzistuar kurrë?

Para së gjithash, kujtesa njerëzore e disa personave është dhuratë nga Allahu dhe përmeshje e premtimit të Allahut se Ai do të ngulitë në zemrat e njerëzve ata që bëjnë bamirësi.

الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ سَيَجْعَلُ لَهُمُ الرَّحْمَنُ وُدًّا

*“Ata të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do të krijojë (në zemrat e tyre) dashuri.”*²

Është mëshira dhe mirësia e Allahut që disa njerëz, për shkak të mirësisë së tyre dhe fisnikërisë së komuniteteve,

² Merjem, 96.

prore t'i çmoj e t'i dojë. Prandaj, Resulullahu për të tillët ka deklaruar: *“Më i miri i njerëzve është ai që është më i dobishëm për ta!”*³

Përveç kësaj, çdo shoqëri krijon një grup të caktuar vlerash që transmetohen në mënyrë tradicionale dhe me sukses e ruajnë shoqërinë nga shkatërrimi. Nuk ka dyshim se një nga vlerat më të rëndësishme është gatishmëria e sakrificës për komunitetin dhe shoqërinë në përgjithësi.

Në komunitetet ku ruhet kjo vlerë, heronj janë ata që e vendosin suksesin dhe lumturinë e komunitetit përpara lumturisë dhe suksesit të tyre personal.

Vakëfi mbart në vetvete dy ide themelore, që janë të kundërta me njëra-tjetrën, idenë e ndalimit dhe idenë e vazhdimësisë dhe bamirësisë institucionale. Vetë fjala vakëf do të thotë të ndalosh qarkullimin e pronës, por nga vjen ideja e një të mire të përhershme - “*sadakai-xharije*”? Pra, fjala është për faktin se vakëflënësi ndalon nga qarkullimi një pjesë të pasurisë së tij për përfitime personale, individuale, dhe e vë atë në shërbim të vazhdueshëm të komunitetit dhe shoqërisë, gjegjësisht institucioneve kompetente.

Prandaj, vakëflënësi me punën e tij dëshmon dhe mbart idenë e sakrificës për komunitetin, për shoqërinë, për të mirën e përbashkët. Këta janë dashamirës që i dhanë përparësi kolektivit mbi individin, i dhanë përparësi fesë dhe komunitetit mbi dëshirat dhe aspiratat e tyre. Ata “e mposhtën kopracinë e shpirtit” dhe dëshmuan se nuk jetonin vetëm për veten e tyre, por edhe për diçka më shumë se për veten e tyre. Vakëflënësit, pra, mishërojnë dhe simbolizojnë ato vlera

³ Imam Es Sujuti, Xhamius-Sagir, 2/8.

që garantojnë të ardhmen e komunitetit, sakrificën dhe vetë-flijimin. Në të njëjtën kohë, ato janë një antitezë e gjallë ndaj lakmisë dhe egoizmit të kudondodhur, të cilat, si kanceri shkatërrojnë çdo shoqëri. Prandaj, njerëzit me mall i kujtojnë vakëflënësit.

Nocioni, kuptimi dhe përkufizimi i vakëfit

Vakëfnimi është një akt sheriato-juridik bamirës, i lejuar, i lavdëruar dhe i parevokueshëm. Arsyeshmërinë e themelimit të këtij institucioni dhe legjitimitetin e tij, juristët islamë e kanë mbështetur në udhëzimet etike të Kuranit,⁴ në praktikën e Pejgamberit a.s.,⁵ në traditën dhe në konsensusin e gjerë të mysli-manëve.⁶

⁴ Më sipër e përmendëm ajetin 92 të sures Ali Imran. Ebu Talhai, kur e dëgjoi këtë ajet, pa hezituar fare shfaqti dëshirën për ta vakëfnuar pjesën më të dashur të pasurisë që kishte, tokën e quajtur "Bejruha".

⁵ Janë shumë hadithe që flasin për aspektin juridik të themelimit të institucionit të vakëfit. Në këtë frymë është hadithi të cilin e ka shënuar Muslimi nga Ebi Hurejreja se Pejgamberi a.s. ka thënë: "*Kur njeriu vdes, pushojnë edhe veprat e tij përveç në tri raste: kur pas vetës lë sadaka të rrjedhshme, ose dituri nga e cila kanë dobi të tjerët, ose fëmijë i cili lutet për të!*" Sadakaja e rrjedhshme-xharije ka të bëjë me vakëfin. Imam Shevkaniu ka thënë: "Fjalët e Pejgamberit "Sadakai-xharije" tregojnë se vakëfi është i parevokueshëm dhe se nuk lejohet anulimi i tij." Më gjerësisht: Shekaniu në Nejlü '1-Evtar, 6/27.

I tillë është edhe hadithi i mirënjohur i Ibën Ymerit, në të cilin thuhet se Pejgamberi a.s. i ka thënë haz. Ymerit, i cili ka dashur ta vakëfnojë tokën e tij në Hajber: "Nëse dëshiron vakëfnoje tokën dhe dhurojë frytet e saj!" Ymeri e la atë vakëf ashtu që ajo as mund të shitet, as mund të dhurohet e as të trashëgohet!" (Transmetojnë koleksionet). Tirmidhiu ka thënë: "Dijetarët veprojnë sipas këtij hadithi, dhe se për këtë çështje ekziston konsensus i dijetarëve!" (Tirmidhi, 5/ 352-353). Dijetarët islamë kanë deklaruar se me

Të vakëfnosh diçka do të thotë, sipas përkufizimit të zgjedhur të juristëve islamë, të ndalosh disponimin e pronësisë së sendit (lëndës) të vakëfnuar, i cili mund të përdoret duke ruajtur substancën e tij, dhe t'i drejtosh përfitimet dhe frytet e tij për ndonjë qëllim bamirës të ligjshëm, të lejuar sipas Sheriatit. Disa juristë, si imamët Ebu Jusufi dhe Muhamedi, e formulojnë këtë kuptim si *“sekuestrimi dhe vendosja e sendit, zyrtarisht dhe ligjërisht, në pronësi të Allahut...”*⁷

Ka edhe përkufizime të tjera, si ai që i atribuohet Imam Ebu Hanifes, sipas të cilit vakëfi është *“përvetësimi i një sendi në pronësi të vakëflënësit dhe lejimi i përdorimit të tij për qëllime bamirësie.”*⁸

Meqenëse një person juridik rëndom ka pronarin e tij, juristët imam Ebu Jusufi dhe imam Muhamedi, treguan qartë në përkufizimin e tyre se vakëfi bëhet pronë e Allahut të Plotfuqishëm (në kuptimin absolut dhe relativ), gjë që përfundimisht zgjidh dyshimin e Ebu Hanifes lidhur me pronarin.

Gjithsesi, synimi kryesor i vakëfnimit duhet të jetë fitimi i pëlqimit të Allahut dhe arritja e shpëtimit në botën tjetër-

sadakanë (mirëbërsinë, lëmoshën) që vazhdon të veprojë, e që quhet “sadakatu-l-xharije-rrjedhëse”, në përgjithësi fjala është për vakëfin.

⁶ Është e ditur se sahabët kanë rënë ujdi përkitazi me themelimin e institucionit të vakëfit nga aspekti sheriato-juridik. Sahabiu i njohur, Xhabir bin Abdilah, mësohet të ketë thënë: “Nuk më është e njohur se ndokush nga muhaxhirët dhe ensarët të ketë pas pasuri e të mos e ketë vakëfnue një pjesë të saj si sadaka rrjedhëse, kështu që ajo nuk mund të shitet, as të dhurohet e as të trashëgohet!” (Mugni, 6/189)

⁷ Shih: Muhamed Ebu Zehre, *Muhaderat fi-l-vakfi, Dar el-fikr el-arabij*, 1391/1971.

⁸ Shih: Kemal b. Humani, *Fethu'l-kadir, El-Matbe'a el-emirijje*, 1316.h., 5/37.

Ahiret. Kështu, ky synim është përmbledhur në shprehjen koncize “et-tekarrub ila Allah”- “*afrim tek Allahu*”.

Fushat në të cilat është vakëfnuar

Edhe pse është e pamundur për të treguar dhe renditur këtu të gjitha llojet e vakëfeve, nga Pejgamberi a.s. e deri më sot, po i japim disa shembuj të rëndësishëm të vakëfnimeve sa për të pasur një si ide:

- ndërtimi dhe mirëmbajtja e xhamive, mesxhideve, musal-lave, teqeve e tyrbeve;
- medresetë, fakultetet dhe institucionet kërkimore e shkencore;
- shërbimet e strehimit, hanet, hamamet dhe shërbimet shëndetësore;
- namazgjahet, libraritë, bibliotekat dhe shtëpitë e pritjes (mysafirhanet);
- shtëpi strehimi, sidomos në qytete (imarete);
- ujësjellësit, puset, çezmat, lugun e çezmave për kafshët e lagjes;
- gjellëtoret publike, çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve;
- çlirimi i robërve dhe skllevërve;
- sigurimi i lëndës djegëse për të varfrit;
- zëvendësimi me të reja i enëve të thyera nga shërbëtorët me qëllim që të mos qortoheshin dhe poshtëroheshin nga zotërinjtë;
- përgatitja e pajës për vajzat jetime dhe të varfra;
- pagimi i borxheve të borxhlinjve;
- ndihmat për gratë e veja dhe nevojtarëve;
- ndihma në ushqime dhe veshje për nxënësit e shkollave;

- shërbimet funerale për të varfrit dhe të vetmuarit;
- dhurata festash për fëmijët dhe të vetmuarit për t'i gëzuar edhe ata;
- mbrojtja e grave të moshuara dhe të vetmuara;
- përgatitja e gurëve të rrafshët në kullota për ta vendosur kripën për bagëtinë;
- vakëfnimi i armëve që në rast nevoje t'iu jepen njerëzve për të gjuajtur shpezë a shtazë për të sëmurët ose të varfrit;
- vendosja e shtëpizave në qoshe të xhamive si strehë për shpezët.⁹

Mund të ketë, mbase, akoma më shumë fusha ose veprime ku besimtarët e sinqertë e zemërmirë kanë bërë vakëfnime (në kohën aktuale, jo rrallëherë, këto po i emërtojnë edhe si fondacione).¹⁰ Është për t'u theksuar se njerëzit e mëdhenj-vakëfëlënësit, me rastin e vakëfnimit, kanë treguar shumë ndjeshmëri, e kanë ndie në shpirtin e tyre rëndësinë që ka kjo përshpirtje. Kjo përshpirtje, sipas gjendjes në terren, ka përfshirë njerëz, po mbase edhe kafshë, sepse vakëfëlënësit janë kujdesur të vakëfnojnë edhe qendra kurimi për kafshë.

⁹ Osman Nuri Topbash, *Vakëfi, dhurimi dhe shërbimi, Tiranë*, pa vit botimi.

¹⁰ Dr. Kaleši, Hasan. Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Prishtinë, 1972.

(Jo)revokueshmëria dhe konsekuencat e tjera juridike të dhurimit

Si edhe çdo veprim tjetër juridik, edhe vakëfnimi shkakton disa konsekuenca juridike. Për këtë ka mendime të ndryshme të juristëve islamë.

Në mënyrë sublimë, konsekuencat juridike të vakëfnimit mund të përmbliidhen në sa vijon:

1. Shuarja e pronësisë së vakefëlënësit mbi sendin e dhuruar.
2. Parevokueshmëria e vakëfit.
3. Detyrimi për t'i dhënë përfitimet dhe frytet e vakëfit përfituesit të synuar, për të cilin ai pretendon të drejtën, moralisht dhe ligjërisht, siç tregohet nga detyra e përfituesit të vakëfit për të dhënë zekatin për frutat e mbledhura. Parevokueshmëria nënkupton ndalimin e disponimit me të cilin bartet pronësia, me ose pa pagesë, dhe ndalimin e trashëgimisë.

Ky është mendimi i shumicës së juristëve hanefi, shafii dhe hanbeli për dallim nga juristët maliki, sipas të cilëve pasojat juridike të vakëfnimit reduktohen në dy gjëra:

1. Parevokueshmëria e vakëfit.
2. Detyrimi për sigurimin e përfitimeve dhe fryteve të vakëfit moralisht dhe ligjërisht.¹¹

Nga sa u tha më sipër, është e qartë se shumica e juristëve të shkollave hanefite, malikite, shafiite dhe hanbelite e konsiderojnë parevokueshmërinë e vakëfit si një nga konse-

¹¹ El Imam Alauddin ebi Bekr b. Mesud el Kasani el Hanefi, “*Bedaiu’ s-Sana’i fi tertibi sh-Sherai’*”, botoi “Daru-l-ihjai al-tourath al-arabi”, bot i tretë, 2000 (1421), Bejrut.

kuencat e vakëfnimit. Kjo konsekuencë ndodh me vetë aktin e vakëfnimit (nëse janë të plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme) dhe nuk varet nga vendimi i gjykatës. Megjithatë, duhet theksuar se parevokueshmëria e vakëfit në kushtet tona këtu, para procedurës së parashikuar administrativo-gjyqësore, i përket sferës së detyrimit moral, sepse nuk ekziston asnjë instrument dhe mekanizëm i zbatimit gjyqësor të detyruar të normave të së drejtës së Sheriatit. Megjithatë, vetë ndjenja e detyrimit moral për të përfunduar punën ligjore të vakëfnimit është nxitje e mjaftueshme për një besimtar të vërtetë që të mos heqë dorë dhe të revokojë atë që është e parevokueshme sipas Sheriatit.¹²

Parevokueshmëria e vakëfit nënkupton ndalimin e revokimit të vakëfit, anulimin e tij ose kalimin e pronësisë së sendit të vakëfnuar me kontratë ose trashëgimi. Shumica dërmuese e juristëve islamë, në përputhje me mendimin për parevokueshmërinë e vakëfit, ndalojnë pronësinë e objektit të vakëfit, nga cilado anë që të ketë ardhur, në mënyrën që rezulton me privatizimin e vakëfit aktualisht ose në të ardhmen.

Parevokueshmëria e vakëfit tregohet nga argumente të shumta tradicionale dhe racionale, prej të cilave do të përmendi vetëm disa. Në hadithin që flet për vakëfnimin e hasreti Ymerit¹³, përmendet një kusht i qartë: “Nuk mund të shitet, as të dhurohet, as të trashëgohet”, që nënkupton këtë parevokueshmëri. Prandaj, Ymeri r.a. e kuptoi duke iu bindur urdh-

¹² Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, “Kryesia e Çështjeve fetare të Turqisë – Dijaneti”, bot. i dytë, Ankara, 2017.

¹³ Shih fusnotën 4.

rit të Pejgamberit a.s., kështu që ai e vendosi të njëjtin kusht në vakëfin e tij, duke e proklamuar atë para shokëve të shquar.

Disa juristë e kontestojnë argumentin e parevokueshmërisë së vakëfnimit me këtë hadith, duke vënë në dukje se kushti i përmendur (shart) *“Nuk mund të shitet, as të dhurohet apo të trashëgohet”* është thënë nga Ymeri r.a., e jo nga Pejgamberi a.s., siç tregojnë disa transmetime në të cilat këto fjalë i atribuohen Ymerit, kështu që në atë rast, kushti i përmendur është si kusht i vetë vakefëlënësit (shartu'l-vakifi), dhe rrjedhimisht, parevokueshmëria dhe qëndrueshmëria e vakëfit të Ymerit është pasojë e respektimit të kushteve të vakefëlënësit, e jo e tekstit të Ligjvënësit. Mirëpo, kontestimi i lartpërmendur është i pabazë pasi që ekzistojnë transmetime të ndryshme, disa prej të cilave janë edhe në *“Sahihajn”* (Buhari dhe Muslim)¹⁴, në të cilat ky kusht shprehimisht i atribuohet Ligjvënësit (Allahut xh.sh.). Pejgamberi a.s. e kishte urdhëruar Ymerin, kurse ai iu kishte bindur atij urdhri. Në këtë kuptim, Imam Shevkaniu,¹⁵ thekson se nuk ka kundërtënie ndërmjet këtyre versioneve, ani pse në shikim të parë duken të ndryshme, sepse është e mundur që në mes tyre të ketë pajtueshmëri, duke interpretuar se Ymeri e shprehu këtë kusht pasi u urdhërua ta bënte këtë nga Pejgamberi a.s.. Disa ia atribuuan atë Ymerit, sepse ai e shqiptoi atë kusht duke zbatuar urdhrin e Pejgamberit a.s..

¹⁴ Sahihu'l-Buhari dhe Sahihu Muslim.

¹⁵ Shevkaniu, Nejlu 'l-Evtar, 6/25. Gjithashtu El Imam Alauddin ebi Bekr b. Mesud el Kasani el Hanefi, *“Bedaiu' s-Sanai' fi tertibi sh-Sherai”*, Bejrut, 2000.

Për parevokueshmërinë e vakëfit tregohet edhe dhurimi i një pusi të quajtur Rumi nga Osmani r.a., pasi që Pejgamberi a.s. kishte treguar për shpërblimin me Xhenet atij që e blen dhe e dhuron të njëjtin. Kështu, pra, Osmani e bleu dhe e bëri vakëf për myslimanët, kurse ai vetë do ta përdorte si çdo sahabij tjetër.¹⁶ Ai kishte të drejtë të përdorte ujin nga ky pus si myslimanët e tjerë, dhe jo në cilësinë e pronarit. Nëse vakëfi do të ishte i revokueshëm, pusi nuk do të dilte nga pronësia e Osmanit, nuk do ta humbte pronësinë mbi të dhe nuk do të kishte merituar një burim në Xhenet si kompensim për të. E, pra, kjo tregon se vakëfi është një vepër e përhershme dhe e pakthyeshme (e parevokueshme) dhe shumë e dashur tek Allahu xh.sh..

Edhe fakti se historikisht nuk është shënuar e as ta ketë mbajtur në mendje ndokush se ndonjëri nga sahabët e ka anuluar (revokuar) vakëfin dhe ka hequr dorë prej tij, gjë që interpretohet si konsensus i tyre në kuptim të parevokueshmërisë së vakëfit.¹⁷

Përkrahësit e këtij mendimi e shpjegojnë parevokueshmërinë e vakëfit me një provë racionale, e cila është një analogji me dhurimin e xhamisë (mesxhidit). Ekziston një mendim unanim se dhurimi për një xhami (mesxhid) është i parevokueshëm. Toka në të cilën është ndërtuar xhamia del nga pronësia e vakëfit, por nuk kalon në pronësinë njerëzore të askujt, por mbetet e zënë dhe e lidhur me punën e synuar të devotsh-

¹⁶ Njëjtë, si më sipër, Shevkani, Nejlu 'l-Evtar, 6/25.

¹⁷ Njëjtë si në fusnotën 5. Shih gjithashtu: - Prof. Muhamed Mustafa esh Shelebi, “*El-Medhal fit-tarif bil-fikhi-l-islamij*”, botoi “Dar an-Nahda al-Arabijje”, 1969, Bejrut.

me, kështu që në mënyrë analoge kjo është edhe me llojet e tjera të vakëfnimit. Arsyeja e zakonshme ligjore është qëllimi për të kryer vepër të devotshme.

Po ashtu, vetë motivi i vakëfnimit nënkupton parevokueshmërinë e tij, ashtu siç edhe nënkupton pushimin e pronësisë së vakëfëlënësit mbi objektin e vakëfnuar. Vërejtja se nevoja për kontinuitetin e sevapit nuk e sjell pashmangshmërisht ndalimin e pronësisë, sepse në atë rast, vakëfimi do të cilësohej si punë e detyrueshme juridike (vaxhib), ndonëse ajo është vetëm e lavdërueshme (mendub) e kjo nuk qëndron. Sepse vakëfi, në bazë të legjitimitetit të tij ligjor, përfaqëson një akt devotshmërie që bëhet ekskluzivisht në emër të Allahut. Parimet e Sheriatit urdhërojnë mosndaljen nga veprat e devotshme dhe bamirëse, siç kuptohet nga fjalët e Allahut xh.sh.:

... وَلَا تُبْطِلُوا أَعْمَالَكُمْ

“...dhe mos i shkatërroni veprat tuaja!”¹⁸, nga respekti ndaj Allahut të Madhëruar.

Në të vërtetë, madhërimi i të Lartësuarit është intencë kategorike e Sheriatit. Fjalët e Pejgamberit a.s.: “Kur njeriu vdes, atij i ndërpriten të gjitha veprat e tij, përveç në tri raste: në rastin e sadakasë së përhershme-të rrjedhshme (sada-kai-xharie)...”, sugjerojnë pikërisht këtë, sepse ajo është vendosur me qëllim për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Imam Shevkaniu ka thënë: “Kjo frazë tregon për parevokueshmërinë dhe për joanulueshmërinë e tij, sepse, sikur të

¹⁸ Muhamed, 33. Shih dhe Abdurrahman el Xheziri, Kitabu 'l fikh al-el medh-hebil erbeati, “Dar u rrejan lit-turath”, bot i parë, Kajro, 1987.

lejohej anulimi i tij, vakëfimi do të ishte një bamirësi e përkohshme, e ndërprerë (“sadaka munkati'a”), ndërsa hadithi e përshkruan atë si të përhershme (“sadaka xharije”).¹⁹

Sa i përket pohimit se vakëfnimi është vetëm vepër e lavdërueshme (mendub), nuk kontestohet, por para se të hyhet në atë punë juridike, d.m.th. para themelimit të vakëfit dhe jo në lidhje me konsekuencën juridike. Pra, kushdo që themelon vakëf, për hir të kënaqësisë së Allahut, me vullnetin e tij të shprehur lirshëm, ai vetë e ka marrë përsipër atë obligim, dhe sipas dispozitave sheriatike-juridike, ai e respekton edhe pa-revokueshmërinë e tij, nga respekti që ndjen për Allahun e Gjithëmëshirshëm.²⁰

Kurse Imam Ebu Hanife, i pasuar edhe nga nxënësi i tij, Zuferi, mbron tezën për revokueshmërinë e vakëfit dhe mbajtjen e tij në pronësi të vakefëlënësit.²¹

Këtë mendim të tij, ai e argumenton me argumente tradicionale dhe racionale. Kuptimi i argumenteve tradicionale, të cilat janë të diskutueshme për sa i përket autenticitetit të tyre, tregon faktin se hadithet që flasin për vakëfnimin janë në kundërshtim me ajetet që përmbajnë dispozitat për trashëgiminë. Në të vërtetë, pas zbritjes së ajeteve për trashëgiminë, Pejgamberi a.s. kishte thënë - siç transmeton Ibën Abasi: “*Nuk ka ndalim (mbajtje) të pasurisë pas zbritjes së sures En-Nisa.*”²² Në një rivajet tjetër, nga Ibën Abasi, është thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut a.s., si e ndalonte

¹⁹ Burimi i njëjtë, 6/27.

²⁰ Shih: Durejni, njëjtë, 2/226-227.

²¹ Më gjerësisht: Serahsi, El-Mebсут, 12/27-28.

²² Transmeton Bejhëkiu.

mbajtjen e pasurisë.²³ Kjo ka të bëjë me mbajtjen e pasurisë dhe parandalimin e kalimit në pronësi të trashëgimtarit. Nëse konsekuencat e vakëfnimit janë parevokueshmëria e vakëfit, ndalimi i disponimit të sendit të vakëfnuar, përfundimi i pronësisë së vakëflënësit mbi të dhe moskalimi i tij në pronësi të trashëgimtarit të vakëflënësit, atëherë e gjithë kjo nënkupton bllokimin e sistemit të trashëgimisë të përcaktuar nga Allahu i Madhëruar (habs 'an feraidil-lah) dhe pengimin e trashëgimtarëve nga shfrytëzimi i të drejtave të tyre, gjë që është e ndaluar me hadithin e lartpërmendur.²⁴

Megjithatë, argumentimi i bazuar në hadithin e sipërpërmendur është kontestuar për disa arsye.

1. Hadithi është i diskutueshëm për shkak të vërtetësisë së tij. Në të vërtetë, në zinxhirin e transmetuesve ka dy transmetues (Ibën Lehi'a dhe vëllai i tij Isai), të cilët nuk janë të besueshëm.²⁵ Një hadith i tillë nuk mund t'i kundërvihet hadithit që flet për vakëfnimin e Ymerit, të cilin e kanë shënuar koleksionet relevante përkatëse të hadithit dhe i cili tregon për parevokueshmërinë e vakëfit.
2. Edhe sikur të supozojmë vërtetësinë e tij, hadithi nuk tregon për ndalimin e vakëfnimit apo revokueshmërinë e tij. Sepse vakëflënësit disponon me pasurinë e tij gjatë jetës së tij, si dhe gjatë asaj kohe, trashëgimtari ende nuk e pretendon pronën, sa që të mund të thuhet se vakëfnimi po e bllokoi institucionin e trashëgimisë. E drejta e trashëgimtarit është e lidhur me pronën në dy raste:

²³ Transmeton Tahaviu.

²⁴ Mr. Enes Ljevkovic, Neopozivost i neotudivost vakufa (luzumu'l-vakfi), në Takvim, 2001, Sarajevë.

²⁵ Shevkani, Nejlü- 'l-Evtar, 6/27; Zejle'ijj, Nasbur-rajja, 3/476.

1. Në rast të vdekjes së trashëgimlënësit.
2. Në rast të sëmundjes pa shpresa për shërim (مرض الموت) të pronarit të pronës. Në këtë rastin e dytë, pronari ka të drejtë të disponojë një të tretën e pasurisë së tij, të cilën mund ta lërë me testament, ta dhurojë ose ta vakëfnojë.
3. Nëse vakëfnimi gjatë jetës së vakëflënësit do ta bllokonte trashëgiminë, dhe për rrjedhojë do të ndalohej, i njëjti parim do të zbatohet edhe për veprimet e tjera bamirëse si donacionet - dhuratat, sadakatë, testamentet dhe të tjera të ngjashme, e këtë nuk e ka thënë asnjë nga juristët islamë. Në mënyrë analogjike, i njëjti rregull vlen edhe për vakëfnimin²⁶.

Si përfundim

Nga sa u tha më sipër, mund të konkludohet se vakëfnimi është një bamirësi e parevokueshme, një veprim juridik i njëanshëm që rezulton në kalimin e pronësisë mbi objektin e vakëfnuar në vakëf si person juridik, dhe atë me dispozitë të Sheriatit, si dhe me detyrimin për t'i orientuar të ardhurat dhe frytet e vakëfit për qëllimet e synuara. Ndonëse vakëfnimi është në thelb një akt juridik i lavdërueshëm, konsekuenca e tij juridike është parevokueshmëria e vakëfit dhe detyrimi për t'i shpenzuar të ardhurat për qëllimet e synuara. Ky person juridik, i cili themelohet në bazë të dispozitës ligjore, si pasojë e deklaramit të njëanshëm të vullnetit, është i pavarur nga personi fizik i vakëflënësit, përfituesit të vakëfit dhe nga

²⁶ Mr. Enes Ljevkovic, Neopozivost i neotudivost vakufa (luzumu'l-vakfi), në Takvim, 2001, Sarajevë., El-Karnshavi, Abdul-Xhelil. *Dirasat fi 'l Sheriati 'l islamije*, botime të Universitetit të Benghazi, Benghazi, Libi, pa v.b..

vetë substanca e lëndës së vakëfnuar. Ajo ka ekzistencën e saj të pavarur dhe një subjektivitet juridik të pavarur, me të cilin janë të lidhur të drejtat dhe detyrimet e vakëflënësit, të cilat i përfaqëson muteveliu (drejtuesi) ose mbikëqyrësi i tij (naziri).²⁷

Sipas kësaj, mendimi mbizotërues i shumicës së juristëve islamë është se vakëfnimi është një veprim juridik i përherëshëm i parevokueshëm që rezulton me kalimin e pronësisë te subjekti juridik i vakëfit, e jo që ai të anulohet.

Imam Shevkaniu ka thënë: “Është e vërtetë e pamohueshme se vakëfnimi u përket veprave të mira të cilat nuk lejohet të anulohen pasi të jenë bërë, as vakëflënësit nuk i lejohet dhe as dikujt tjetër.”²⁸

E lus Allahun e Lartësuar, I Cili jep dituri dhe urtësi, që të themi të vërtetën, të ndjekim të vërtetën dhe të luftojmë për të vërtetën. Ta shpjeremi lakminë dhe koprracinë nga zemrat tona dhe t'i hapim zemrat tona ndaj mirësisë dhe ndershmërisë. Asnjë institucion nuk e ka ndihmuar fenë islame aq mirë dhe aq gjatë siç e ka ndihmuar vakëfi. Prandaj, vakëflënësit do të përmenden nga populli i tyre deri në Kiamet. Në çështjen e vakëfit është e domosdoshme të tregohet ndjeshmëri e lartë dhe respekt i veçantë, sepse është amanet hyjnor. Me vu dorë në vakëf është me vu dorë në pronën Allahut të Gjithëpushtetshëm.

Dhëntë i Madhi Zot të bëhemi shërbëtorë të krijesave për hir të Krijuesit! Amin!

²⁷ Osman Nuri Topbash, *Vakëfi, dhurimi dhe shërbimi*, Tiranë, pa vit botimi.

²⁸ Shevkani, Nejlü 'l-Evtar: 6/21 e në vazhdim. Krahaso: Mr. Enes Ljevkovic, Neopozivost i neotudivost vakufa (luzumu'l-vakfi), në Takvim, 2001, Sarajevë.

Dr. Ajni SINANI

KADAJA DHE KADERI

“Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në Tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë (e shënuar) në Libër (Levhi Mah-fudh) para se të ngjajë ajo. Dhe kjo për Allahun është e lehtë.” (El Hadid, 22).

“Nuk ka gjë të fshehtë në qiell e në Tokë, që të mos jetë (e shënuar) në Librin e qartë.” (En Neml, 75).

Allahu xh.sh. zotëron diturinë absolute, prandaj çdo gjë që do të ndodhë, Ai e di që më parë. Besimi në kadanë dhe kaderin është një nga gjashtë shtyllat e imanit. Në hadithin e gjatë, që e transmeton h. Omeri r.a., kur Xhibrili a.s. e pyeti Pejgamberin a.s.: *“O Muhamed, ç’është imani?”* Pejgamberi a.s. u përgjigj: *“Të besosh Allahun, melaqet e Tij, librat e Tij, pejgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit dhe caktimin e së mirës dhe së keqes nga Allahu.”*¹

Tavusi ka përcjellë nga Abdullah b. Omeri këtë thënie të Pejgamberit a.s., se ai ka thënë: *“Çdo gjë është sipas kaderit.”*²

¹ M93 Muslimi, Iman, 1, shih: *“Islami nëpërmjet haditheve 1”*, botoi: Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë dhe Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2017, f. 613.

² M6751, Muslimi, Kader, 18; MU 1629, Kader, 1, shih: *“Islami nëpërmjet haditheve 1”*, op. cit., 615.

Sipas pikëpamjes sunite, në faktin që Allahu i di ngjarjet që më parë, nuk bëhet fjalë për ndonjë detyrim.³

Çështja e formës së veprave dhe të sjelljeve të njeriut, të bëra në kohë dhe hapësirë, në dijen dhe caktimin eternal (e pa fillim dhe pa mbarim) të Zotit, janë çështje për të cilat bëhet përpjekje për t'i zbërthyer ato.⁴

Puna, angazhimi, mundi dhe përpjekja për kërkimin e furnizimit, të ndërruarit e vendit për këtë qëllim, nuk është në kundërshtim me mbështetjen e besimtarit të Zoti xh.sh.. Dorëzimi të Zoti (*tevekkuli*) nuk është braktisje e marrjes së shkaqeve. Këtë më së miri e shpjegon veprimi i Omerit r.a. kur ishte nisur me ushtrinë për në Siri (Sham) dhe kishte marrë vesh se aty mbizotëronte një epidemi, andaj nuk lejoi që ushtria të hynte në Damask. Disa nga të pranishmit i thanë: “A po ikën prej caktimit të Allahut xh.sh.?” Omeri r.a. u përgjigj: “Po iki prej një caktimi të Allahut në caktimin tjetër të Tij.”⁵

Në kuadër të gjithpërfshirjes së caktimit të Allahut, një vend meritore i jepet lirisë dhe përpjekjes njerëzore. Kujdesi dhe marrja e masave parandaluese nuk është në kundërshtim me caktimin e Allahut. Abdurrahman b. Avfi, tregon se Pejgamberi a.s., ka thënë: “Nëse dëgjoni që në një vend ka epidemi, atëherë mos shkoni në atë vend. Ndërsa nëse ju ndodheni

³ Shih: prof. dr. Bekir Topaloglu, “Hyrije në kelam”, Prishtinë, 2002, f. 291-292.

⁴ A. Saim Kilavuz, “Hyrije në apologjetikën islame”, Logos A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2014, f.99.

⁵ Nexhat Ibrahim, “Fjalor enciklopedik islam”, Logos A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2017, f. 441.

në një vend në të cilin ka filluar epidemia, atëherë mos dilni prej tij."⁶

Muhamedi a.s. ia ka tërhequr vërejtjen besimtarëve, të cilët justifikoheshin me kaderin, duke lënë anash rolin dhe përgjegjësinë e njeriut në vepra. Kur Aiu r.a. po bëhej gati të flinte pas namazit të jacisë, Muhamedi a.s. e pyeti atë: "A ngrihesh natën për të falur namazin e natës – tehexhudit?" Aliu r.a. është përgjigjur: "O i Dërguari i Allahut, jeta jonë është në dorën e Allahut, po deshi, na e jep; po deshi, na e merr; po deshi, na zgjon!" Atëherë Pejgamberi a.s., duke i zënë me pëllëmbë gjunjët e Aliut r.a., ka thënë: "*Sa shumë po përpiqet njeriu!*" (Buhariu). Kështu Pejgamberi a.s. shprehu pakënaqësinë e tij ndaj perceptimit justifikues të kaderit nga ana e Aliut r.a..⁷

Ebu Huzame, përcjell se babai i tij e ka pyetur Pejgamberin a.s.: "O i Dërguari i Allahut, leximet që i kemi bërë me qëllim shërimi, kurat që kemi përdorur gjatë mjekimit dhe masat parandaluese që kemi marrë, a e kthejnë caktimin e Allahut?" Pejgamberi a.s. i është përgjigjur: "*Edhe ato janë caktim i Allahut!*"⁸

Imami Ebu Hanife, përmend çastin kur njerëzit ishin në botën e shpirtrave, meqenëse zotëronin vullnet dhe mundësi zgjedhjeje. Zoti atyre u është drejtuar me pyetjen: "***Elestu bi Rabikkum?***". "*A s'jam Unë Zoti juaj?*"⁹ Ai, Ebu Hanife, ka

⁶ MU1621, Muvatta, Xhami, 7; M5784 Muslim, Selam, 98, sipas "Islami nëpërmjet haditheve 1", op. cit., f. 617.

⁷ Nexhat Ibrahim, "Fjalor enciklopedik islam", op. cit., f. 436.

⁸ T2065 Tirmidhi, Tib, 21, sipas "Islami nëpërmjet haditheve 1", op. cit., f. 623.

⁹ Kadir Misiroglu, "Botëkuptimi islam", op. cit., f. 404.

thënë: “Allahu xh.sh. i nxori pasardhësit e Ademit nga kurri i tij, në formë grimce, duke i bërë ata të arsyeshëm, pastaj u është drejtuar duke i urdhëruar (me besim), dhe duke i ndaluar (nga mosbesimi), ndërsa ata e pranuan Hyjninë e Tij. Ky akt i tyre është besimi i tyre i natyrshëm.”¹⁰

Prandaj, *kadaja* dhe *kaderi* nuk kanë të bëjnë me fatalizmin, sepse Allahu Fuqiplotë gjithsesi e di se çfarë do të bëjnë robërit, i di punët e tyre dhe se çfarë do të ndodhë në pronën e Tij. Zoti ka cilësinë e dijes absolute, që do të thotë se Zoti di gjithçka. Kjo dije e Tij absolute është cilësi që i shpalos gjërat ashtu siç janë ose se si do të ndodhin më vonë. Imam Neveviu, në komentimin e Sahihut të Muslimit, tregon: “Hatabiu ka thënë: “Shumë njerëz mendojnë se nocioni *kada* dhe *kader* është shtrëngim dhe detyrim nga Allahu që njerëzit të bëjnë atë që Ai ka caktuar më parë. Por, nuk është ashtu siç supozojnë, ngase domethënia e tyre është lajmërim për atë se Allahu e di se çfarë do të veprojnë njerëzit dhe se ato kryhen me caktimin e Tij.”¹¹

Caktimi i fatit nuk vjen në kundërshtim me vullnetin e lirë. Caktimi i fatit nuk do të thotë shtrëngim dhe detyrim në atë që nuk është në karakterin e njeriut. Allahu e mohon detyrimin: “*Nëse kishim dashur, Ne, nga qielli do t’ua zbritnim një shenjë para së cilës ata do t’i ulnin qafat e tyre.*” (*Esh Shu-*

¹⁰ Nexhat Ibrahim, “Akaidi i Ebu Hanifes”, Prizren, 2017, f. 101; Kadir Miroglu, “Botëkuptimi islam”, Progresi, Shkodër, 2008, f. 367.

¹¹ Prof. Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, “Të vërtetat e patundshme të besimit islam (Detyrimet e njeriut ndaj Krijuesit)”, Tetovë, Asr, 2004/1425., f.151.

ara, 4). Pra, Allahu ka mundur që t'i detyrojë njerëzit në besim, por këtë nuk e ka bërë, sepse:

“Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota...” (El Bekare, 156); “Sikur të kishte dashur Zoti yt, do të besonin çka janë në Tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?” (Junus, 99).

Zoti Fuqiplotë e i Gjithëdijshëm, e ka ditur që në pafillmësi se akëcili, kur ta krijojë, do ta zgjedhë rrugën e mirë, rrugën e mësimit e zbatimit të urdhrave të Zotit. Kështu kur njeriu i bën punët e tij me dashje a vullnet, ai në të vërtetë vepron ashtu siç e ka ditur dhe e di Zoti xh.sh., por jo i shtyrë e i detyruar, por vetëm sipas mendjes së tij.¹²

Hadithi ku thuhet: *“Lapsat janë ngritur (është dhënë vendimi) dhe fletët janë tharë (çështja ka marrë fund),”*¹³ e tregon qartë se nuk mund të ngelë asgjë jashtë dijes së Zotit.

Allahu xh.sh. i ka ditur të gjitha hollësitë e jetës sonë ende pa u krijuar ne, gjithashtu, nga para zanafilla e di dhe drejt cilave vepra do të orientohet zgjedhja jonë. Dija para zanafillore e Allahut nuk është ndërhyrje paraprake te ngjarjet.¹⁴

Njohja e një gjëje nga Allahu para se të ndodhë nuk është imponim ose determinim, por është rrjedhojë e mos kushtëzimit të Tij nga koha dhe hapësira. Njohja nga Allahu e gjërave që kanë për të ndodhur, nëse mund të shprehemi, i ngjet

¹² Shejh Vehbi S. Gavoçi, “Nyja e besimit sipas Imam Tahaviut”, Logos A, 2015, f. 80.

¹³ HM 2669 Ibën Hanbel 1, 293; Tirmidhi, Sifatu'l-kijame, 59, sipas “Islami nëpërmjet haditheve 1”, op. cit., f. 622.

¹⁴ “Islami nëpërmjet haditheve 1”, op. cit., f. 622.

njohjes nga bujku i bimës që ka për të mbirë nga fara që ka hedhur në tokë, ngaqë i njeh veçoritë e farës.¹⁵

Kadaja dhe domethënia e saj

Shprehja *kada*, në kuptimin etimologjik, do të thotë urdhër, vendim, kryerje dhe krijim. Kurse në kuptimin terminologjik, sipas maturidive,¹⁶ nënkupton krijimin dhe paraqitjen koherente të gjërave nga Allahu xh.sh. në kohë dhe vend të caktuar, atëherë ku Ai do dhe cakton të bëhen, të gjitha në përputhje me dijen, vullnetin dhe përcaktimin e Tij. Pra *kadaja* ka të bëjë me atributin hyjnor të krijimit dhe të shpikjes (*tekin*).¹⁷

Imam Ebu Hanife ka thënë: “Caktimi (*el kada*), dhe përcaktimi (*el kader*) dhe vullneti (*meshi’e-tu*), janë cilësitë e Tij të amshueshme, pa (modalitetin) si. Allahu i Madhëruar e di jo ekzistuesen (*el ma’dum*) në gjendjen e saj të jo ekzistimit dhe Ai e di se si do të jetë ajo kur ta sjellë atë në ekzistencë. Allahu i Madhëruar e di ekzistuesen (*el mevXHud*) në gjendjen e saj të ekzistimit si ekzistuese dhe Ai e di se si do të jetë shkatërrimi i saj (*fena*).”¹⁸

¹⁵ Kadir Misirogllu, “Botëkuptimi islam”, op. cit., f. 368.

¹⁶ Kadaja, sipas esharive, ndërlihet me vendimin-dispozitën dhe në shfaqjen e më vonshme të gjërave. Shih: A. Saim Kilavuz, op. cit., f. 113; Sipas R. Butit, kadaja shpreh dijen e Allahut të Gjithëdijshëm që nga përjetësia (ezeli) për të gjitha gjërat se çfarë do të ndodhin në të ardhmen. Shih: prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit., f., 150; Sipas Kadir Misirogllut, kadaja shpreh realizimin e atij evenimenti kur i vjen koha. Shih: Kadir Misirogllu, op. cit., f. 361.

¹⁷ A. Saim Kilavuz, op. cit., f.113.

¹⁸ Nexhat Ibrahim, “Akaidi i Ebu Hanifes”, op. cit., f. 97-98.

Kaderi dhe domethënia e tij

Në kuptimin etimologjik, fjala *kader*, do të thotë masë, sasi, veprim, në bazë të masës së caktuar, caktim. Në kuptimin terminologjik, sipas maturidive,¹⁹ kaderi nënkupton pikëpamjen sipas së cilës Allahu xh.sh., me dijen e Tij eternale, e di kohën dhe vendin, karakteristikat dhe mënyrën se si do të ndodhin të gjitha gjërat. Kaderi ndërlidhet ngushtë me dijen dhe dëshirën e Allahut xh.sh. dhe si i tillë shpreh rregullsinë e gjithësisë dhe të gjërave brenda saj.²⁰

Allahu xh.sh. thotë: ***“Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të caktuar.”*** (*El Kamer, 49*).

Ky ajet tregon se çdo gjë e mirë apo e keqe, e hidhur apo e ëmbël, e gjallë apo jo e gjallë, e dobishme apo e padobishme, është e krijuar me dijen, dëshirën, fuqinë dhe krijimin e Allahut xh.sh.. Gjithësia është e krijuar nga Krijuesi që ka dije, fuqi, dëshirë dhe urtësi. Ajo nuk udhëhiqet nga kaosi, por nga kaderi/masa, ekuilibri dhe sistemi.²¹

Me fjalë të tjera, kaderi është “planifikim dhe programim nga Krijuesi i Lartë, që zotëron dijen e pasosur, që sheh dhe di të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen si një pikë të vet-

¹⁹ Kaderi, sipas esharive, ka kuptimin e krijimit të gjërave në kohë të caktuar nga Allahu xh.sh. në ujdë me dijen e Tij eternale. Shih: A. Saim Kilavuz, op. cit., f.113;

Sipas R. Butit, nocioni kader, shpreh realizimin e atyre gjërave në akte dhe kjo në përputhje me dijen e përjetshme të Allahut që është e lidhur me ato gjëra. Shih: prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti, op. cit., f. 150;

Sipas Misirogllut, kaderi shpreh vendimin hyjnor të parashkruar, në Levhi mahfudh të një evenimenti. Shih: Kadir Misirogllu, op. cit., f. 361.

²⁰ A. Saim Kilavuz, op. cit., f. 99.

²¹ “Islami nëpërmjet haditheve 1”, op. cit., f. 618.

me dhe për Allahun xh.sh. nuk ka të shkuar, të tashme dhe të ardhshme.²² *“Ai është që di të fshehtën dhe të dukshmen, Ai është i Madhëruari e i Lartësuari.”* (Er Rra'd, 9).

Shumë dijetarë janë të mendimit se kadaja dhe kaderi janë të pandashme, sikurse themeli dhe konstrukti i ndërtesës, dhe kush synon ndarjen e tyre, synon edhe rrënimin e ndërtesës.²³

Njeriu ka qëllimin, kurse Allahu mundëson realizimin e tij

Njeriu jeton në një botë me kohë dhe hapësirë. Edhe mendimet dhe idetë e tij janë të kufizuara në kohë dhe hapësirë. Për pasojë, ai nuk e rrok të vërtetën dhe dijen e Allahut që është përtej kohës dhe hapësirës.

Zoti me dijen e tij absolute e di se çfarë ka për të bërë secili, çfarë ka dëshiruar në mënyrë vullnetare, realizimin praktik dhe konkret të saj. Allahu i jep secilit atë që është në qëllimin e tij, i dëshiron atë çka e dëshiron dhe e zgjedh vetë robi. Zoti e cakton dhe e parashkruan atë që synon dhe dëshiron robi, sipas qëllimit që ka:²⁴ *“Nëse Allahu e di se në zemrat tuaja ka diçka të mirë, do t’ju japë më mirë se ajo që është marrë nga ju...”* (El Enfal, 70); *“Kurse ata të cilët janë në rrugë të drejtë, Ai atyre u shton edhe më udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u jep mundësi të jenë edhe më të devotshëm.”*

²² Nexhat Ibrahim, “Fjalor enciklopedik islam”, op. cit., f. 436.

²³ Naim ef. Tërnav, “Besimi Islam, shtyllat dhe veçoritë 2”, Prishtinë, 2020, f. 77.

²⁴ Dr. Mustafa Mahmud, “Dialogu me mikun ateist”, Sira, Prishtinë, 2018, f. 35.

(Muhamed, 17); “Sa i përket atij që jep dhe ruhet (nuk gabon) dhe atë më të bukurën e konsideron të vërtetë, atij do t’ia lehtësojë. Ndërkaq, ai që është koprrac dhe ndihet i mëvetësi-shëm, dhe atë më të bukurën e konsideron gënjeshtër, atij do t’ia lehtësojë për në vështirësi.” (El Lejl, 5-10).

Në këto ajete tregohet për qëllimin që i përket njeriut. Nëse qëllimi është i mirë, Allahu ia mundëson realizimin me të mirë, e nëse është i keq ia mundëson me të keq: *“Në zemrat e tyre kanë sëmurje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë...” (El Bekare, 10).*

Ajeti vijues tregon se akti i të gjuajturit identifikohet me gjuajtjen e bërë nga Allahu xh.sh.:

“Ti nuk gjuajte kur gjuajte, por gjuante Allahu...” (El Enfal, 17).

Allahu na mundëson dhe realizon atë që e kemi zgjedhur në zemrat tona dhe ashtu sikurse edhe janë qëllimet tona, prandaj nuk ka shtrëngim në diçka që nuk është në pajtim me përzgjedhjen tonë.²⁵

Zoti na jep pavarësi dhe kërkon përgjegjshmëri

Tema e fatit është mjaft e vjetër. Është një pyetje mjaft e hershme se, nëse njeriu është pa vullnet të lirë (*musejjer*) apo, nga ana tjetër, ka mjaft vullnet të lirë. Ngjashëm është edhe me paracaktimin e fatit (*xhebr*) dhe zgjedhjen e lirë (*ih-tijar*).²⁶

²⁵ Po aty, f. 36.

²⁶ Muhamed Mutevel’li esh Sharavi, el Kadau vel kader, Darush Shuruk, Kaj-ro 1399/1979, f.43.

Prej vetë natyrës sonë, ne kuptojmë se kemi përgjegjësi për zgjedhjet tona. Liria e zgjedhjes është parakusht i përgjegjësisë njerëzore. Lira e zgjedhjes buron prej ‘autonomisë’ me të cilën Krijuesi ka mbrujtur llojin tonë.²⁷ Njerëzit për dallim nga kafshët, bimët, apo gjallesat e tjera, janë qenie me vullnet pjesërisht të lirë. Është kjo liri që i bën ata përgjegjës para urdhëresave të Zotit. Prandaj, llogaridhënia dhe pyetja ‘përse e bërë këtë?’ ka kuptim vetëm atëherë kur kemi liri për të zgjedhur.

Zoti e krijoi njeriun, shenja dalluese e të cilit është liria. Lira është thelbi dhe bërthama e të qenit njerëzor. Ne jetojmë duke u brengosur vazhdimisht brenda vetvetes dhe duke marrë vendime mes asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar. **Melaqet** bëjnë vetëm të mira, por kjo ndodh sepse nuk kanë mundësi të bëjnë të këqija. **Kafshët** janë të përjashtuara nga beteja e vazhdueshme brenda vetvetes, ato i përgjigjen gjithçkaje që duan të bëjnë. Krijesat e tjera i nënshtrohen programimit, ne, qeniet njerëzore kemi mundësinë e përzgjedhjes së lirë dhe kjo është fisnikëria e njerëzimit.²⁸

Zoti na përshkruan se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe

Ne nuk jemi krijesa të përkryera, as nuk u përcaktuam të ishim të tilla. Shpesh munda ynë nuk është i pagabueshëm. Jeta jonë është betejë e përhershme. Prandaj është e arsyeshme që Zoti t’i pranojë përpjekjet tona, t’i çmojë ato dhe të na dojë si krijesat e tij më fisnike. Ai do të na shihnte të kalojmë

²⁷ Hassan Hathout, “Leximi i mendjes së myslimanit”, Tiranë, 2006, f. 6.

²⁸ Po aty, f. 6.

sprovën e përgjegjshmërisë, pavarësisht nga lira jonë e zgjedhjes. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është të kuptojmë vazhdimisht se tek Ai është streha e mbramë, se çfarë është e mirë dhe çka është e keqe, ashtu siç na përshkruan Ai.²⁹

E mira dhe e keqja është në kuadër të vullnetit të Zotit

Çdo gjë që ne e bëjmë është në kuadër të Vullnetit të Zotit, qoftë e mirë apo e keqe. E mira që veprojmë është në pajtim me kënaqësinë e Allahut, ndërkaq e keqja nuk është në pajtim me kënaqësinë e Tij. Njeriu është i lirë të bëjë diç që i kundërvihet kënaqësisë së Allahut xh.sh., por ai s'mund të bëjë asgjë që i kundërvihet vullnetit të Allahut xh.sh..³⁰

Kaderi absolut dhe i kushtëzuar

Kaderi ndahet në dy lloje: absolut dhe i kushtëzuar. *Kaderi absolut* përfshin tërë botën materiale, nga atomet tek yjet e panumërta në kozmos dhe në tërë gjithësinë. Tërë kjo botë materiale, meqenëse s'ka vullnet dhe aftësi zgjedhëse, lëviz si robot me lëvizje të përcaktuara nga Zoti. Ky është ligji i Zotit – *sunnetullah*: “**Në krijimin (aktin krijues) e Mëshiruesit nuk mund të gjesh asnjë parregullsi.**” (*El Mulk*, 3). Pra, bota materiale-lëndore ndodhet nën zotërimin e kaderit absolut. Këtu përfshihet edhe qenia materiale e njeriut, pra trupi i tij.³¹

²⁹ Ismail R. Al Faruqi dhe Lois Lamya Al Faruqi “Atlasi kulturor islam”, Logos A, Shkup-Prishtinë-Tiranë, 2018, f. 303.

³⁰ Dr. Mustafa Mahmud, op. cit., f. 31-32.

³¹ Kadir Misiroglu, op. cit., f. 369.

Kaderi i kushtëzuar

Në kaderin e kushtëzuar (pezull), bëjnë pjesë aktet dhe veprat e fushës së lirë që kanë të bëjnë me qeniet e pajisura me vullnet të lirë (njerëzit dhe xhinët). Njeriu është lloj dhe krijesë që mban përgjegjësi për çdo veprim vetjak, ngase posedon lirinë e përzgjedhjes. Përgjegjësia e njeriut ka të bëjë me aktet dhe veprimet ku ai e përdor lirshëm vullnetin e tij.³² Aty ku njeriu ka një mundësi për të kryer ose mos kryer një vepër, ka të drejtë të zgjedhë, aty vjen në shprehje vullneti i tij.

Njeriu ka veprime të pavullnetshme dhe të vullnetshme

Njeriu ka dy lloje të veprimeve, veprime me detyrim dhe veprime të vullnetshme. Ehlu Suneti (maturiditë dhe esharitytë), detyrimet i ndajnë në veprime të detyrueshme të pavullnetshme dhe veprime të vullnetshme me zgjedhje të lirë.³³

1. *Veprime të detyrueshme të pavullnetshme.* Këto bëjnë pjesë në kaderin e njeriut dhe janë caktuar nga Allahu me dijen, vullnetin dhe fuqinë e Tij që në pafillimësi. Për she-mbull, rrahja e zemrës, frymëmarrja, puna e trurit etj., janë reflekse të pavetëdijshme dhe, natyrisht, të pavullnetshme, respektivisht janë rezultat i vullnetit dhe i përcaktimit hyjnor dhe njeriu nuk ka përgjegjësi për punën e tyre.³⁴ Njeriu nuk ka kurrfarë roli në vendosjen se prej cilëve prindër, në cilin vend, në çfarë kohe, në çfarë qyte-

³² Po aty, f. 404.

³³ A. Saim Kilavuz, op. cit., f. 115.

³⁴ Nexhat Ibrahim, "Fjalor enciklopedik islam", op. cit., f. 440.

tërimi e kulture, populli e gjendje, do të lindë. Këto janë të paracaktuara dhe janë pjesë e jetës (fatit) tonë. Në këto çështje nuk jemi të ngarkuar me përgjegjësi dhe nuk vihemmi në provë. Për rrjedhojë, për këto as nuk shpërblehemi dhe as nuk ndëshkohemi.³⁵

2. *Veprime të vullnetshme me zgjedhje të lirë.* Grupi i dytë ndahet në dy nëngrupe:

A. *Rregullat hyjnore natyrore dhe fetare* nga të cilat varen veprat tona që i bëjmë me vullnet dhe zgjedhje të lirë. Të gjithë pajtohen se ligjet natyrore dhe fetare janë të caktuara prej Allahut, sepse njeriu nuk ka as fuqi, as mundësi, as aftësi e afinitet që t'i caktojë rregullat e natyrës dhe të fesë nga të cilat varen veprimet e vullnetshme.³⁶

Çështja e rregullave të natyrës, mund të kuptohet më mirë nga rasti i kalifit të dytë, Omerit r.a.. Ai nuk kish-te lejuar që ushtria të hynte në Damask, sepse aty ishte përhapur epidemia. Epidemia është një rregull natyror në të cilin nuk mund të ndikojmë dhe ne mund të veprojmë sipas ligjit të Allahut të vendosur në natyrë. Njeriu nuk ka mundësi të dalë jashtë kornizave të këtij ligji të Allahut. Ai duhet të përdorë vullnetin e tij të lirë dhe duhet të mos hyjë në vendet ku ka epidemi dhe në këtë mënyrë ta mbrojë veten e tij.³⁷

Edhe normat dhe vendimet fetare me të cilat janë të lidhura veprimet tona të vullnetshme janë të caktuara

³⁵ A. Saim Kilavuz, op. cit., f. 115.

³⁶ Nexhat Ibrahimî, "Fjalor enciklopedik islam", op. cit., f. 441.

³⁷ Shih: A. Saim Kilavuz, op. cit., f. 116.

prej Allahut. Njeriu nuk ka kurrfarë ndikimi në to. Ato realizohen sipas paracaktimit hyjnor. Për shembull, shpërblimi i atyre që kryejnë obligime fetare dhe ndëshkimi i atyre që i shkelin ato. Këtu njeriu s'mund të ndryshojë gjë. Atij i mbetet që me vullnetin dhe përzgjedhjen e tij të lirë t'i kryejë ato obligime.³⁸

- B. *Veprat tona origjinale të lira*. Veprimet e vullnetshme të njeriut janë të shkruara paraprakisht dhe ka ujdi mes dijetarëve myslimanë lidhur me atë se njeriu është i lidhur për një fat të paracaktuar nga Zoti. Maturiditë, rreth asaj se si mund të arrijmë të ndërldhim dijen, vullnetin dhe caktimin hyjnor, që janë tejkohor dhe tejhapësinor, me veprat e njeriut, të cilat janë në kuadër të kohës dhe hapësirës, kanë ofruar një sqarim të kapshëm e të logjikshëm lidhur me dimensionin njerëzor në caktimin hyjnor. Ata thonë se çdo gjë që ekziston në këtë botë është bërë me dijen, vullnetin, caktimin dhe krijimin e Allahut xh.sh.. Kjo domethënë që Allahu, me dijen e Tij të amshueshme, e di se çka dhe në cilën kohë njerëzit do të zgjedhin dhe dëshirojnë, dhe në kuadër të dijes së Tij i dëshiron të njëjtat gjëra, e pastaj, varësisht vullnetit të njeriut në kohën dhe vendin e caktuar i krijon ato vepra. Kjo nuk është dhunim i vullnetit të njeriut, por pasim i vullnetit të njeriut.³⁹

³⁸ Shih: A. Saim Kilavuz, op. cit., f. 116.

³⁹ Shkolla maturidite, konceptin e lirisë e njuh në konceptin *el ihtijar* (zgjedhje), që është veprim, jo në konceptin '*hurrijjeh*' që është gjendje. Veprimi i nënkuptuar në *ihtijar* është ai i bërjes së zgjedhjes, jo midis shumë alternativave, por midis dy alternativave: së mirës dhe së keqes. Për shkak se *ihtijari* është i lidhur në kuptimin me *hairin*, që do të thotë "e mirë", zgjedhja që është nënkuptuar në *ihtijar* është zgjedhja e asaj që është e mirë, më e

Allahu i ka çliruar zemrat tona nga çfarëdo imponimi

Allahu i ka çliruar zemrat tona nga çfarëdo detyrimi, duke i lënë të lira. Prandaj, Zoti e ka bërë qëllimin-nijetin, vendndodhja e të cilit është zemra, shtyllë të përgjegjësishë. Besimtari i cili nën presion mohon, nuk do të merret në përgjegjësi: “... *me përjashtim të atij që detyrohet (për të mohuar), kurse zemra e tij është e bindur plotësisht me besim...*” (En Nahl, 106.)⁴⁰

Njerëzit ndërlihen me njëri-tjetrin sipas ligjeve morale dhe shoqërore, të cilat shpallja i paraqet si urdhëresa dhe nënshtrime, e ndaj të cilave njeriu vepron me vullnetin e tij të lirë. Në obligimet që ka dhënë Zoti nuk ka shtrëngim. Në të vërtetë, nënshtrimi ndaj tyre, nëse nuk është i lirë, është i pavlerë. Njeriu mund të mos i kryejë urdhëresat fetare, ose ai mund t’i realizojë ato vullnetarisht për hir të Zotit. Përmbushja e tillë i jep njeriut një meritë tjetër më të lartë sesa të gjitha krijesat e tjera. Kjo është ajo meritë që myslimani e quan dimensionin moral, e kundërta është amorali.⁴¹

Njeriu me vullnetin e tij e pranoi amanetin, sikurse tregon Allahu xh.sh. në Kuran: “*Ne i afruam amanetin qiejve, Tokës dhe maleve, e ata nuk deshën ta merrnin përsipër atë, dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu e mori mbi vete.*” (El Ahzab, 72).

mirë, apo shumë më e mira mes dy alternativave. Shih: Nexhat Ibrahim, “Fjalor enciklopedik islam”, op. cit., f. 441.

⁴⁰ Dr. Mustafa Mahmud, op. cit., f. 31-32.

⁴¹ Ismail R. Al Faruqi dhe Lois Lamya Al Faruqi, op. cit., f. 303.

Zoti e pajisi njeriun me dije: “**Zoti ia mësoi Ademit** (njeriut) **emrat e sendeve...**” (*El Bekare, 31*). Kjo është arsyeja e favorizimit të njeriut ndaj krijesave të tjera dhe përse Zoti i urdhëroi engjëjt t’i përuleshin Ademit, ndonëse engjëjt janë të mbrojtur nga mëkati, ndërsa Ademi jo.⁴²

Caktimi i Allahut në bazë të dëshirës së njeriut

Njeriu nuk është në mënyrë absolute krejtësisht i lirë në të gjitha veprimet e tij, por as nuk është në mënyrë absolute i privuar nga kjo liri, ai nuk lëviz si robot. Ka evenimente që janë domosdoshmëri dhe njeriu nuk ka dorë në to si p.sh. furnizimi me pjesë nga të mirat (rrësku), koha kur vjen në jetë, prindërit, jetëgjatësia, fizionomia, vendi ku ka lindur, përkatësia nacionale, çasti i fundit etj..⁴³ E njëjta gjë ndodh edhe me ndjenjat e tij, lëvizjen dhe qarkullimin e mekanizmit të trupit. Ne nuk dimë se si mushkëritë e kryejnë vetë funksionin e tyre, si qarkullon gjaku etj.. Mëshira e Zotit deshi dhe dëshiroi të na krijonte pa vullnet të lirë në të gjitha këto, që ne të mos kemi pjesë në këto çështje shumë të rëndësishme. Sistemi trupor i bën detyrat e veta edhe kur jemi në gjumë, prandaj, nëse do të kishim lirinë e zgjedhjes dhe të drejtimit, kush do ta vinte atë sistem në funksion gjatë kohës që jemi duke fjetur?⁴⁴

⁴² Hassan Hathout, op. cit., faqe 6-8.

⁴³ Kadir Misiroglu, op. cit., f. 405.

⁴⁴ Muhamed Mutevel’li esh Sharavi, op. cit., 1979, f. 50.

Njeriu nuk ndikon dot te Dielli, as te Hëna, sepse kjo ka të bëjë me lirinë absolute që i përket vetëm Zotit. Në disa fusha dhe në disa gjëra, nuk ka mundësi për një zgjedhje më të gjerë për kryerjen apo moskryerjen e tyre, sepse janë segmente ku mendja jonë nuk ka kurrfarë ndikimi. Çdo njeri krijohet, normalisht, si specie më e përparuar, dhe ai ruan në vete disa tipare të natyrës shtazore, të natyrës bimore, si dhe të natyrës së pajetë. Në atë pjesë ku njeriu ka elemente të caktuara të botës së palëvizshme, jetës bimore dhe shtazore, ai është pa vullnet të lirë, (*musejjer*) njëlloj sikurse edhe ato specie.⁴⁵ Prandaj, Allahu xh.sh. nuk do të na kërkojë përgjegjësi për të gjitha këto që janë jashtë kompetencave tona.⁴⁶

Gjithsesi, njeriu posedon lirinë relative në planin e obligimeve. Kjo liri është realitet dhe te ne e dëshmon ndjenja e lindur për të. Ne ndiejmë përgjegjësi, pendim dhe brejtje të ndërgjegjes për gabimin e bërë, ndërsa kënaqësi kur bëjmë punë të mira. Ne vendosim mes gjërave të mundshme dhe detyra e parë e arsyes sonë është zgjedhja dhe përcaktimi ndërmjet disa alternativave.⁴⁷

Udhëzimi (*hidajeti*) në kuptimin e të treguarit dhe në kuptimin e mbështetjes

Në vazhdim do të shtjellojmë *hidajetin* në bazë të trajtimit që i ka bërë shejh Sharaviu. Ai vë në dukje se ka një ndryshim midis *hidajetit* që tregon dhe rrëfen diçka dhe *hida-*

⁴⁵ Muhamed Mutevel'li esh Sharavi, op. cit., f. 51.

⁴⁶ Dr. Mustafa Mahmud, op. cit., f. 30.

⁴⁷ Po aty, f. 23.

jetit që nënkupton inkurajimin dhe ndihmën. *Hidajeti* që ka kuptimin e të treguarit, ka një pjesë të përbashkët si te besimtarët ashtu edhe te jobesimtarët.⁴⁸

Allahu xh.sh. pohon: **“Sa i përket Themudit. Ne atyre u patëm treguam rrugën e drejtë, por ata megjithatë më shumë e deshën verbërinë, se udhëzimin, andaj ata i kapi tmerri i dëniimit të turpshëm për shkak të asaj që vepruan.”** (Fussilet, 17).

Nëse shohim fillimin e ajetit **“Sa i përket Themudit. Ne atyre u patëm treguam rrugën e drejtë...”** - **“fe hedejnahum”**, do të vërejmë se Allahu i Madhëruar në vazhdim ka thënë: **“por ata megjithatë më shumë e deshën verbërinë, se udhëzimin”** - **“festehabbul - a'ma a'lel-huda”**.

Në këtë rast, pjesa e shkurtër **“Sa i përket Themudit. Ne atyre u patëm treguam rrugën e drejtë”**, nuk është në kuptimin: **“I kemi inkurajuar dhe ndihmuar në rrugën e drejtë”**, por ka kuptimin: **“Ne i treguam Themudit rrugën që do i shpie ata drejt së mirës dhe paqes. Mirëpo ata nuk ndoqën rrugën që iu tregua!”**⁴⁹

Pra, në Kuran përmendet fjala *hidajet* në kuptimin e të treguarit të rrugës që të çon drejt lumturisë dhe së mirës. Dhe gjithashtu fjala *hidajet* përmendet edhe në një kuptim tjetër, që është nxitja dhe ndihma (*temkini*) për të bërë vepra të mira.

Që ta kuptojmë më qartë, le të imagjinojmë, për shembull - dhe Allahu është shembulli më i lartë (*methelul-e'ala*) - se duam të udhëtojmë për Prishtinë, por nuk e dimë se cilën rrugë duhet të marrim për të arritur në destinacionin e dëshiruar. P.sh. një polic trafiku na afrohet duke na thënë: “Kjo është

⁴⁸ Muhamed Mutevel’li esh Sharavi, op. cit., f. 52.

⁴⁹ Po aty, f. 52.

rruga për në Prishtinë!” Pra, ai na udhëzon dhe na tregon rrugën me fjalët e tij. Pasi i besojmë fjalëve të tij dhe e falënderojmë për këshillën e dhënë, kur nisemi për udhëtim, polici na thërret përsëri dhe na thotë: “Dëgjoni, ka pengesa në këtë rrugë dhe do të ishte mirë nëse do të vepronit me kujdes për t’i shmangur disi ato pengesa.”⁵⁰

Nga kjo kuptohet se ka dy lloje të udhëzimit (*hidajetit*). Udhëzimi i parë vetëm na tregon se në cilën rrugë duhet të shkojmë, ndërsa udhëzimi i dytë gjithashtu dëshiron të na ofrojë ndihmë për t’i kapërcyer ato pengesa në rrugë.

Prandaj, në shembullin e mësipërm, polici i trafikut mund të ndihmojë vetëm ata që i besojnë dhe e përfillin këshillën e tij, se cila është rruga që duhet shkuar. Ndërkaq, ai nuk mund të ndihmojë atë person që nuk ia veshin dhe vepron kokë më vete, që refuzon dhe i thotë policit se ju nuk dini se në cilën rrugë duhet të shkohet!⁵¹

Sa i përket *hidajetit* në aspektin e tregimit dhe të kallëzimit të rrugës në të cilën arrihet lumturia dhe e mira, Allahu i Madhëruar ia ka treguar mbarë njerëzimit, pa përjashtim, besimtarëve dhe jobesimtarëve. Dhe më pas, kushdo që pranon këtë udhëzim dhe beson se Allahu është Zoti i tij dhe i bindet Atij, Allahu do ta nxitë dhe do ta ndihmojë në misionin e tij dhe do t’ia lehtësojë rrugëtimin jetësor.⁵²

Hidajeti i përmendur në ajetet kuranore ka kuptim të dyfishtë, *hidajet* në kuptimin e udhëzimit dhe *hidajet* në kuptimin e mbështetjes dhe ndihmës. Allahu xh.sh. ka konfirmuar dhe

⁵⁰ Po aty, f. 50.

⁵¹ Po aty, f. 52.

⁵² Po aty, f. 52.

vërtetuar qartë për Pejgamberin a.s. *hidajetin* në kuptimin e udhëzimit dhe tregimit të rrugës që duhet ndjekur, kur tha: **“Vërtet, ti udhëzon për në rrugën e drejtë.”** (*Esh Shura, 52*), **“In-neke le-tehdi”** **“Vërtet, ti udhëzon!”** Pra, i Dërguari i Allahut ua kallëzon dhe ua tregon njerëzve rrugën e drejtë të Zotit.⁵³

Ndërkaq, nëse ata do ta ndjekin rrugën e drejtë apo jo, nëse do ta besojnë Allahun apo jo, kjo është një çështje krejtësisht tjetër dhe nuk është në dorën e Pejgamberit a.s.. I Dërguari i Allahut nuk mund t’i bëjë dhe as t’i ndihmojë ata që të udhëzohen. Në ajetin vijues, Allahu xh.sh., thotë: **“Ti, vërtet, nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Allahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.”** (*El Kasas, 56*).

Pra, ai që beson udhëzimin e Allahut dhe pranon programin e Tij, Allahu do t’ia lehtësojë dhe do ta ndihmojë: **“Allahu i forcon ata që besuan me fjalën e fortë (e mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët Allahu i bën të humbur, Allahu punon çka të dojë.”** (*Ibrahim, 27*); **“Kurse ata që janë në rrugën e drejtë, Ai atyre u shton edhe më udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë më të devotshëm.”** (*Muhamed, 17*); **“...Allahu nuk e udhëzon popullin jobesimtarë.”** (*El Bekare, 264*).

Nga ajetet e përmendura na bëhet e qartë se *hidajeti* në kuptimin e udhëzimit ka të bëjë me secilin, dhe çdo personi i tregohet rruga, ndërsa *hidajeti* në kuptimin e nxitjes dhe inkurajimit (*elhamlu a'lal hajri*) në të mirë, i referohet vetëm atij që beson Allahun dhe pranon udhëzimin e Tij.⁵⁴

⁵³ Po aty, f. 51.

⁵⁴ Po aty, f. 52.

Vehbi Sylejman GAVOÇI

FEJA, ÇËSHTJE VENDIMTARE NË FORMIMIN SHPIRTËROR TË NJERIUT

1. Feja (Islami) është natyrshmëri e njeriut

Zoti i Madhëruar e krijoj njeriun në natyrshmërinë e besimit (imanit), të mishëruar në natyrshmërinë e besimit në Zotin Një, Allahun xh.sh.. Prandaj, nëse njeriu mbetet në këtë natyrshmëri të shëndoshë, nuk do të zgjedh tjetër, përveç besimit në Allahun e Madhëruar, ashtu siç dëshmoi Allahu i Madhëruar në Kuran:

فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا ۚ فِطْرَتَ اللَّهِ الَّتِي فَطَرَ النَّاسَ عَلَيْهَا ۚ
لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ اللَّهِ ۚ ذَٰلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا
يَعْلَمُونَ

“Përqendroje vetveten tënde singërisht në fenë e pastër nga çdo e kotë! Fe e Allahut, kjo në të cilën i krijoj njerëzit. S’ka ndryshim të asaj natyrshmërie të krijuar prej Allahut. Kjo është feja e drejtë, mirëpo shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Err Rrum, 30).

Ndërsa Pejgamberi a.s. ka thënë: “Çdo fëmijë lind në natyrshmërinë e besimit (Islamit), e pastaj prindërit, atë, ose e bëjnë të besimit hebre, të krishterë apo zjarrputist.”

Natyrshmëria (fitreja) e pastër e njerëzve nënkupton krijimtarinë e parë të njohur, e cila ndryshon nga krijimtaria e botës shtazore. Disa dijetarë të jurisprudencës dhe të teorive, kanë thanë se fitre është karakter i krijuar te njeriu, që nëpërmjet tij, kur arrin nivelin e diturisë, e njeh Zotin e vërtetë. Thuhet se natyrshmëria (fitreja) e theksuar ka për qëllim atë që është marrë prej tyre në kurrizin e Ademit a.s. në kohën e krijimit të tyre si shpirtra, kur ata i dhanë zotimin Allahut xh.sh. për njohjen dhe adhurimin e Tij, ashtu siç dëshmoi me fjalët:

“Kujto kur Zoti yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuës të vetës së tyre (duke u thënë): “A nuk jam Zoti juaj?” Ata thanë: “Po, dëshmuam!” Të mos thoni në Ditën e Kiametit: “Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur.” (El Araf, 172).

Lindja e secilit njeri bëhet me këtë dëshmi përgatitëse, meqë Allahu ka krijuar zemrat e njerëzve të përgatitura dhe në përshtatshmëri me pranimin e së vërtetës, ashtu siç krijoi të shikuarit dhe të dëgjuarit e tyre si mjete për pranimin e gjërave që shihen dhe dëgjoen. Kjo argumenton atë që duhet të pranohet se njeriu është i përgatitur për pranimin e së vërtetës dhe pasimin e pranimin e fesë së natyrshme islame dhe vërtetësinë e saj.

Gjithashtu, thuhet se ajo ka për qëllim faktin se Zoti xh.sh. e ka bërë njeriun të natyrshëm, të përgatitur me mendje e dije, të njoftuar për mosbesimin e besimin e vërtetë, dhe duke qenë ata ende si shpirtra, Zoti nxori nga kurrizi (shpina) e Ademit a.s. besën dhe u tha: **أَلَسْتُ بِرَبِّكُمْ** **“A nuk jam Zoti juaj?”** Të gjithë u përgjigjen duke thënë **“Gjithëse-si!”**. Njerëzit, vullnetarisht dhe pa imponim, të lumtur u për-

gjigjen nga zemra “*Gjithsesi!*”, pasi e njohën Atë, ndërsa të mjerët thanë gjithashtu “*Gjithsesi se ti je Zoti ynë*”, por atë e thanë duke e urryer dhe jo me dëshirën e tyre.

Fakti që përforcon edhe më natyrshmërinë e besimit (fitren) te njeriu është se Allahu xh.sh. nuk e thirri njeriun për të besuar në parim, sepse besimi është i natyrshëm, i lindur te njeriu, por e thirri të besojë në Zotin e vërtetë, Allahun xh.sh., ashtu siç tha Ai:

آمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَأَنْفِقُوا مِمَّا جَعَلَكُمْ مُسْتَحْلِفِينَ فِيهِ

“Besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai u bëri trashëgues në të.” (El Hadid 7).

Po ashtu ajo që na përforcon edhe më se feja është e lindur te njeriu, është se nuk gjejmë ndonjë ajet kuranor që urdhëron njeriun të hajë ushqim, por që porosinë e Kuranit kryesisht janë të përqendruara tek urdhëresa që ushqimet të jenë të pastra, të mira dhe të lejuara (hallall) dhe me sasi mesatare, ndonëse nevoja për ushqime e pije është e lindur te çdonjëri, meqë përbënë domosdoshmërinë e ruajtjes së jetës. Ja një shembull kuranor:

يَا بَنِي آدَمَ خُذُوا زِينَتَكُمْ عِنْدَ كُلِّ مَسْجِدٍ وَكُلُوا وَاشْرَبُوا وَلَا

تُسْرِفُوا إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الْمُسْرِفِينَ

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (lutje), hani dhe pini e mos teproni, pse Ai (Allahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin).” (El Araf, 31).

2. Feja jep përgjigje për të gjitha çështjet rreth jetës së njeriut

Feja jep përgjigje se: Kush jam unë?; Pse jam krijuar?; Çfarë kërkohet prej meje?; Ku është fundi im?; Ç'është gjithësia?; Kush e krijoi atë?; Kush bëri që të gjitha krijesat të kenë dobi prej saj?; Ç'është puna e njeriut e cilët janë kufijtë e tij?; Çka është qëllimi dhe fundi i tij?; e shumë e shumë pyetje të tjera, për të cilat është e pamundur që t'u jepet përgjigje nga çdo mendje e logjikë e njeriut, çdo filozofi e kulturre, përveç nëse kthehemi në fe, e pyesim atë dhe tek atëherë marrim përgjigje të duhur.

Mendja e përzier me ideologji, epshe dhe tradita e zakone jo të mirëfillta humbi gjithherë kur u futë në gjëra të jashtëzakonshme e mbinatyrore, meqë filloi të japë mendime e teori të llojllojshme pa pasur fakte. Me këtë rast, ajo ra nën ndikimin e hipotezave se gjithësia u krijua rastësisht, ndonëse është e ditur për mbarë njerëzinë se as një rresht në një libër nuk është e shkruar vetvetiu pa autor, e as tryeza me ushqime të llojllojshme nuk mund të përgatitet pa shërbyesin. E si është e mundur të krijohet kjo gjithësi vetvetiu me krejt këtë rregull e precizitet?! Këto shkenca të ndryshme?! Ky njeri si krijesë mahnitëse?! E krejt këto gjëra a thua u bënë rastësisht pa një Krijues të Fuqishëm, të Dijshëm e të Urtë?!

Gjithashtu mendja u vë në lajthitje kur e shpalli vetveten si zot, dëshironte të programonte jetën e njeriut mbi sipërfaqen e tokës, e në realitet ajo nuk e di saktë se çfarë është njeriu, as nuk e di të ardhmen e tij, e as nuk e di siç duhet jetën njerëzore mbi sipërfaqen e tokës.

Për këtë vërejmë çdo ditë ndërrimin dhe modifikimin e mendimeve të tyre, herë i ngushtojnë e herë i zgjerojnë ato

në emër të përparimit dhe interesave të tyre, pa dashur të pranojnë mos kapacitetin dhe mos mundësinë për ta njohur të vërtetën mbi njeriun, çka i duhet atij dhe çka mund të bëjë ai.

3. Feja është shkencë dhe njohuri e vërtetë

Është e ditur se rrugët e arritjes së njohurive janë tri:

a) Ndjenjat, shqisat e të dëgjuarit, të shikuarit, të prekurit, të nuhaturit dhe të shijuarit.

Kjo është shkalla më e ulët e arritjes së njohurive, duke ditur se ndjenjat (shqisat) janë të ngushta në kapacitet, fuqinë e kanë të kufizuar, e në to gjejmë mangësi, dobësi e gabime.

b) Mendja dhe arsyeja.

Mendja është e nivelit më të lartë se paraprakja (shqisat), por megjithatë edhe mendja është e ngushtë në kapacitete, e përkufizuar në arritje dhe nuk mund të arrijë vetë atë që e parafytyron. Mundësia kuptuese e saj është e kufizuar përderisa është ekzistuese në krijesën njeri të kufizuar, e çfarë do të mbetet fuqia e kuptueshmërisë në çështjet sekrete?!

c) Lajmi i vërtetë, i sigurt.

Përveç dy metodave të përmendura, nëpërmjet të cilave përfitojmë dituri të vërtetë e njohuri të sigurt, është edhe metoda e tretë që quhet lajm i vërtetë.

Lajmi i vërtetë është i nivelit më të lartë se dy çështjet e tjera të cekura më herët (shqisat dhe mendja), sepse është i mbështetur dhe buron nga Zoti i Madhërisëm, i Cili krijoi dhe përcaktoi çdo gjë. Zotit xh.sh. nuk i fshehët asgjë prej asaj që krijoi dhe shpiku. Më pas, Ai shpalli atë që dëshiroi

te lloji njerëzor nëpërmjet të dërguarve të tij. Allahu xh.sh. thotë:

﴿٤﴾ ﴿٣﴾ إِنَّ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ

“Dhe ai nuk flet nga dëshira. Ajo nuk është tjetër pos shpalljes që i shpallet.” (En Nexhm, 3-4).

Sa më tepër të ofrohet lajmi nga lajmëtari dhe transmetuesi i drejtë, aq më e madhe është obligueshmëria dhe mundësia e pranimit. Lidhur me këtë çështje, Zoti xh.sh. thotë:

وَمَنْ أَصْدَقُ مِنَ اللَّهِ قِيلًا

“E kush mund të jetë më saktë në fjalë se Allahu?” (En Nisa, 122).

وَمَنْ أَصْدَقُ مِنَ اللَّهِ حَدِيثًا

“E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie.” (En Nisa, 87).

4. Feja është program për individin dhe shoqërinë

Nuk ka dyshim se Krijues dhe Sundues i njeriut është Zoti xh.sh.. Ai e di dhe është i njoftuar për çdo gjë për njeriun, se çka e dëmton dhe çka i bënë dobi atij. Ai është i Vetmi që me të drejtë vë rregulla dhe trason rrugën për njeriun. Ai është i Vetmi, që me programin e Tij, njeriut i qetëson shpirtin, zemrën e moralin e tij, duke e informuar se çka është e dobishme e çka është e dëmshme për jetën e tij në raport me jetën në këtë botë, në raport me vetveten e tij, me familjen dhe me shoqërinë. Gjithashtu është i informuar në raport me besimin dhe lidhshmërinë e njeriut me Zotin në vepra e moral, duke pasur gjithherë parasysh që t'i nënshtrohemi Atij.

Një gjë duhet ditur, se nuk ka nevojë t'i devijojmë njerëzit dhe t'i largojmë ata nga feja në emër të përparimit dhe zhvillimit, në emër të kulturës e artit, duke pretenduar ngritjen e individit dhe shoqërisë, në emër të interesave të përbashkëta, sepse Islami është program absolut dhe i përshtatshëm me jetën e shëndoshë dhe të mirëfilltë njerëzore.

Në bazë të kësaj, njeriu si personalitet, lidhja e tij me shoqërinë dhe lidhja e shoqërisë me shoqëri, forcojnë lidhjen dhe bashkëpunimin e fortë ndërmjet tyre. Por, kjo duhet të jetë në bazë të mësimave fetare, siç është bashkëpunimi në punë të mira e të mbara, e jo në mëkate e armiqësi mes vete.

5. Feja i përshtatet dëshirave të shëndosha dhe besnikërisë së njeriut

Te dashuria, mëshira, dëshira, modestia, singëriteti, besnikëria, shpresa, etj., nuk ka asgjë që ndikon më shumë sesa feja. Feja është e vetmja që lidhë zemrën me dashuri të plotë, pra dashuria e tillë është e pastër, meqë lidhet për te Krijuesi dhe për Atë, prandaj nuk ka mangësi. Çdo gjë duhet të vepërohet për hir të Zotit dhe duke pasur për qëllim kënaqësinë e Tij, përfshirë këtu edhe dashurinë ndaj prindërve, bashkëshorteve, fëmijëve, pasurisë, ruajtjes së raporteve farefisnore, besnikërisë në moral dhe dëshirës së të mirës për mbarë njerëzinë në përgjithësi.

Kush e udhëheq zemrën drejt mëshirës, ndihmës së nevojtarëve, ndihmës së të dobëtit dhe i atij që i bëhet padrejtë, përveç fesë?!

Qetësia shpirtërore dhe siguria në jetën e njeriut janë gëzim e rehati, dashuri e harmoni. Ato janë jetë e begatë, të cilën nuk mund ta prish asgjë dhe askush. Qetësia shpirtërore e

programon jetën e njeriut, prandaj është feja dhe nuk ka asgjë tjetër përveç fesë që ndikon më shumë në qetësinë shpirtërore. Shoqëritë jo islame, veçanërisht ato ateiste, vuajnë shumë nga problemet e ndryshme shpirtërore, ndonëse vërejmë tek ata tentime për ta arritur atë, qoftë nëpërmjet vendeve të përcaktuara si: shtëpi e begative, kafene e parajsës etj., por këto janë të pamjaftueshme për ta arritur objektivin e synuar. Madje shumë prej tyre investojnë për moshën e pleqërisë, gjë e cila është e mirë, por shumë e vonuar, sepse aspektet shpirtërore kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm përgjatë jetës. Aq më tepër, kur investimet e tilla nuk përfshijnë aspektin fetar, i cili është vendimtar në arritjen e çfarëdo avancimi shpirtëror.

Ndërsa feja e vërtetë, Islami, e bën Xhenetin të dashur te besimtari, vend qetësie e rehatie, ku në të, besimtari e gjen atë që i do shpirti e ia kërkon syri, pa probleme e mërzia, pa telashe me shëndet. Aty ka jetë të përjetshme, që nuk do sëmuret kurrë e as nuk i paraqitet vdekja. Allahu xh.sh. thotë:

مَثَلُ الْجَنَّةِ الَّتِي وَعَدَ الْمُتَّقُونَ فِيهَا أَنْهَارٌ مِنْ مَاءٍ غَيْرِ آسِنٍ
وَأَنْهَارٌ مِنْ لَبَنٍ لَمْ يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُ وَأَنْهَارٌ مِنْ حَمْرٍ لَذَّةٍ لِلشَّارِبِينَ
وَأَنْهَارٌ مِنْ عَسَلٍ مُصَفًّى وَهُمْ فِيهَا مِنْ كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَمَغْفِرَةٌ مِّن
رَبِّهِمْ

“Shembulli i Xhenetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur (të devotshëm), në të cilin ka lumenj me ujë për pije, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar, ata kanë aty edhe gjithfarë lloj pe-

*mësh, kanë edhe falje nga Zoti i tyre (a është i njëjtë).”
(Muhamed, 15).*

6. Feja është lumturi

Si mund të ndodh pa fe sinqeriteti me bindje të pastër në Zotin Një, Sunduesin absolut, i Cili posedon çdo gjë, i jep njeriut çka dëshiron dhe shpreson, duke e synuar të mirën që kanë dobi besimtarët pa pretenduar shpërblim e as falënderim nga njerëzit?!

Kush e shtyn njeriun që të ketë bindje të pastër dhe të pres shpërblim prej njerëzve, nëse ai ia mohon sjelljen e tij apo ai nuk ia njeh fare?; Përmendja për të mirë?; Falënderimi i njerëzve?; Librat e historisë?; Të gjitha këto në mendjet e tyre nuk vlejnë asgjë, bile nuk vlen as dhënia as e ndonjë vendi udhëheqës, e nuk vlen as dhënia e ndonjë pasurie apo kryerja e ndonjë shërbimi.

Çka i shtynë nëpunësit nëpër vende të ndryshme të botës për marrje ryshfeti prej firmave që bëjnë tregti me shtetet e tyre dhe kanë nevojë për ta? Nuk ka dyshim se ata të cilët merren me ryshfet nuk zgjedhin rrugë e as metodë dhe nuk përdorin metoda të drejta me ato kompani, por i mashtrojnë dhe nuk synojnë tek interesi e shteti apo shoqëria e tyre, por ndjekin rrugën që e bën shejtanin të kënaqet, apo thënë më qartë, ata shikojnë vetëm interesin e tyre personal.

Ata të cilët kanë bindjen e sinqertë dhe qëllimin për Zotin, ndalohen dhe largohen prej mashtrimeve duke pasur dronë e Tij.

7. Feja është mburojë dhe edukatë

Feja është mbrojtje e ruajtje nga prishja e zemrës nga xhelozia dhe inatet. Feja është ruajtje dhe siguri e edukatës nga vjedhja, plaçkitja, kidnapimi, rrena, bartja e fjalëve, për-gojimi, dëshira për sherr, dhe nga veprimet negative në përgjithësi.

Feja është edukatë për zemrën, ashtu që njeriu të dëshirojë për njerëzit atë që dëshiron për veten e tij dhe të sillen ndaj njerëzve ashtu siç dëshiron të sillen ata ndaj tij.

Kështu që nuk e shoh të rrugës dhe të nevojshme të bëjë krahasim në mes të gjendjes së besimtarit me zemër e edukatë dhe gjendjes së një ateisti. Feja, besimtarit ia forcon moralin, ashtu siç ia forcon lidhjen me namazin e agjërimin, ndërsa ateisti, lidhjen e tij me moralin e bën nga interesi apo frika dhe dëshira që t'i kompensohet ajo sjellje e tij, derisa nuk ka fe e as besim.

Gjendja faktike e individëve dhe shoqërive ateiste na e dëshmon këtë më së miri.

8. Feja është lumturi për njeriun në të dyja botët

Besimtari është i bindur me një bindje të fortë se krejt çka përjeton në këtë botë është e mirë (hair) për të, sepse kur përjeton begati, ai bëhet falënderues, e kur e godet ndonjë sprovë, ai duron, prandaj përsëri fiton shpërblimin te Zoti i Madhëruar. Muhamedi a.s. kur përjetonte ndonjë mirësi, falënderonte, prandaj thoshte: *“Falënderimi i takon Allahut të Madhërishëm, i Cili me dhuntitë e Tij, plotëson të mirat!”*, e

kur e godiste ndonjë sprovë, ai duronte dhe thoshte: “Falënderim i qoftë Zotit për çdo gjë!” (Transmeton Ibën Maxhe).

Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Është çudi puna e besimtarit, çdo gjë tek ai është hair, nëse i vjen ndonjë e mirë, e falënderon Zotin dhe është hair për të, po edhe nëse e përcjell ndonjë sprovë, bën durim për të dhe është hair për të, pra çdo gjë që e përjeton besimtari është hair dhe e dobi-shme për të.” (Transmetojnë Muslimi dhe Imam Ahmedi).

Besimtari mysliman beson se kjo botë është arë e botës tjetër. Nuk ka asnjë bujk që angazhohet dhe e punon arën e nuk shpreson se rezultati e rendimenti do të arrihet. Pra besimtari sado që fiton dhe harxhon, apo sprovohet dhe e përcjellin gjëra të pakëndshme, ai e di se do ta kalojë atë gjendje dhe do të përjetojë vetëm mirësi prej Krijuesit të tij. Te besimtari kjo botë nuk është diç tjetër përveç ditë të numëruara, dhe se këto ditë do të kalojnë dhe nuk do të mbetet diç tjetër përveç veprave të tij.

Transmetohet nga Enesi r.a., se Pejgamberi a.s., ka thënë:

“Kur personi arrin në botën tjetër me të mirat e dynjasë, e në fakt nuk është prej banorëve të Xhenetit, një zhytje futet në Xhehenem e i thuhet: “O filan, a ke parë, a ke përjetuar ndonjëherë ndonjë të mirë? A të ka kaluar ndonjëherë pranë ndonjë e mirë?” E ai thotë: “O Zot, as nuk kam parë e as nuk më ka kaluar pranë ndonjëherë ndonjë e mirë.” Më pas vjen personi me varfëri, urrejtje e fatkeqësi të kësaj bote e ai është i përcaktuar për Xhenet dhe futet në Xhenet njëherë dhe i thuhet: “O rob i Zotit, a ke përjetuar ndo-

njëherë varfëri,URREJTJE apo ndonjë fatkeqësi? A ka kaluar pranë teje diç e tillë?” Ai thotë: “Jo o Zot, nuk kam përjetuar as nuk ka kaluar ndonjëherë pranë meje gjë e keqe.” (Transmeton Muslimi).

Në botën tjetër, çështja është e qartë, gëzimi e lumturia janë ekskluzive për ata që besuan Allahun me të drejtë.

Lidhur me këtë çështje, Pejgamberi a.s. ka thënë:

“Nuk do të hyjë askush në Xhenet, përveç atyre që kanë besuar, dhe se vërtet Zoti e ndihmon këtë fe edhe me njerëz jo të mirë.” (Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi).

Ndërsa zjarri (Xhehenemi) është stacioni i fundit për ata që nuk besuan në Allahun xh.sh., prandaj ata që shpëtojnë prej zjarrit kanë fituar, ashtu siç dëshmohet në Kuran:

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ ۗ وَإِنَّمَا تُوَفَّقُونَ أُجُورَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ ۗ فَمَن زُحْزِحَ عَنِ النَّارِ وَأُدْخِلَ الْجَنَّةَ فَقَدْ فَازَ ۗ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعُ الْعُرُورِ

“Secili njeri do ta shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u plotësohen Ditën e Kiametit, e kush i shmanget zjarrit e futet në Xhenet, ai ka arritur shpëtim, e jeta e kësaj bote nuk është tjetër pos një përjetim mashtrues.” (Ali Imran, 185).

Sëmundjet më të rrezikshme të përhapura ndër njerëz sot janë sëmundjet e stresit dhe pakënaqësive shpirtërore. Njerëzit janë të pakënaqur me atë që e posedojnë dhe angazhohen me atë që nuk e posedojnë, duke fantazuar, derisa të arrijnë në një moment kur iu ndërpriten shpresat, iu prishën dëshirat (qejfet), pra ai është momenti i vdekjes.

Për atë që nuk ka mëdyshje, është se qetësia shpirtërore është fundamentale për të qenë njeriu edhe pa dhimbje trupore, dhe se nuk ka dyshim se pëlqimi e kënaqësia me atë që e ka caktuar Zoti xh.sh. është pasuria më e madhe.

Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Frikësoju të ndaluarave, do të jesh më i përkushtuari ndaj Zotit, pëlqe me atë që të ka dhënë Zoti, do të jesh më i pasuri ndër njerëz, sillu mirë me fqinj, do të jesh besimtar, dëshiro për të tjerët atë që dëshiron për vetën tuaj, do të jesh mysliman i duhur, dhe mos u qesh përtej mase, sepse të qeshurit e tepërt e vdes zemrën.”*

9. Feja është gjithherë me njeriun

Ashtu siç e përshkruan Allahu xh.sh.:

وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا

“E Ai (Zoti) ia mësoi Ademit të gjithë emrat (e sendeve).” (El Bekare, 31).

وَقُلْنَا يَا آدَمُ اسْكُنْ أَنْتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ

“Ne i thamë: “O Adem, ti dhe bashkëshortja juaj bazoni në Xhenet.” (El Bekare, 35).

Feja ka qenë me njeriun kur zbriti në tokë për ta ndërtuar atë:

قُلْنَا اهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا ۚ فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ مِنِّي هُدًى فَمَنْ تَبَعَ هُدَايَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Ne u thamë: “Dilni prej aty që të gjithë, e juve gjithqysh do t’u arrijë udhëzim prej Meje, e kush pranon udhëzimin Tim, për ata nuk ka as frikë as që do të brengosen.” (El Bekare, 38).

Feja ka qenë me njeriun çdoherë ku Allahu dërgoi te çdo popull pejgamberë, të dërguar:

وَإِن مِّنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ

“E nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar.”
(Fatir, 24).

E deri në Pejgamberin e fundit, Muhamedin a.s., për të cilin Zoti Fuqiplotë dëshmoi:

مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِّن رِّجَالِكُمْ وَلَكِن رَّسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ

“Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i Dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve.” (El Ahzab, 40).

Kjo fë do të qëndrojë duke i mësuar e duke i udhëzuar, ndihmuar dhe fuqizuar njerëzit, derisa të afrohet kataklizmi (Kiameti), deri në momentin kur do të lind Dielli nga Perëndimi, meqë pas këtij momenti nuk pranohet besimi e pendimi i askujt, ashtu siç thotë Allahu i Madhërishëm:

لَا يَنْفَعُ نَفْسًا إِيْمَانُهَا لَمْ تَكُنْ آمَنَتْ مِن قَبْلُ أَوْ كَسَبَتْ فِي إِيْمَانِهَا حَيْرًا

“Asnjë njeriu nuk i vlen besimi i Tij nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë me besimin e tij kurrfarë të mire.” (El Enam, 158).

E njeriu është njeri, atë e ngritë apo e ulë besimi, veprat dhe edukata e tij, sepse këto vlerësohen te Krijuesi, e jo fizionomia e pasuria.

Nevojat shpirtërore të njerëzve i mbulon Islami, prandaj ai e edukon shpirtin me besim në Allahun dhe respektin ndaj Tij, e edukon mendjen me dije të dobishme, me kërkim dhe studim, si dhe e edukon trupin që të kënaqet me atë që e ka lejuar Allahu prej llojeve të ushqimit, pijeve, veshjes, çka

është e mirë dhe e dobishme e lejuar, e jo çka është e keqe dhe e dëmshme.

Shumë prej njerëzve gabojnë kur mendojnë se njeriu i kohës së sotme ndryshon prej njeriut të kohës së kaluar dhe se gabojnë kur mendojnë se kërkesat e tyre të vërteta ndryshojnë.

Të analizojmë epshet, mëshirën, egon e unin, ndjenjat për gjininë tjetër, ndjenjat për prindërit, për fëmijët, për pasurinë, a ndryshon diç në mes të njeriut të kohës së sotme nga ai i kohës së kaluar? Apo na mashtron pamja e jashtme, shkaqet dhe metodat e asgjë tjetër?!

Shiko te domosdoshmëria e njeriut për ajrin, ushqimin, pijen, veshmbathjen, a ndryshon diç në mes të njeriut të kohës së sotme nga ai i kohës së kaluar? Jo assesi, por vetëm ka ndryshuar dukja dhe metoda!

Analizo sinqeritetin, bamirësinë, mëshirën e sjelljen ndaj prindërve, dëshira e së mirës për të tjerët, dashuria ndaj rregullit (sistemit), nënshtrimi ndaj sunduesit, shiko a ka ndryshuar niveli mendor i njeriut të kohës së sotme nga ai i kohës së kaluar?

Pra, njeriu është njeri, atë e ngritë edukata e drejtë fetare dhe atë e ulë çdo vepër e ligë dhe negative.

Njerëzit lexojnë dhe studiojnë për sunduesit e mençur, të cilët kanë jetuar para qindra vitesh dhe nuk merakosen dhe nuk merren me sunduesit e kohës së tyre, kur dihet se ata kanë qenë sundues të mençur me vizion të drejtë në jetë, e këta mendjehetët me edukatë të ulët të epsheve dhe të qëllimeve të ulëta.

Ibën Kajimi ka thënë: “Feja është domosdoshmëri për njeriun, e edhe më tepër se domosdoshmëria e tij për ushqim, pije etj., sepse nëse vendos me ndërpre ushqimin dhe pijet,

paraqitet vdekja e trupit dhe shpirti ikën prej tij, por nëse vendos me e ndërpre fenë (Sheriatin), rezulton me prishjen e shpirtit dhe trupit së bashku dhe është shkatërrim i përhershëm. Feja është domosdoshmëri më e madhe për njerëzit sesa mjekësia, zhvillimi etj.. A nuk e vëren se shumë prej njerëzve jetojnë pa mjek dhe në vende të pa zhvilluara, d.m.th. njeriu nuk mund të jetojë jetë të lumtur pa fe.

Për fund themi se, nevoja e njeriut për fenë është e domosdoshme mbi çdo nevojë tjetër, qoftë ajo edhe nevojë ushqimi, pije dhe çdo gjëje tjetër, sepse Islami e njofton njeriun se si është Zoti i kënaqur me të dhe si të mos e hidhëroi Atë, e njofton gjithashtu për të gjitha punët e mira. Ai e njofton atë se feja është themeluar me shpallje (vahj) prej Allahut të Madhëruar, që nuk gabon dhe i dinë të gjitha gjërat.

Ibën Kajimi gjithashtu ka thënë:¹ “Feja është domosdoshmëri më e madhe se domosdoshmëria e njerëzve për ushqim dhe pije, sepse përfundim që arrihet me ndërprerjen e frymëmarrjes, ushqimit dhe pijes është vdekje e trupit dhe largimi i shpirtit prej tij, ndërsa ajo që rezulton me mungesë të fesë është prishje e shpirtit dhe e zemrës së bashku, e që është prishje e përvetshme, pra feja është domosdoshmëri më e madhe se mjekësia. A nuk e shihni se shumë prej njerëzve jetojnë edhe pa mjek?, që do të thotë se, pa fe, njerëzit nuk mund të jetojnë mirë.

Marrë nga:

“’Erkanu Islam’ - Eshtheadetani ve ahkamuha”

Përktheu:

Ekrem Simnica

¹ Miftah daru seadeh 2/2 me përshtatje.

Dr. Orhan BISLIMAJ

“JETO NË KËTË BOTË SI ME QENË JABANXHI OSE UDHËTAR RASTI!”

Njeriu kur e kupton arsyen e ardhjes në këtë botë, ai e kupton edhe misionin e tij real, dhe kjo është gjëja më e rëndësishme për të. Pejgamberi i Zotit, Muhamedi a.s., na ka mësuar se kjo jetë është periudhë e përkohshme për njeriun, kurse stacioni i fundit i tij është Ahireti. Në lidhje me këtë temë, do ta kemi në epiqendër hadithin që do ta shpjegojmë në vazhdim.

1. Shpjegimi i hadithit

عن عبد الله بن عمر رضي الله عنهما قال: أخذ رسول الله ﷺ مِنِّي فقال: كُنْ فِي الدُّنْيَا كَأَنَّكَ غَرِيبٌ، أَوْ عَابِرُ سَبِيلٍ.

Transmetohet nga Abdullah ibën Omeri, Zoti qoftë i kënaqur me të, i cili ka thënë: “Më kapi për shpatulla Pejgamberi i Zotit a.s. dhe më tha: “*Jeto në këtë botë, si me qenë jabanxhi ose udhëtar rasti!*” (Muttefekun alejhi).¹

Vërtet, është një hadith tepër interesant e përmbajtësor, sepse njeriun e fut në mendime e analiza të thella. Pejgam-

¹ Ahmed bin Alij bin Haxher el Askalanij, *Fet’hu’l-Bari Sherhu Sahihi’l-Buhari*, Daru’s-Selam, botimi i parë, Riad, 2000, vëll.11, fq.280, hadithi nr.6416.

beri a.s. foli fare shkurt, por tha shumë: *“Jeto si jabanxhi ose udhëtar!”*

Personalisht, sa herë që e kam lexuar këtë hadith, më ka ndërgjegjësuar akoma më shumë për ta kuptuar rolin tim si njeri, përfshirë ardhjen në këtë botë, jetesën në këtë botë kalimtare, perceptimin e kënaqësive të dynjasë dhe përgatitjen për Ahiret.

Në fakt, ky hadith duhet të shërbejë si një leksion i përbotshëm e i përjetshëm për secilin njeri në baza ditore. Vetë mënyra se si Pejgamberi a.s. i është drejtuar, pra duke e kapur për shpatulla Abdullah ibën Omerin, është një lloj tërheqje e vërejtjes ndaj tij, në mënyrë që të jetë vigjilent karshi dynjasë tërheqëse dhe sfidave të saj.

Por një gjë është me rëndësi, këtë hadith, absolutisht nuk duhet kuptuar si një thirrje për minimizimin e rolit tonë në këtë dynja, sepse dikush mbase mund ta lexojë si kthim vetëm kah Ahireti me ibadete dhe asgjë tjetër. Jo, absolutisht, hadithi vjen si një kundërvënie parimore ndaj egoizmit të madh që njerëzit e kanë për kënaqësitë e përkohshme të dynjasë e që janë të pa fund, e të cilat aq janë të ashpra, gjersa edhe mund ta devijojnë thellë besimtarin, nëse nuk ka kujdes të shtuar.

Kjo që po e themi, ndërlidhet me faktin e pakontestueshëm se Zoti i Madh, në shpirtin e njeriut ka vendosur lakmi tepër të madhe për dynjanë dhe nga kjo nuk ka përjashtim askush. E, këshilla e Pejgamberit a.s. nëpërmjet këtij hadithi, vjen si një thirrje për t'i mbizotëruar këto prirje, sepse, në rastin e kundërt, nëse ato marrin hov, e shkatërrojnë njeriun dhe e rrënojnë totalisht dinjitetin e tij njerëzor.

2. Kurthimi i dynjasë dhe lakmia njerëzore

Hasreti Ademi a.s. e kishte humbur betejën me shejtanin e mallkuar, jo për shkak të urisë momentale për ushqim kur e konsumoi frytin e ndaluar, porse për shkak se ra pre në kurthin e shejtanit kur i tha se ai fryt, mbase do t'ia mundësonte përjetësinë në këtë botë, atë që njeriu e do më së shumti.

Prandaj, dynjaja përtej mundësive të mëdha që i ofron njeriut, siç është mundësia për të qenë i devotshëm e për ta fituar Xhenetin, në anën tjetër, ajo është një lloj kurthi për njeriun. Është e tillë, sepse secili njeri e ka thellë në shpirtin e tij lakminë për dynjanë si një veti gjenetike njerëzore.

Këtu buron edhe nevoja e mësimeve të fesë, si një manual udhëzues për ta disiplinuar këtë veti, e cila nëse nuk mbizotërohet, shndërrohet në ves shkatërrimtar për njeriun, gjersa, siç thotë Allahu, e degradon njeriun në pozitë të kafshës, madje akoma edhe më keq. (El A'raf, 179, El Furkan, 44).

Në fakt, këtu buron edhe urtësia e ibadeteve ndaj Zotit, e të cilat, përveçse nënkuptojnë madhërimin e Krijuesit, ia kujtojnë njeriut idenë e Ahiretit, si një arbitër për përkohshmërinë e dynjasë.

Dhe, kur i vështrojmë bashkërisht, mësimet teorike të Kuranit e hadithit, në njëërën anë, dhe aplikimin e ibadeteve në baza ditore, në anën tjetër, arrijmë ta kuptojmë se imani - feja është një terapi adekuate për ta përsosur shpirtin njerëzor dhe për ta mbajtur në ekuilibër e rezistent përballë trysnive të dynjasë dhe cytjeve të saj.

Pa këtë terapi, shpirti i njeriut ndihet i varfër, ashtu siç ndihet e varfër mendja e njeriut pa arsimim, apo trupi i njeriut pa ushtrime fizike. Në secilin rast, këto mungesa shfaqin

probleme serioze gjatë rrugës. Për këtë arsye, filozofët e teoricienët ftojnë në arsimim, kurse mjekët ftojnë në vitalizimin e muskujve, përmes ecjes, ushtrimeve ditore të mëngjesit, fitnessit e deri te fizioterapia për raste të veçanta të çrregullimeve, etj., për ta pasur një jetë me sa më pak ankesa.

E, çfarë të bëjmë me shpirtin, me çka duhet vitalizuar e rivitalizuar atë, kur dihet se brishtësia e tij, e determeninon brishtësinë e trupit, por jo e kundërta. Shto këtu faktin se mjekë të shpirtit nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë. Për këtë arsye, Allahu ia ka zbritur njerëzimit Kuranin, ia ka dërguar Pejgamberin a.s., pra ia ka ofruar platformën e fesë, e cila jep përgjigje në pikëpyetjet më delikate të njeriut, në ato që mendja njerëzore vetvetiu nuk mund t'i perceptojë kurrë.

Ky hadith, pikërisht vjen për t'ia treguar njeriut vizionin për dynjanë, si një mbrojtje nga kurthimet e gabuara, që do ta rëndonin gjendjen e tij shpirtërore, siç ndodh me atë që beson se me këtë dynja merr fund çdo gjë!? Vjen për ta vetëdijesuar njeriun se kjo botë nuk është fund i njeriut e as shtëpi e tij e përhershme, por është vetëm një rrugë kalimtare që ia mundëson arritjen deri te vendbanimi i tij përfundimtar, Ahireti.

Neve, ndoshta na duket shumë i thjeshtë për nga vështrimi literal e teknik, por rëndësia e këtij hadithi është shumë e madhe, sepse ofron konceptin kornizë për dynjanë si shteg i Ahiretit. Kjo ngjason me atë që hip në trenin e duhur dhe arrin në destinacionin e synuar, kundrejt atij që hip në trenin e gabuar dhe çdo stacion i del i gabuar.

3. Vetëdijesimi për dynjanë mashtruese

Në kaptinën El Hadid, Allahu i Madhërishëm pasi ia sqaron njerëzve saktësisht karakterin e dynjasë, në fund thotë se ajo është veçse ‘mashtruese’. Allahu thotë:

اعْلَمُوا أَنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَهَوٌّ وَزِينَةٌ وَتَفَاخُرٌ بَيْنَكُمْ وَتَكَاثُرٌ فِي الْأَمْوَالِ وَالْأَوْلَادِ كَمَثَلِ غَيْثٍ أَعْجَبَ الْكُفَّارَ نَبَاتُهُ ثُمَّ يَهِيحُ فَتَرَاهُ مُصْفَرًّا ثُمَّ يَكُونُ حُطَامًا وَفِي الْآخِرَةِ عَذَابٌ شَدِيدٌ وَمَغْفِرَةٌ مِّنَ اللَّهِ وَرِضْوَانٌ وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعٌ الْغُرُورِ

“Dijeni, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbulurim, si dhe mburrje e garë ndërmjet jush për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij. E, jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (El Hadid, 20).

Siç po e vërejmë në këtë ajet, Allahu i drejtohet njerëzve në formën urdhërore: “Dijeni...!”, e që është një tërheqje e posaçme e vërejtjes për vigjilencë, kujdes e vetëdijesim ndaj dynjasë. I Madhi Zot, e fillon me urdhëroren ‘dijeni...!’, dhe në vazhdim e përshkruan jetën e kësaj bote, ambiciet dhe ëndrrat e njeriut për luks, mburrje, pasuri, fëmijë, etj., kurse në fund të ajetit thotë ‘të gjitha këto aspirata të dynjasë janë kënaqësi e rreme’.

Ndaldu edhe mendo thellë, në atë që po thotë Krijuesi, kjo dynja është kënaqësi e rreme. Kjo duhet të qëndrojë mbi këmbën tonë gjatë gjithë kohës. Fundja, këshillat e Zotit, kanë

për qëllim zgjimin e vetëdijesimit tonë, para se të na godasë e keqja e pakujdesisë. E, vërtetimi i asaj që e thotë i Madhërishmi, ka për të ndodhur patjetër, mbetet vetëm çështje kohe. Kjo më së miri pasqyrohet te të vjetrit që kanë mbërrirë në fund të jetës. Prej gojës së tyre shpeshherë i kemi dëgjuar këshillat kur thonë ‘kjo dynja qenka mashtruese’, apo ‘kjo dynja s’qenka gjë’, etj.

Secilit njeri, një ditë kanë për t’iu kujtuar këto fjalë. Ai që e kupton dynjanë ashtu siç duhet, nuk do të zhgënjehet në fund të jetës. Me një rast, Alija Izetbegović, Allahu e mëshiroftë me grada të larta në Xhenet, ka thënë: *“Po qe se do të më ofrohej me një mrekulli të jetoja përsëri - nuk do të pranoja. Po qe se do të isha i detyruar të pranoja, do të jetoja njësoj siç kam jetuar!”*²

Këtë konstatim, në fund të jetës, nuk e thotë dikush që nuk e ka kuptuar kurrë se kjo dynja është kalimtare, por e thotë vetëm ai që e ka kuptuar dynjanë si një rrugë e shkurtër që të mundëson udhëtimin deri te shtëpia e përhershme, Ahireti.

Prandaj, Pejgamberi a.s., sikur po i thotë Ibni Omerit: Kujdes, mos e humb veten pas lakmive të pavlera të dynjasë, sepse ato janë të rreme dhe një ditë do të zhgënjehesh! Prandaj, feja kërkon prej njeriut që të rrugëtojë në këtë botë me dy krahë, ashtu siç fluturon shpendi, me krahun e dynjasë dhe me krahun e Ahiretit.

² Alija Izetbegović, *Kujtime*, Prishtinë, 2008, fq. 9.

4. Pjesa e hadithit: “Jeto si jabanxhi (garib)!”

‘Garib’, i thuhet atij që është jabanxhi apo i huaj, që nuk është vendas, por që ka ardhur nga një vend tjetër. Personi që është jabanxhi nuk e njeh mirë vendin ku gjendet si mysafir, andaj edhe nuk rrafshohet shumë në atë vend, përkundrazi është i preokupuar për t’u kthyer në vendin e vet.

Në analogji me këtë, myslimani asnjëherë nuk rrafshohet aq shumë në dynja, për nga aspekti i ndjeshmërisë dhe lidhjes emocionale, ashtu sikurse jabanxhiu që nuk ka emocion rrënjësor për një vend të huaj, por e shfrytëzon dynjanë si një rrugë tranzitore drejt Ahiretit. Çdo gjë që i kundërvihet objektivit të Ahiretit, ai e braktisë, kurse çdo gjë që i shërben Ahiretit, ai e vepron dhe e zbaton. Këto janë ato idealet dhe kriteret e mirëfillta të jetës.

Për shembull, shkuarja në xhami për namazin e xhumasë, ditën e premte, nuk nënkupton vetëm një ibadet, por nënkupton zbatimin e një obligimi fetar në funksion të Ahiretit, si një vlerësim përtej dynjasë. Njësoj është edhe me ibadetet e tjera apo veprat e mira që bëhen në emër të Zotit. Në rastin e kundërt, pra lënia e xhumasë, nënkupton zhvillimin e një jete ku në epiqendër është dynjaja e jo Ahireti.

Pra, si qëllim final i këtij hadithi, mund të themi se është ndërgjegjësimi i njeriut, në mënyrë që jetën e tij dhe punët e tij t’i akordojë në funksion të Ahiretit si objektiv madhor, apo siç thotë populli për ‘riza të Zotit’.

Myslimani që i ka parasysh këto këshilla, tregohet i kujdesshëm, në çdo aspekt. Çdo egoizëm të tij, që mund të lind nga pushteti, pozita, pasuria, apo çfarëdo kënaqësi tjetër, e mbizotëron me dioptrinë e llogaridhënies në Ahiret. Zaten,

njeriu tregohet i pakujdesshëm në bërjen e të këqijave dhe padrejtësive ndaj të tjerëve, atëherë kur e harron llogaridhënien, apo kur mendon se mund t'i ikë përgjegjësisë. E, Abdullah ibën Omer r.a., në lidhje me këtë hadith, thoshte:

“Nëse jeni në mbrëmje, mos e prisni mëngjesin, e nëse jeni në mëngjes, mos e prisni mbrëmjen dhe shfrytëzoje shëndetin para sëmundjes, kurse jetën para vdekjes.”

وَكَانَ ابْنُ عَمَرَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمَا يَقُولُ: "إِذَا أُمْسَيْتَ فَلَا تَنْتَظِرِ الصَّبَاحَ، وَإِذَا أَصْبَحْتَ فَلَا تَنْتَظِرِ الْمَسَاءَ، وَخُذْ مِنْ صِحَّتِكَ لِمَرَضِكَ، وَمِنْ حَيَاتِكَ لِمَوْتِكَ"³.

Domethënë, njeriu duhet të jetojë me ndjenjën se vdekja mund t'i vijë kurdoherë dhe se një ditë ka për të dhënë llogari për çdo gjë.

5. Pjesa e hadithit: “Jeto si me qenë udhëtar rasti (abiru sebil)!”

“*Abiru sebil*”, i thuhet udhëtarit që e merr rrugën për të shkuar diku. Edhe kjo pjesë e hadithit është në funksion të ndërgjegjësimimit të njeriut në raport me dynjanë e përkohshme, në mënyrë që mos t'i lidhë ndjenjat me të, ashtu si udhëtarit që nuk ka ndjeshmëri për vendet nëpër të cilat kalon gjatë rrugës, sepse nuk i përjeton si të tij.

Disa kanë thënë se puna e njeriut në këtë botë është si puna e një robi të cilin e dërgon pronari i tij në një qytet tje-

³ El Askalanij, *Fet'hu'l-Bari Sherhu Sahihi'l-Buhari*, po aty, vëll.11, fq. 280.

tër për ndonjë nevojë, e ai preokupohet për ta kryer atë punë për të cilën ka shkuar dhe menjëherë kthehet në vendin e tij, pa u interesuar për asgjë tjetër.⁴

Pejgamberi a.s. e ka përmendur shprehjen ‘si udhëtar rasti’, për ta sqaruar çështjen edhe në mënyrë figurative. Dome thënë, dynjanë duhet ta marrim afër zemrës, po aq sa edhe udhëtari që i merr afër zemrës vendet e huaja nëpër të cilat kalon andejpari. E dihet, se udhëtari, jo se nuk ka ndjeshmëri për ato vende, por ndihet edhe i frikësuar nga udhëtimi edhe për faktin se është duke kaluar nëpër rajone, ku nuk njihet me banorët.

Përveç kësaj, kjo puna e ‘udhëtarit të rastit’ është akoma më gjithëpërfshirëse, në kuptimin se udhëtari gjatë rrugës i merr me vete vetëm ato gjësende që janë ngushtësisht të tij dhe që ka nevojë për to momentalisht, e ato janë shumë pak, si: veshmbathje, pak ushqim, pak ujë dhe asgjë më shumë. Ky është një leksion i mirë për prirjet egoiste të njerëzve për më shumë pasuri, apo për të gjithë ata egoistë që mundohen ta uzurpojnë krejt pasurinë e botës, kurse nuk japin asgjë për bamirësi apo interesin e përgjithshëm.

Në një hadith tjetër sahih, të cilin e transmeton Abdullah ibën Mesudi r.a., Pejgamberi a.s., punën e dynjasë e krahason me hijen e pemës, nën të cilën njeriu pushon përkohësisht dhe pastaj e braktis:

⁴ El Askalanij, *Fet’hu’l-Bari Sherhu Sahihi’l-Buhari*, po aty, vëll.11, fq. 282.

مَا لِي وَلِلدُّنْيَا؟ مَا أَنَا فِي الدُّنْيَا إِلَّا كَرَكَابٍ اسْتَظَلَّ تَحْتَ شَجَرَةٍ، ثُمَّ
رَاحَ وَتَرَكَهَا

“Çfarë lidhje kam unë me dynjanë? Unë në këtë botë nuk jam gjë tjetër veçse një kalorës që për një çast qëndron nën hijen e një peme, pastaj nisat dhe largohet prej saj.” (Tirmidhiu).

Pejgamberi a.s., po i thotë Ibni Omerit, ‘jeto si udhëtar rasti’, si një vërejtje që të mos dashurohet në pasuri, sepse ajo ka për të mbetur në dynja, ashtu sikur udhëtari që nuk mund të marrë me veti as shtëpinë e as pasurinë, por do të marrë me vete vetëm ato që janë ngushtësisht të tij, e ato janë veprat e mira.

Përfundim

Për çdo ditë të shpenzuar, njeriu largohet prej dynjasë, kurse shkon duke u afruar kah Ahireti. Prandaj, thënia e Pejgamberit a.s.: “Jeto në këtë botë, si me qenë jabanxhi ose udhëtar rasti!”, duhet të qëndrojë si një kurorë mbi kokat tona, ditë e natë, gjatë gjithë jetës, për të jetuar në këtë botë, si jabanxhi apo udhëtar, por me idenë e Ahiretit, ku çdo gjë që e bëjmë, e bëjmë ‘fi sebilil-Lahi’ - për hir të Zotit.

E Allahu i Madhërishëm, devotshmërinë e ka cilësuar si furnizimin më të mirë për rrugë:

وَتَزَوَّدُوا فَإِنَّ خَيْرَ الزَّادِ التَّقْوَىٰ وَاتَّقُونِ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ

“Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria, o ju të zotët e mendjes keni dronë Time.” (El Bekare, 197).

Ramadan SHKODRA

MANIFESTIMI I MEVLUDIT DASHURI, ZOTIM E BESATIM PËR RRUGËN E MUHAMED MUSTAFASË -

Muaji hënor Rebiul Evel është muaji që në vitin tashmë të largët 571, në Mekën e bekuar, lindi i Dërguari i Zotit, peygamberi i fundit, hazreti Muhamed Mustafaja, alejhi selam. Peygamberi, a.s., përveçqë lindi në Mekë, aty e kaloi edhe rininë e tij, dhe pikërisht aty, në Mekën e bekuar, Zoti i Gjithë-dijshëm e shpalli peygamber dhe ia dha misionin për besimin e drejtë, të cilin Muhamedi, a.s., e shpërfaqti për njerëzimin për 23 vjet rresht.

Misioni që Krijuesi i gjithësisë ia ngarkoi Muhamedit, a.s., që t'ia komunikonte njëzimit, ishte plot mësim, kondita e parime për dynja e ahiret, prandaj edhe Muhamedi, a.s. përveçqë ishte i zgjedhur e i nderuar prej Zotit, xh.sh., që të ishte resulullah, ai u bë edhe i dashur, i nderuar, i respektuar, i çmuar e i vlerësuar ndër besimtarët myslimanë, po edhe te të tjerët, të cilët megjithëqë nuk e pranuan për peygamber, e çmuan për ndikimin që pati ai dhe misioni i tij në historinë, kulturën e qytetërimin njerëzor.

Duke pasur parasysh këto fakte, besimtarët e devotshëm, me dëlirësi e sinqeritet të madh, kanë praktikuar udhëzimet, thëniet, veprat, pëlqimet dhe punët e Peygamberit, a.s., duke pasur atë prore model e udhëzues për veprat dhe jetën e tyre.

Kështu, besimtarët myslimanë, me devocion e përkushtim, nga dashuria e madhe për Muhamed Mustafanë, me shumë të drejtë e kanë kujtuar dhe vazhdojnë ta kujtojnë e ta shënojnë ditëlindjen e tij, datën 12 të muajit Rebiul Evel, po edhe gjithë muajin në vazhdim, aq sa ky muaj mori edhe epitetin Muaji i Mevludit, dhe kështu u njoh dhe njihet në mbarë botën myslimane, sepse vërtet në këtë muaj lindi njeriu më i mirë, lindi peygamberi ynë i fundit, Muhamedi, a.s.

Dhe, ndërsa vitet rrjedhin dhe koha ecën, dashuria për Muhamed Mustafanë gjithnjë e më shumë rritet e shtohet, e me të edhe format dhe mënyrat e kujtimit dhe të shënimit të ditëlindjes së Tij ndër besimtarët e vendeve, të trevave, rrethanave e hapësirave të ndryshme, dhe në vartësi të rrethanave shoqërore, kulturore e arsimore. Mirëpo, gjithnjë duke e kujtuar ditëlindjen e tij, a.s., me po atë ndjesi të veçantë, sikur të kishin qenë që në kohën e tij dhe bashkë me të.

Nëse e shohim, e vështrijmë dhe e analizojmë me qetësinë e mendjes e me kritere objektive e shkencore, na rezulton se nuk ka një personalitet të dytë, që biografia, veprimtaria, misioni dhe ndikimi i tij të ketë pasur trajtim, e të jetë shqyrtuar më shumë prej kronistëve, historianëve, teologëve kulturologë e studiues të fushave e të disiplinave të ndryshme, tash e kaq shekuj, më shumë sesa Peygamberi, a.s.

Në këtë rrafsh bën pjesë edhe trashëgimia shkrimore, e cila është krijuar për jetën e Peygamberit, a.s., që nga poezia, proza, odet, kasidet, gazelet, mevludet, e deri tek monografitë e ndryshme, pothuajse në të gjitha gjuhët e besimtarëve myslimanë, anekënd botës.

Gjithsesi se është për t'u theksuar se historikisht besimtarët myslimanë nëpër botë, me përkushtimin më të madh e për

çdo vit, në ambientet familjare, po edhe nëpër xhami e institucione, e kujtojnë në formën më të mirë ditëlindjen e Pejgamberit të tyre, Muhamed Mustafasë. E, kujtimi i ditëlindjes së Pejgamberit, a.s., përtej dashurisë është edhe zotim e besatim për t'i ndjekur mësimet dhe porositë e Pejgamberit, a.s., si dhe është besnikëri ndaj rrugës dhe misionit të tij.

Shënimit të ditëlindjes së Pejgamberit, a.s., dhe manifestimit të muajit të mevludit, si shumë popuj të tjerë myslimanë, i kushtuan rëndësi dhe i dhanë specifika e tipare të veçanta e autoktone edhe shqiptarët, qysh se u bënë pjesë e fesë islame. Kësisoj, shënimi i manifestimit të kësaj ngjarjeje ndër ne ka një të kaluar të begatë dhe të shtrirë në kohë dhe në hapësirë, që në mënyrën më të mirë tregon për respektin dhe dashurinë tonë për Pejgamberin – Muhamedin, a.s. Kjo traditë e mishëruar thellë në kujtesën e popullit tonë vazhdon ende, dhe duhet të kultivohet edhe në ditët tona, e deri sa të jemi në këtë jetë.

Shqiptarët myslimanë jo vetëm se e kanë shënuar e manifestuar ditëlindjen e Pejgamberit, a.s., por shtresa intelektuale ka shkruar e hartuar edhe vepra të veçanta në formë të prozës e poezisë - rrëfenja e mevlude, ku me motive të thela islame e në mënyrë artistike i kanë përshkruar momentet më të rëndësishme të jetës, të veprës, të mrekullive dhe të misionit të Pejgamberit, a.s.

Kështu kanë lindur edhe mevludet e para, si krijimtari artistike letrare të shqiptarët, e ndër të parët, për aq sa dihet deri më sot, konsiderohet Mevludi i rilindësit tonë të shquar Hasan Zyko Kamberi, në shek. XVIII, për t'u pasuar prej shumë autorëve të tjerë, aq sa sot njihen mbi 30 mevlude të shkruara vetëm prej personaliteteve të njohura në fusha të

ndryshme të fesë dhe të letërsisë, e të cilët, me mjeshtërinë e tyre dhe në mënyrë artistike e shembullore, thurën lavde e konsiderata, si për askënd tjetër, për të Dërguarin e Allahut, xh.sh., Muhamedin, a.s. Ndër më të njohurit janë: Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Çami, Ismail Floqi, Hfz. Ali ef. Ulqinaku, Tahir ef. Popova, Hfz. Ali ef. Korça, Hfz. Ibrahim ef. Dalliu, Abdullah ef. Zëmplaku, Sheh Ahmet Shkodra, Hfz. Islam Nekovci, Mehmet ef. Salihu-Opoja, Ferit Vokopola, Idriz Lamaj, Fahrudin Osmani, e shumë të tjerë. Secili nga këto mevlude ka pasur shtrirje dhe ndikim më të madh në trevat ku janë hartuar, po edhe më gjerë. Mevludi i Tahir efendiut, nga fshati Popovë i Vushtrrisë së Kosovës, ka pasur dhe ka shtrirje dhe ndikim të madh në përgjithësi në territorin e Kosovës, po edhe në një pjesë të mirë të Maqedonisë së sotme. E meqë jemi te ky Mevlud, - i cili është hartuar sikurse edhe mevludet e tjera, sipas modelit të mevludit “*Vesîletu n-Nexhât*”, i shkruar më 1409, prej autorit turk Sylejman Çelebiut, quhet “*Vargje në gjuhën shqipe mbi lindjen e Qenies më të vlefshme (Mevludi)*” “*Manzûmetu ‘l-mevlûd fi efdali ‘l-mevxhûd bi lisâni ‘l-Arnaûd*”, - duhet përmendur se Tahir efendiut e Mevludi i tij e ka shkruar me shkronja arabe, po me fjalë në gjuhën shqipe e të renditura në bejte, duke respektuar rimën dhe metrikën e kësaj gjinie, dhe se falë stilit të tij të lehtë e të kuptueshëm ky mevlud, ndër besimtarët tanë, është mësuar përmendsh, aq sa mund të thuhet me siguri se ishin të paktë ata që nuk dinin përmendsh pjesë të këtij mevludit. Kjo flet vetvetiu se sa i pranishëm dhe sa i mishëruar ishte mevludi në masën e gjerë!

Mënyra e manifestim të Mevludit në Kosovë natyrisht se ka njohur ndryshime ndër vite, disa të kuptueshme, e disa,

për arsyet që do t'i përmendim më poshtë, fare të paarsyeshme e madje edhe joqëllimmira. Manifestimi i Mevludit në Kosovë, fjala vjen, gjatë viteve 1950-1990, e gjejmë të organizuar në dy rrafshë: atë institucional dhe atë në ambiente familjare.

Bashkësia Islame manifestimin e mevludit e organizonte në xhamitë e qendrave kryesore, ku merrnin pjesë imamët që kishin zërin më të mirë për ta kënduar mevludin, ndërsa besimtarët e shumtë që kishin ardhur aty e dëgjonin me vëmendje e disiplinë.

Zakonisht këto manifestime organizoheshin në natën e 12 të muajit Rebiul Evel, pas namazit të drekës apo edhe të iqindisë. Në këto manifestime, përveç këndimit të mevludit, ulematë mbanin edhe derse-ligjërata me tematikë nga jeta e Muhamedit, a.s., pastaj këndonin Kuran e ilahi të ndryshme, gjë që i jepte një atmosferë madhështore, me të gjitha elementet e kulturës e të traditës islame, që nga mënyra e mbajtjes së ligjëratave, këndimit të Mevludit, pastaj këndimit të ilahive, e deri te këndimi i Kuranit prej imamëve të përzgjedhur.

Edhe më madhështore kanë qenë manifestimet që organizoheshin në ambientet familjare, ku besimtarët, për ta kujtuar me dinjitet ditëlindjen e Pejgamberit, a.s., organizonin mevlud.

Madje, për të pasuar mundësi që të merrnin pjesë te njëritjetri, këtë manifestim e organizonin në ditë të ndryshme, aq sa i tërë muaji Rebiul Evel kalonte në këtë atmosferë festive.

Për manifestimin e mevludit, krahas hoxhallarëve që bënin këndimin e tij, ftoheshin edhe fisi, miqtë, fqinjët e dashamirët, të cili kur shkonin në mevlud, visheshin në rroba so-

lemne, ngase ishin të bindur që po shkonin në një manifestim ku kujtohej i Dërguari i Allahu, xh.sh.

Në odën ku mbahej manifestimi i mevludit, hoxhallarët zinin vend në krye të konakut, dhe para këndimi të mevludit për të pranishmit mbanin ligjërata kushtuar jetës së Pejgamberit, a.s., duke nisur që nga prindërit e tij, a.s., e posaçërisht për jetën e të Dërguarit, që nga lindja, e deri në kalimin në ahiret, e pastaj flisnin për parimet e Islamit dhe çështjet e tjera që kishin të bënin me fenë.

Para se të niste këndimi i mevludit këndohej, të paktën, një pjesë-ashere nga ajetet e Kuranit, dhe kjo përsëritej edhe në gjysmë të mevludit dhe në fund të tij. Aty këndoheshin pareshtur, prej hoxhallarëve dhe xhematit bashkërisht, edhe salavatet, ndërsa në fund të fasilit, kur paralajmërohej lindja e Pejgamberit, a.s., gjithë të pranishmit, në shenjë respekti, ngriheshin në këmbë, ktheheshin nga Kibla dhe këndonin salavate në kor.

Në fund të mevludit imami bënte dua, ndërsa pas duasë të pranishmit e uronin dhe luteshin për atë që ishte bërë se bep, si dhe për familjen dhe shtëpinë e tij.

Mevludi te ne është kënduar edhe në raste të gëzimeve, si me rastin e hyrjes në shtëpi të re, me rastin e lindjes së fëmijëve, po edhe për gëzime të tjera. Mevludi është kënduar edhe në ato raste kur besimtari ka pasuar ndonjë qeder dhe ka shpëtuar, si dhe në raste të vdekjeve në familje.

Mevludi në Kosovë ka qenë i përhapur si manifestim edhe gjatë muajit të madhëruar Ramazan, kur xhamatliu që e thërriste farefisën për iftar, organizonte dhe mevlud, e që këndohej pas faljes së namazit të iqindisë, dhe për këtë kishte një rend dhe garë midis xhematit.

Nga këto pak të dhënë që ofruam gjer këtu, mund të kup-tohet se manifestimi i mevludit në Kosovë kishte një shtrirje të gjerë në masën e besimtarëve, madje ishte si një ndër manifestimet më popullore, dhe kjo për faktin se gati i tërë manifestimi mbahej në gjuhën shqipe, dhe kur kësaj i shtohet edhe se mesazhi i mevludit në përgjithësi ishte fisnikërimi i njeriut dhe njohja e tij me fenë islame, mund të merret me mend pse një manifest i tillë ishte aq i përhapur te ne.

Manifestim i Mevludit prej ulemave u shfrytëzua për shpjegimin e mësimëve islame, ngase në manifestim e mevludit xhemati kishte mundësi që të bashkëbisedonte me ho-xhën për çështjet fetare, e që nuk mund t'i diskutonte në xhami.

Gjithashtu, mevludi si manifestim ka luajtur edhe rol mobilizues për mësimet dhe kulturën fetare te ne, megjithëqë popullata jonë pati fatin e keq të jetojë në sistemin socialist. Hartimi dhe manifestimi i mevludit ka luajtur një rol me rëndësi edhe për ruajtjen e identitetit tonë kombëtar, po edhe për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Kjo është një e dhënë e padiskutueshme dhe mjaft domethënëse. Në anën tjetër, autorët e mevludeve, duke qenë fetarë dhe atdhetarë të dëshmuar, kanë synuar që në bejtet e tyre, përveç frymëzimit fetar, ta ngjallin edhe vetëdijen kombëtare. Ja se si shkruan Hafëz Ali Korça i mirënjohur, ndër të tjerash, në Mevludin e tij:

“Për udhërrfenjës mjaft kemi Kuranë

Po mbajtëm Kuranë mbajtëm lumturinë

Me të mund ta mbajmë din e kombësinë”.

Ose:

“Zot! Le të na rojë Atdhe’ Kombësija

Aqë sa të rrojë edhe gjithësia!”

Vlerat e mevludit bëhen gjithnjë e më të mëdha edhe për faktin se autorë të mevludeve kanë qenë njerëz të shquar në vendin tonë, ulema të ditur e vizionarë, të cilët jo vetëm se nuk kanë bërë ndonjë kritikë për këndimin e mevludit, por duke shkruar mevlude vetë, ata edhe janë bërë të njohur në këtë fushë. Sikundër që në atë kohë kanë jetuar edhe shumë ulema të tjerë të shquar, të cilët e kanë predikuar fenë tonë, dhe të cilët jo vetëm se nuk e kanë kundërshtuar këtë praktikë, por, përkundrazi, e kanë kënduar mevludin, ose kanë marrë pjesë në këto ceremoni. Dhe, kështu ka vazhduar deri para dy-tri dekadave, kur filloi një debat i kotë për Mevludin dhe manifestimin e tij në fenë islame, debat ky i iniciuar nga disa kuadro të diplomuar në botën arabe dhe të pavetëdijshëm, të painformuar dhe me dije të varfra për mevludin si përmbajtje, si manifestim dhe si krijimtari artistike letrare etj.

Hapja e këtij debati solli një konfuzion e huti në xhematin tonë, mirëpo te gjenerata e vjetër nuk pati ndonjë ndikim të madh; ndikimi negativ i këtij debati pati njëfarë efekti te gjenerata e re, të cilët, të ndikuar nga ky debat, sikur e lanë anash organizimin e manifestimit tradicional të mevludit. Fatmirësisht, zërat e tillë gjithnjë e më shumë po zbehen dhe po mbesin të vetmuar e të papëlqyer nga xhemati.

Një segment tjetër që ka pasur një ndikim në zbehjen e manifestimit të mevludit është edhe një tentim për ta bërë më bashkëkohore mënyrën e manifestimin e mevludit, sikurse, fjala vjen, tendenca për organizimin e manifestimeve fetare,

madje edhe të mevludit, jashtë xhamive dhe jashtë ambienteve familjare, si në salla sporti, amfiteatro etj., ku në emër të modernizimit të manifestimit të mevludit e humbin atmosferën dhe ndikimin tradicional islam.

Që mos t'u jepet hapësirë këtyre ndikimeve negative që po zbehin atmosferën dhe rolin e mevludit ndër ne, mendoj, sikurse e kam thënë edhe herë të tjera, se institucionet fetare të ne, e në këtë rast Bashkësia Islame e Kosovës, me të gjitha institucionet e veta, duhet të tregohen më rigorozë në ruajtjen e trashëgimisë pozitive islame, siç është edhe organizimi i manifestimit të mevludit nëpër xhamitë qendrore të qendrave kryesore. Le të ndalet debati i hoxhallarëve me xhematin për traditën pozitive dhe, nëse paraqitet nevoja për një debat të tillë, ai le të bëhet nga njerëzit kompetentë dhe të dëshmuar në fushat përkatëse. Në institucionet arsimore, në medrese dhe në Fakultetin e Studimeve Islame duhet t'i kushtohet rëndësi më e madhe lëndës së Qytetërimit Islam, në të cilën duhet të vihet theksi në trashëgiminë pozitive islame, siç janë personalitet e njohura të ulemave tanë, pastaj kultura materiale islame, me të gjitha vlerat e veta, si dhe trashëgimia kulturore e shkruar dhe ajo shpirtërore. Le të stimulohen dhe të motivohen talentet e reja për hartime të mevludeve të reja. Në periodikun e bashkësisë islame të ne, poedhe në trevat e tjera shqiptare, duhet t'i kushtohet më shumë hapësirë mevludeve si krijimtari artistike, letrare, pa harruar edhe vlerat fetare e kulturore.

Imamët duhet t'i kushtojnë më shumë rëndësi sensibilizimit të besimtarëve për organizimin dhe manifestimin e mevludeve. Gjithashtu duhet të ruhet edhe mënyra tradicionale e manifestimit dhe e këndimit të mevludit. Sepse, përmes ma-

nifestimit të mevludit, synohet nderimi ynë ndaj personalitet të Muhamedit, a.s., synohet dashuria ndaj tij dhe dashuria ndaj Pejgamberit, a.s., është përkushtim ndaj Allahut, xh.sh.; me të synohet mësimi i vlerave fetare, letrare, gjuhësore, historike, kulturore, gjuhësore dhe atdhetare të përmbajtjes, të formës e të ceremonialit të tij, si dhe synohet forcimi i frymës së bashkimit, mirëkuptimit, bashkëpunimit e tolerancës midis besimtarëve dhe midis njerëzve në përgjithësi, si krijesa të Allahut, xh.sh.

Allahu xh.sh., - përmes Xhibrilit - i kishte thënë Muhamedit, a.s., që t'u thoshte myslimanëve:

قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ

“Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë ju dhe t’ua falë mëkatet!” (Kuran, Ali Imran, 31)

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

“Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij e përshëndesin Pejgamberin, prandaj edhe ju, o besimtarë, përshëndetni atë me përshëndetje meritore!” (Kuran, Ahzab, 56)

Dr. Sedat ISLAMI

LUTJE TË VEÇANTA TË PROFETIT MUHAMED A.S. PËR YMETIN

HYRJE

Lidhja e Profetit Muhamed a.s. me ymetin ishte e veçantë. Nuk ishte vetëm kryerja e misionit me besnikërinë dhe përkushtimin më të madh ajo për të cilën karakterizohej kjo lidhje, por edhe aspekti emocional dhe shpirtëror i saj. Kurani dhe Syneti na ofrojnë dëshmi e prova përkatëse për këtë lidhje dhe këto dimensionë të saj. Allahu i Madhëruar duke e përshkruar Profetin Muhamed a.s. dhe raportin e tij me besimtarët thotë:

﴿لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ بِالْمُؤْمِنِينَ رَؤُوفٌ رَّحِيمٌ﴾

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, ua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Et Teube, 128).

Ibën Kethiri, duke e komentuar këtë ajet, vë në pak pikërisht këto dimensionë të kësaj lidhje. Ai thotë se Profetit a.s. i vjen rëndë dhe e shqetëson çdo gjë që e lodh dhe mundon

ymetin e tij, sikur që ai është kureshtar për ta udhëzuar atë dhe për ta shpjerë te çdo e mirë e kësaj dhe botës tjetër.¹

Këto ndjenja dhe këtë lidhje që ka pasur me ymetin, na i ka shpalosur edhe vetë Profeti a.s.. Ajshja r.a., rrëfen: Një ditë e pashë Profetin a.s. në qejf, andaj i thashë: “O i Dërguari i Allahut, lute Allahun për mua!” Ai u lut: “*O Allahu im, falja Ajshes mëkatet e mëparshme dhe të ardhshme, të fshehtat dhe të dukshmet!*” Aishja r.a., (nga gëzimi) qeshi aq shumë, saqë koka e saj ra në prehrin e të Dërguarit të Allahut. “*A të gëzoi dua ja ime?*” - iu drejtua Profeti a.s.. E si të mos më gëzojë dua ja jote - iu përgjigj Aisheja r.a.. Atëherë Profeti a.s. tha:

وَاللَّهِ إِذَا لَدَعَوْتِي لِأُمَّتِي فِي كُلِّ صَلَاةٍ

“*Betohem në Allahun, ajo është lutja me të cilën lutem për ymetin tim në çdo namaz!*”²

Jo vetëm kaq. Edhe lutjen që e kishte si privilegj profetik e kishte ruajtur për ne. Ebu Hurejre r.a., përcjell se Profeti a.s. ka thënë:

لِكُلِّ نَبِيٍّ دَعْوَةٌ مُسْتَجَابَةٌ، فَتَعَجَّلْ كُلُّ نَبِيٍّ دَعْوَتَهُ وَإِنِ احْتَبَأْتُ
دَعْوَتِي شَفَاعَةً لِأُمَّتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ

“*Secili profet ka pasur (në dispozicion) një lutje të pranuar dhe secili prej tyre e ka shfrytëzuar këtë mundësi. Ndërsa unë e kam fshehur lutjen time që të jetë ndërmjetësim për ymetin tim në Ditën e Llogarisë...*”³

¹ Shih: Ismail bin Omer bin Kethir, *Tefsiru el Kur’ani el adhimi*, (Rijad: Dar Tadjiba li en neshri ve et teuzië, ed. 2, 1999), 4/241.

² Hadithin e shënon Ibën Hibbani në *Sahih*, nr. 7111, dhe të tjerë, ndërsa Albani, në *Es silsiletu es sahihah*, nr. 2254, e klasifikon si hadith hasen.

³ Buhariu, nr. 6304; Muslimi, nr. 198; 199. Teksti është i Muslimit.

Pra, lutja, siç shihet, është një lidhje e veçantë e cila shpreh dashurinë e madhe të Profetit a.s. për ne. Në këtë punim, ne do të ofrojmë një përmbledhje lutjesh të veçanta të Profetit a.s. për ymetin, lutjet për t'i shpërblyer me tûba⁴. Më saktë, do të prezantojmë shtatë hadithe me këtë tematikë, duke i paraprirë me një shpjegim për tûba-në dhe domethënien e saj.

TÛBA DHE KUPTIMET E SAJ

Tûba (ar. طوبى) është një shprehje arabe, e përdorur në Kuran dhe hadithe. Në kaptinën Rra'd, ajeti 29, Allahu i Madhëruar, duke folur për shpërblimin e besimtarëve që bëjnë vepra të mira thotë:

الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ طُوبَىٰ لَهُمْ وَحُسْنُ مَآبٍ ﴿٢٩﴾

“Për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira ka çdo mirësi dhe vendbanim të mrekullueshëm!”

Dijetarët, siç shënon Imam Maverdi,⁵ kanë tri mendime për sa i përket origjinës së kësaj shprehje: disa mendojnë se është etiopiase, të tjerët thonë se është indiane, ndërsa të tretët mendojnë se është arabe. Këtë, mendimin e fundit, e mbështesin shumica e dijetarëve. Ndërsa sa i përket kuptimit të kësaj shprehje, dijetarët, klasikë e bashkëkohorë, kanë për-

⁴ Referencë të cilës i jemi mbështetur fillimisht dhe nga e cila jemi frymëzuar për këtë punim kemi artikullin e Fehd bin Abdul Aziz bin Abdullah Shuvejrih “*Men dea lehun err Rresulu alejhissalatu vesselamu bi: tuba*”, i publikuar në <https://ar.islamway.net/> më 28-06-2023. Artikulli është shfletuar më 10 gusht 2023.

⁵ Shih: Ali bin Muhamed el Maverdi, *Tefsir el Maverdi*, (Bejrut: Dar el kutub el ilmije, p.v.b.), 3/110-11.

mendur kuptime të përiferëta të saj. Imam Taberiu⁶ ka përmbledhur disa nga këto kuptime që dijetarët kanë ofruar:

- sa të mirë të madhe që kanë;
- fatbardhësi e fatmirësi;
- gëzim dhe prehje shpirtërore;
- përfundim të mirë ose më të mirën do ta kenë;
- mirësi për ta;
- emër i Xhenetit, respektivisht për ta është Xheneti. Për këtë shkak është thënë se kjo fjalë ka origjinë indiane ose sipas Ibën Abasit r.a., etiopase pasi që në gjuhën e tyre kështu i thuhet tokës së Xhenetit;⁷
- pemë në Xhenet.

Imam Maverdi dhe Ibën Xheuziu kanë shtuar edhe *jetën e mirë*, pra do të kenë jetë të mirë, dhe *gjendjen e këndshme*.⁸ Nga bashkëkohorët, Sharavi, ka ofruar një kuptim përmbledhës. Ai thotë se *tûba* përmbledh të mirën e të këndshmen në çdo formë e dimension: çdo gjë që besimtarët duan, do ta kenë në formë të mirë e të këndshme...⁹

⁶ Shih: Muhamed bin Xherir et Taberiu, *Xhamiu el bejan fi te'vili aji el Kuran*, ver. Ahmed Muhamed Shakir, (Bejrut: Muessesetu err rrisale, 2000), 16/434-437.

⁷ Shih: Abdurrahman bin Ali bin Muhamed el Xheuzij, *Zad el mesir*, (Bejrut: Dar el kitab el arabij, 1422 h.), 2/494; Ismail bin Omer bin Kethir, *Tefsiru el Kur'ani el adhim*, vep. cit., 4/455.

⁸ Shih: Ali bin Muhamed el Maverdi, *Tefsir el Maverdi*, vep. cit., 3/111; Abdurrahman bin Ali bin Muhamed el Xheuzij, *Zad el mesir*, vep. cit., 2/494.

⁹ Shih: Muhamed Muteveli Sharavi, *Tefsir esh Sharavi*, (Kajro: Metabiu Ahbar el Jevm, 1997), 12/7329. Edhe në shqip është përkthyer me këto kuptime: *lumturi, fatbardhësi; lumturi e plotë; bekim; i lumi ti, lum ai; lumi ti! lum për ty!*; *vepra të mira; gjëra të bukura, të mira; elegancë, hollësi; më i mirë; më i këndshëm; më e këndshme; më i lezetshëm, më e lezetshme, më i shijshëm, më e shijshme; mirësi, kënaqësi e madhe shpirtërore, shëndet.*

Edhe komentuesit e haditheve kanë dhënë kuptime të ngjashme. Në fakt, në hadithe, tekstualisht *tûba* prezantohet si pemë në Xhenet. Siç shënojnë imamët, Ahmedi dhe Ibën Hibani në veprat e tyre, Profeti Muhamed a.s. ka thënë:

طوبى شجرة في الجنة ، مسيرة مائة عام ، ثياب أهل الجنة تخرج من
أكمامها

“Tûba është pemë në Xhenet, gjerësia (apo hija) e së cilës është sa njëqind vite kalërim; rrobat e banorëve të Xhenet bëhen nga kupat e luleve¹⁰ të saj.”¹¹

Bazuar në shpjegimet e mëparshme, mund të themi se *tûba* është emër i përgjithshëm që përfshin pemën në Xhenet, por edhe të mirat e tjera në përgjithësi, sepse i këtillë, i mirë dhe i këndshëm me kuptimin e plotë të fjalës, është shpërblimi i besimtarëve në këtë dhe botën tjetër.

Pikërisht për shkak të këtyre kuptimeve kemi preferuar që, në këtë punim, këtë shprehje ta përdorim në origjinal.

Shih: Isa Memishi, Fjalor arabisht-shqip, (Prishtinë: Sh. B. ‘Libri shkollor’, 2011), 2/1138-1139; Sylejman Tomçini, Fjalor arabisht-shqip, (Tiranë: AIITC, 2010), f. 556.

¹⁰ Fletë të vogla të gjelbra, të vendosura në trajtë hinke, që mbështjellin dhe mbrojnë burbuqen e lules. Kupa e lules (e karafililit, e trëndafililit). Shih: <https://fjale.al/kupë>

¹¹ E ka saktësuar Albani në *Sahih el Xhami*, nr. 3918.

HADITHET ME SHPJEGIM

Hadithi 1: *Tûba* për ata që e kanë besuar Profetin a.s..

Në hadithin e përcjellë nga Ebu Seid el Hudriji r.a., qëndron se Profeti a.s. ka thënë:

طُوبَى لِمَنْ رَأَى وَأَمَّنَ بِي، ثُمَّ طُوبَى، ثُمَّ طُوبَى، ثُمَّ طُوبَى لِمَنْ آمَنَ بِي
وَمَا يَرِينِي

“*Tûba* për atë që më ka parë dhe më ka besuar. *Tûba*, *tûba*, *tûba* për atë që më ka besuar, ndërsa nuk më ka parë.”¹²

Në këtë hadith, *tûba*, siç shohim, u është premtuar dy grupeve të besimtarëve:

- 1) atyre që e kanë besuar Profetin a.s. duke e parë, pra sahabëve, dhe
- 2) brezave të mëvonshëm që do ta besojnë atë ndonëse nuk e kanë parë e takuar fizikisht.

Parimisht, besimi në Profetin a.s. dhe misionin e tij është kusht pa të cilin nuk vlen imani, porse ne këtu, krahas besimit, gjejmë diçka të veçantë që mbase ka përcaktuar këtë përmendjen e shpërblimit të shumëfishtë me *tûba* për besimtarët e fundit, që e besojnë megjithëqë nuk e kanë parë Profetin a.s.. Munaviu, duke shpjeguar arsyen e veçimit me këtë shpërblim, ka thënë: “Allahu ka lëvduar besimtarët për besimin e tyre në të fshehtën - gajbin. Brezat e parë besuan duke

¹² Hadithin e shënojnë Imam Ahmedi në *Musned*, nr. 11673, dhe të tjerë. Albani në *Es silsiletu es sahihatu*, nr. 1241, e ka saktësuar. Hadithi ka dhe versione të tjera, të ngjashme me këtë që sollëm në punimin tonë.

e parë e dëshmuar Profetin a.s., ndërsa brezat e mëvonshëm besuan pa mosparaqitje (pa e parë) atë që brezat e parë e besuan duke (e parë) e dëshmuar.”¹³

Kjo flet për pozitën e lartë të brezave të mëvonshëm të besimtarëve që besojnë pa parë provat dhe dëshmitë (mrekullitë) që panë sahabët. Disa dijetarë, si p.sh., Ibën Abdul Berrri, shënon Munaviu,¹⁴ bazuar në këtë, kanë ardhur deri te konstatimi, ndonëse nuk mbështeten nga pjesa dërrmuese e dijetarëve - *xhumhuri*, se disa nga besimtarët e mëvonshëm kanë vlerë më të madhe se disa sahabë veç e veç. Ky hadith mund të konstatojë vlerën e madhe të besimit në Profetin a.s. pa e parë, por jo edhe për t’i vlerësuar brezat e mëvonshëm ndaj brezave të parë. Askush nuk mund të krahasohet me sahabët - ka konstatuar me të drejtë Kastalani.¹⁵

Ky hadith është nxitje për ta besuar Profetin a.s. dhe për ta ndjekur rrugën e tij. Këtë e dëshmon edhe shkaku pse është thënë ky hadith. Ibën Hamza, si shkak të këtij hadithi ka përmendur pyetjen që i ishte bërë Profetit a.s.: “Çfarë thua për atë që të beson ndonëse nuk të ka parë, dëshmon për vërtetësinë e misionit tënd pa të parë?” “Ata janë vëllezërit e mi, janë me mua!” - kishte thënë Profeti a.s..¹⁶ Ndryshe, lidhja e

¹³ Muhamed bin Ali el Munavi, *Et tejsir bi sherhi el Xhami'i es sagir*, (Rijad: Mektebetu el Imami esh Shafi'ij, ed. 3, 1988), 2/119.

¹⁴ Muhamed bin Ali el Munavi, *Fejdu el Kadir sherhu el Xhami'i es sagir*, (Egjypt: El mektebetu et tixharije el kubra, 1356 h.), 4/279.

¹⁵ Shih: Hamza Muhamed Kasim, *Menar el karij sherhu Muhtesari Sahihi el Buhari*, (Damask - Taif: Mektebetu Dar el bejan – Mektebetu el Muejjed), 4/258.

¹⁶ Ibrahim bin Muhamed Ibën Hamza, *El bejan ve et ta'rif fi esbabi vurudi el hadithi esh sherif*, (Bejrut: Dar el kitab el arabij), 2/94.

Profetit a.s. me besimtarët e brezave të mëvonshëm është faktuar edhe me tekste të tjera. Në Sahihun e Muslimit (nr. 249), përcillet nga Ebu Hurejre r.a., se Profeti a.s. ka thënë: “Sa do të doja t’i shihja vëllezërit tanë!” “Po ne a nuk jemi vëllezërit tu? - e pyetën. Tha: “Ju jeni shokët e mi, vëllezërit e mi ende nuk kanë ardhur...”

Kjo dashuri është e ndërsjellë, sepse siç tregon vetë Profeti a.s., edhe besimtarët e këtyre brezave të mëvonshëm, do ta duan shumë atë, saqë ndonjëri prej tyre vetëm për ta parë do të jepte çdo gjë. Profeti a.s. ka thënë: “Ata që më duan më së shumti nga ymeti im janë njerëzit që do të vijnë pas meje prej të cilëve dikush do të sakrifikonte me pasurinë e familjen vetëm për të më parë.”¹⁷

Hadithi 2: *Tûba* për gurebâtë

Ebu Hurejre r.a., përcjell se Profeti a.s. ka thënë:

بَدَأَ الْإِسْلَامَ غَرِيْبًا، وَسَيَعُوْدُ كَمَا بَدَأَ غَرِيْبًا، فَطُوبَىٰ لِلْغُرَبَاءِ

“Islami ka filluar si i huaj e i panjohur, dhe i këtillë, i huaj e panjohur, do të kthehet, siç ka filluar, e tûba për këta të huaj e të panjohur!”¹⁸

Gurebâtë janë njerëzit që përqafojnë fenë apo e mbajnë atë kur të tjerët nuk e bëjnë. Janë ata që sakrifikojnë për fenë dhe mbajnë atë atëherë kur mbajtja e saj është sikur të mbash gacat e zjarrit në dorë. Këta nuk janë njerëz pasivë, të cilët fenë e mbajnë veç për vete, jo, janë aktivë, të atillë që ndre-

¹⁷ Hadithin e shënon Muslimi, nr. 2832.

¹⁸ Hadithin e shënon Muslimi, nr. 145.

qin prishjet dhe dëmet e shkaktuara nga të tjerët. Kështu në fakt është interpretuar nga vetë Profeti a.s..¹⁹ Pavarësisht se nuk do të kenë mbështetje, ata do ta kryejnë punën e tyre. Profeti a.s., duke i përshkruar, ka thënë: “Tûba për gurebâtë, njerëz të mirë në mesin e të këqijve të shumtë; ata që i kundërshtojnë janë më shumë se ata që iu binden.”²⁰

Këta njerëz janë besimtarë që janë shfaqur në fillim të Islamit, kur kishte pak pasues, e do të shfaqen edhe në fund të kohës, kur do të ketë pak pasues.²¹ Bëhen të këtillë, *gurebâ*, për shkak se njerëzit i bojkotojnë dhe braktisin.²² Mund të tingëllojë paksa dëshpërues fakti që do të ketë pak, por nga aspekti tjetër, ai i të qenët të një grupi përherë në të vërtetën, del shpresdhënës. E mira nuk do të humbasë dhe për sa kohë të rrojë njerëzimi, do të rrojnë edhe e mira dhe e vërteta.

Së këndejmi, në këtë hadith, besimtarët nxiten ta mbajnë fenë e tyre,²³ prandaj edhe disa dijetarë parapëlqejnë që të komentojnë gurebâtë si reformatorë që ndreqin atë që është prishur, jo thjesht si një grup besimtarësh nga e kaluara.²⁴

¹⁹ Shih hadithin nr. 1273 në veprën *Es silsiletu es sahihah*.

²⁰ Hadith i saktë. Shih *Es silsiletu es sahihah*, nr. 1619.

²¹ Shih: Xhelaludin Sujuti, *Ed dibaxh ala Sahihi Muslim bin Haxhaxh*, (Hubër (Arabi Saudite): Dar Ibën Affan, 1996), 1/164.

²² Shih: Ali bin Muhamed Mulla el Herevij el Karij, *Mirkatu el mefatih sherhu Mishkati el mesabih*, (Bejrut: Dar el fikr, 2002), 1/243.

²³ Shih: Grup autorësh, *Sherhu Suneni Ibni Maxheh*, (Karaçi: Kadimi kutub haneh), f. 287; Ubejdullah bin Muhamed el Mubarekfuli, *Mir'atu el mefatih sherhu Mishkati el mesabih*, (Varanas (Indi): Universiteti Selefit, ed. 3, 1984), f. 255.

²⁴ Disa dijetarë mendojnë se me gurebâ janë për qëllim muhaxhirët e parë. Shih: Ali bin Muhamed Mulla el Herevij el Karij, *Mirkatu el mefatih sherhu Mishkati el mesabih*, vep. cit., 1/243.

Hadithi 3: *Tûba* për ata që kërkojnë falje

طُوبَى لِمَنْ وَجَدَ فِي صَحِيْفَتِهِ اسْتِغْفَارًا كَثِيْرًا

“*Tûba* për atë që në fletushkën e veprave gjen istigfar të shumtë!”²⁵

Mëkati është në natyrën e njeriut, por insistimi në mëkat nuk përkon me natyrën e besimtarit. Ky i fundit nuk ngul këmbë në mëkat, përkundrazi. Duke e ndjekur shembullin e Profetit Muhamed a.s., kërkon falje shumë. Profeti a.s. kërkonte falje gjatë ditës më shumë se shtatëdhjetë herë. Në këtë hadith, besimtari nxitet për istigfar ose kërkimfalje për mëkatet me të mirat që gjen në botën tjetër. Brenda fjalëve të hadithit aludohet në regjistrimin e veprave tona dhe llogarinë për to në botën tjetër. Dikush mund të gjejë mirë e dikush keq, varësisht nga ajo që ka bërë. Kurani na mëson se veprat regjistrohen, të gjitha,²⁶ dhe se njeriu do ta lexojë librin e veprave të veta.²⁷ Mulla Ali el Kariu, shpjegon se në hadith aludohet edhe në sinqeritet, respektivisht në kryerjen e veprave me sinqeritet, duke përfshirë me theks të veçantë këtu kërkimfaljen, përndryshe, po të mungonte sinqeriteti, kjo vepër do t’i bëhej hi e pluhur.²⁸ E arsyeja pse është përmendur istigfari në këtë hadith dhe jo ndonjë vepër tjetër është, siç shënon

²⁵ Hadithin e shënon Ibën Maxheh, nr. 3818. Albani e ka saktësuar në *El mishkah*, nr. 2356.

²⁶ El Kehf, 49.

²⁷ El Isra, 14.

²⁸ Ali bin Muhamed Mulla el Herevij el Karij, *Mirkatu el mefatih sherhu Mishkati el mesabih*, vep. cit., 4/1632.

Munaviu, se nuk ka vepër të ngjashme që e shpëton besimtarin sikur istigfari.²⁹

Hadithi 4: *Tûba* për ata që janë çelës të hairit

Enesi r.a., përcjell se Profeti a.s. ka thënë:

إِنَّ مِنَ النَّاسِ مَفَاتِيحَ لِلْحَيْرِ، مَعَالِيْقَ لِلشَّرِّ، وَإِنَّ مِنَ النَّاسِ مَفَاتِيحَ
لِلشَّرِّ مَعَالِيْقَ لِلْحَيْرِ، فَطُوبَى لِمَنْ جَعَلَ اللهُ مَفَاتِيحَ الْحَيْرِ عَلَى يَدَيْهِ،
وَوَيْلٌ لِمَنْ جَعَلَ اللهُ مَفَاتِيحَ الشَّرِّ عَلَى يَدَيْهِ

“Ka njerëz të cilët janë çelësa të hairit dhe dry të sherrit dhe ka të tjerë që janë çelës të sherrit dhe dry të hairit. Tûba për atë që Allahu ka bërë çelësat e hairit të jenë në dorën e tij e vejl³⁰ (mjerë) për atë që Allahu ka bërë që çelësat e sherrit të jenë në dorën e tij!”³¹

Angazhimi me vepra të mira nuk është vetëm çuarje në vend të një urdhri fetar. Është dhe një tregues i një përzgjedhje hyjnore që i bëhet njerëzve. Kush bën mirë ka fituar dashurinë e Allahut, sepse kur Allahu ta dojë robin, e angazhon atë me vepra të mira. Kjo përzgjedhje është e kushtëzuar me përmbushjen e veprave të mira. Nëse njerëzit heqin dorë nga misioni, iu hiqen privilegjet. Profeti a.s. ka thënë: “Allahu ka disa robër, të cilët i ka veçuar me mirësi për t’iu bërë mirë

²⁹ Muhamed bin Ali el Munavi, *Et tejsir bi sherhi el Xhami’i es sagir*, vep. cit., 2/120.

³⁰ Edhe kjo shprehje ka më shumë se një kuptim. Gjuhësisht nënkupton mjerimin, por përdoret edhe si emër i një luginë në Xhehenem.

³¹ Hadithin e shënon Ibën Maxheh, nr. 237. Albani e ka vlerësuar si hadith hasen në *Es silsiletu es sahihatu*, nr. 1332.

njerëzve, mandatin e të cilëve e miraton për aq kohë sa ata e shpenzojnë (pasurinë për këtë qëllim). Ndryshe, nëse ndodhë që ata të mos e japin (pasurinë), atëherë Ai i privon prej saj dhe atë ua bartë të tjerëve.”³²

Në këtë hadith ka një nxitje për angazhim me vepra të mira. Kjo nënkuptohet nga fjala çelës që ka ardhur në shumës³³, për të na treguar se askush nuk duhet të heq dorë nga punët e mira, sepse ato janë shumë dhe se secili mund ta gjejë një të atillë me të cilën i bën shoqërisë dobi. Edhe fakti se nuk janë përmendur vepra të caktuara lë të kuptohet se me to synohet çdo vepër e mirë. Nga kjo perspektivë në këtë hadith përshkruhet dimension i shoqëror i besimtarit dhe se ai nuk izolohet nga shoqëria vetëm se atëherë kur, prania fizike e tij në mesin e të tjerëve nuk do të ketë asnjë ndikim për ndryshim pozitiv të gjërave, siç do të shpjegojmë në hadithin e fundit.

Në hadith bëhet thirrje edhe për kujdes dhe shmangie nga veprat e këqija, sepse edhe ato janë shumë.

Hadithi 5: *Tûba* për ata që janë udhëzuar në Islam dhe bëjnë jetë modeste

طُوبَى لِمَنْ هُدِيَ لِلْإِسْلَامِ، وَكَانَ عَيْشُهُ كَفَافًا، وَفَنَعَ

“Tûba për atë që është udhëzuar në Islam, që bën jetë modeste dhe që është i kënaqur me atë që e posedon!”³⁴

³² Albani në *Es-Silsiletu-s-Sahihah*, nr. 1692, sipas dëshmimeve, e vlerëson në gradën hasen.

³³ Shih: Ali bin Muhamed “مفاتيح الخير ومفاتيح الشر فمن أيهما نحن” publikuar në www.alukah.net më 27/3/2022, shfletuar më 10 tetor 2023.

³⁴ Hadithin e shënojnë Tirmidhiu, nr. 2349, dhe të tjerë. Albani e ka saktësuar në *Sahih el Xhami*, nr. 3931.

Në këtë hadith fshihet sekreti i jetës së lumtur, jetës që përmbledh aspektin shpirtëror dhe material. Të jesh mysliman është mirësia më e madhe me të cilën begatolesh, sikur që mirësi është dhe të disponosh me të mira materiale, modeste dhe të jesh falënderues për to. Theksimi i jetës modeste, me një pasuri që të mjafton, është bërë për të mos e angazhuar besimtarin nga përkushtimi fetar, por dhe për të mos e tiranizuar. Dhënia pas pasurisë dhe grumbullimit të saj, edhe nëse nuk të bën tiran, mund të ta marrë kohën vitale për adhurim. Në koment të hadithi është thënë se mirësia e Zotit ndaj teje plotësohet kur të begaton me furnizim që të mjafton (për të bërë jetë normale) dhe të parandalon nga gjërat që të bëjnë të vrazhdë.³⁵

Natyrisht, jo çdokush di ta vlerësojë këtë, prandaj edhe potencohet në fund të hadithit që të pajtojë me këtë gjendje. Pajtimi me atë që ta ka dhënë Allahu është sekreti i lumturisë shpirtërore. Profeti a.s. e ka quajtur njeriun e tillë si njeriu më i pasur.³⁶ Kjo çështje lidhet edhe me besimin. Arsyeja pse pajton besimtari me këtë është se e di se i është e caktuar nga Allahu i Madhëruar.³⁷

Sigurisht kjo nuk është thirrje për pasivitet dhe aq më pak arsyetim të pasivitetit me kader. Hadithi duhet të lexohet në kontekst pozitiv, të nxitjes për përkushtim shpirtëror e asketizëm, ndryshe nëse besimtari fiton pasuri dhe e përdorë siç

³⁵ Munavi, *Fejdu el Kadir sherhu el Xhami'i es sagir*, vep. cit., 2/729; Muhammed Abdurrahman Mubarekfuri, *Tuhfetu el ahvedhi bi sherhi Xhami et Tirmidhij*, (Bejrut: Dar el kutub el ilmije), 7/13.

³⁶ Shih hadithin nr. 2305 në *Sunenin e Tirmidhiut* të cilin Albani në *Sahih el Xhami*, nr. 7833, e ka saktësuar.

³⁷ Munavi, *Fejdu el Kadir sherhu el Xhami'i es sagir*, vep.cit., 4/282.

duhet, atëherë ajo është e mirë, mu ashtu siç na ka mësuar Profeti a.s..³⁸

Hadithi 6: *Tûba* për jetëgjatët që bëjnë vepra të mira

Abdullah bin Busri r.a., përcjell se Profeti a.s. ka thënë:

طُوبَى لِمَنْ طَالَ عُمُرُهُ، وَحَسَنَ عَمَلُهُ

“*Tûba për atë që jeton gjatë dhe bën vepra të mira!*”³⁹

Në këtë hadith, Profeti a.s. për një besimtar që rron gjatë dhe bën vepra të mira, lutet që Allahu ta begatojë me të mira në të dyja botët. Jeta e gjatë nënkupton mundësinë më të madhe për të bërë vepra të mira më shumë, për t’u penduar dhe për ta ndrequr gabimin e së kaluarës, prandaj Tibiu, kohën e krahason me kapitalin material, i cili sa më i shumtë që të jetë aq më shumë i siguron fitime tregtarit.⁴⁰ Kjo periudhë e gjatë e jetës njeriut ia mundëson atij që ta njoh Allahun më mirë dhe të afrohet tek Ai me vepra të mira të shumta. Tibiu, siç citohet nga Munaviu, kishte konstatuar se vdekja e një njeriu që ka arritur pleqërinë duke e njohur Zotin e vet është më e mirë se vdekja e një fëmijë që shkon tek Allahu pa llogari.⁴¹ Kadi Ijadi, këtë fakt, jetën e gjatë me vepra të mira, e shihte si tregues apo sihariq të shpëtimit në të dyja botët.⁴²

³⁸ Shih hadithin 229 në *Sahihu Edebi el mufred*

³⁹ Hadithin e shënojnë Taberaniu dhe të tjerë. Albani e ka saktësuar në *Sahih el Xhami*, nr. 3928.

⁴⁰ Shih: Ali bin Muhamed Mulla el Herevij el Karij, *Mirkatu el mefatih sherhu Mishkati el mesabih*, vep. cit., 8/3306.

⁴¹ Munavi, Fejdu el Kadir sherhu el Xhami’i es sagir, vep. cit., 4/281.

⁴² Po aty.

Hadithi 7: *Tûba* për ata që i shmangen sprovave

Theubani r.a., përcjell se Profeti a.s. ka thënë:

طُوبَى لِمَنْ مَلَكَ لِسَانَهُ، وَوَسِعَهُ بَيْتُهُ، وَبَكَى عَلَى حَطِيئَتِهِ

“Tûba për atë që zotëron gjuhën e vet, i mjafton shtëpia e vet dhe qanë për mëkatin e vet!”⁴³

Në këtë hadith, Profeti a.s. na ofron një këshillë përmbledhëse, rëndësia e së cilës vihet në pah veçmas në kohë të turbullta e sprovash, kur rendi dhe ligji përmbysen. Në rrethana të këtilla, besimtarët më të mirë janë ata që ruhen më së shumti. Profeti a.s. është lutur me tûba për besimtarin që *zotëron gjuhën* e nuk flet tjetër vetëm se mirë, që i mjafton shtëpia e vet, respektivisht që izolohet nga njerëzit dhe që qanë për mëkatin, gjegjësisht reflekton në këtë kohë vetmie duke kujtuar mëkatet që ka bërë dhe qanë për shkak të pakujdesisë dhe shpërfilljes që ka treguar.⁴⁴ Në këtë hadith nuk këshillohemi vetëm të largohemi nga ato vepra që parimisht janë të këqija, p.sh., nga të folurit për gjëra të ndaluara, por edhe për gjëra që mund të mos jenë të ndaluara, por që nuk kanë ndonjë dobi a interes.⁴⁵

⁴³ Hadithin e shënojnë Taberaniu dhe të tjerë. Albani e ka klasifikuar si hadith hasen në *Sahih el Xhami*, nr. 3929.

⁴⁴ Shih: Munavi, *Et tejsir bi sherhi el Xhami'i es sagir*, vep. cit., 2/120.

⁴⁵ Muhamed bin Ali el Munavi, *Fejdu el Kadir sherhu el Xhami'i es sagir*, (Egjypt: El mektebetu et tixharije el kubra, 1356 h.), 4/279.

Përfundim

Në fund të këtij punimi mund të konstatojmë se dashuria e Profetit a.s. dhe lidhja e tij me pasuesit janë të veçanta. Ai ka dhënë nga vetja çdo gjë dhe ka sakrifikuar me çdo gjë, madje edhe me gjërat më ekskluzive, vetëm e vetëm për të mirën e ymetit.

Tûba e përmendur në Kuran dhe në këto hadithe si shpërblim i veçantë përfshin lutjen për të më të mirat në këtë dhe botën tjetër, sikur që përfshinë dhe një pemë të veçantë në Xhenet, gjerësia e së cilës është sa njëqind vite kalërim.

Fatlumët e këtyre lutjeve duhet të plotësojnë një sërë kushtesh, respektivisht duhet ta reflektojnë fenë thelbësisht e konkretisht, pra duhet të jenë të singertë, të bëjnë vepra të mira dhe të kenë moral dhe sjellje të mira.

Tûba, me pak fjalë, paraqet thirrjen për ndryshim pozitiv, për ripërtërije të lidhjeve me Allahun e Madhëruar, për reflektim personal, për rol reformues në shoqëri, për luftim të së keqes dhe fuqi për t'u ballafaquar me sfidat që na dalin në këtë rrugë. Tûba është pasqyra në të cilën shikon besimtari për ta ndërtuar portretin e vet shpirtëror e edukativ mbi bazën e vlerave dhe jo baza të tjera. Ato që mund të na bëjnë të dukemi të ngjashëm me sahabët, brezin më të mirë të njerëzimit pas profetëve, janë vlerat dhe virtytet.

Prof. ass. dr. Rexhep SUMA

DISA VEÇORI TË DISKURSIONIT-MESAZHIT DHE LIGJËRIMIT FETAR QË KËRKOHEN NË KOHËN TONË

Ligjërimi në mendimin fetar konsiderohet një detyrë shumë e rëndësishme, të cilën Zoti xh.sh., ua ka ngarkuar njerëzve të dijes. Për këtë, erdhën ajetet dhe transmetimet, të cilat konfirmojnë kryerjen dhe zotërimin e tij, si dhe paralajmërojnë mos neglizhencën e tij, pasi që ai është mjeti kryesor për mesazhi të cilit komunikohen dispozitat fetare. Për të pasur efekt mesazhi i predikimit tonë mbi masën e gjerë, asnjëherë nuk duhet hequr nga mendja orientimi ynë në vend, kohë dhe rrethana që jetojmë. Në këtë drejtim, duhet marrë parasysh edhe gjuha e palës së cilës ia komunikojmë vlerat e Islamit, me qëllimin e vetëm, që ligjërimi ynë të jetë i qartë, i saktë dhe ndikues. Përzgjedhja e subjektit që do ta trajtojë para auditoriumit ka peshën adekuate, pasi që bota tanimë veçse është bërë një fshat elektronik. Një pjesë e diskursit tonë tashmë ka hyrë në arenën e globalizimit, por kjo hyrje, nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe teknikave, nuk shkon përtej paraqitjeve formale. Kjo mund të shkaktojë dyshime rreth aftësisë së ligjërit, duke qëndruar i palëkundur përballë sfidës së qytetërimeve dhe kulturave të tjera dhe përshtatshmërisë së tij për të udhëhequr jetën e njeriut bashkëkohor.

Në kuadër të ligjërimin fetar, ka disa individë, që objektiv kryesor në misionin e tyre, kanë plasimin e ideve të bazuara vetëm në divergjencat e dijetarëve. Kjo gjë, shkakton një konfuzitet të xhemati dhe opinionin e gjerë. Sot, diskursi i ligjërimin, është i nevojshëm që të përmirësojë imazhin e dëmtuar të myslimanëve, por edhe vlerave fetare nga të tjerët, si dhe nga vetë pjesëtarët e tij. Islami sot ka ofruar siguri të mjaftueshme, si dhe ka bërë që edukata islame të jetë efektive në të gjitha sferat dhe të japë fryte në të gjitha kohërat. Në mesi e sigurive që ofron Islami, sipas dijetarit të njohur të botës islame, shejh Muhamed el Gazalit, është edhe ajo se ai kontrollon ambientin, për faktin se, në shumicën e rasteve, ambienti i keq vret besimin dhe nderin. Zhvillimi i gjeneratave të reja dhe të formuara si duhet kërkon nga ne që të kemi një mbikëqyrje koncize mbi shtëpinë, rrugën, shkollën etj.. Në këtë rast, shtëpia e besimtarit nuk është vetëm për takime dhe për të kënaqur apetitet e kësaj bote, por ajo është mburojë e sigurt për të formuar fëmijë të shëndoshë e të ndershëm, të cilët do të tregojnë respekt dhe ndjeshmëri ndaj Zotit xh.sh., dhe të drejtave njerëzore.¹ Krijuesi ynë na ka mësuar që të kërkojmë ndihmë për të bërë realitet këtë objektiv, duke na porositur në Kuran:

وَالَّذِينَ يَقُولُونَ رَبَّنَا هَبْ لَنَا مِنْ أَزْوَاجِنَا وَذُرِّيَّاتِنَا قُرَّةَ أَعْيُنٍ
وَجْعَلْنَا لِلْمُتَّقِينَ إِمَامًا

“Edhe ata që thonë: “Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, ne na bën shembull për të devotshmit.” (Furkan, 74).

¹ Muhamed Gazali, *Ed-davetu el islamije testakbilu karneha el hamis ashere*, Dar el Kalem, Damask, bot. II, 2005, f. 202-203.

Nevojat e diskursit islam

Cila është zgjidhja për këtë sfidë të tanishme? Problemi kërkon një trajtim themelor në të cilin bëhen përpjekje të mëdha për të krijuar baza njohëse nga të cilat mund të fillojë ligjërimi islam, duke ofruar pesë nevoja:

Së pari: Të kesh një vizion për realitetin e botës së re dhe një lexim objektiv të ndryshimeve që ndodhin sot në shoqëritë njerëzore.

Së dyti: Të menduarit me një mentalitet të hapur, të përqendruar në interesin e racës njerëzore. Njohja e kryqëzimit të interesave midis familjes njerëzore dhe kërkimi i zgjidhjeve dhe trajtimeve për to.

Së treti: Ripërtëritja e konsideratës dhe zellit në mendimin dhe jurisprudencën islame në dritën e zhvillimeve njohëse, me qëllim që të nxirren vendime për zhvillimet e fundit të çështjeve dhe të mos kënaqemi me opinionet e së kaluarës.

Së katërti: Komunikimi me përvojat e kombeve dhe popujve, dhe të qenët i hapur ndaj tyre për të përfituar prej tyre dhe për të bashkëvepruar me ta, që është një thirrje nga e vërteta. Allahu xh.sh. thotë: **“Dhe Ne ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni me njëri-tjetrin.”** (El Huxhurat, 13).

Së pesti: Përpjekja për të kërkuar metodat më të mira të paraqitjes dhe prezantimit të parimeve dhe mësimëve të Islamit. Kjo është edhe një thirrje kuranore. Për këtë, Zoti xh.sh., thotë: **“Fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe këshillë të mirë dhe diskuto me ta në mënyrën më të mirë.”** (En Nahl, 125).

Islami ka ardhur për të pasur rolin rregullues në tokë, pra ka ardhur për të qenë faktor i përhershëm ndër breza. Mirëpo këtë rol nuk mund ta luajë nëse përpjekjet për faktorizimin e tij nuk ngërthejnë në vetvete origjinalitetin dhe garancinë e vazhdimësisë dhe rezistencës ndaj sprovave të kohërave, si dhe aftësinë për t’iu përgjigjur të gjitha nevojave të aktualitetit. Aktualiteti ynë bashkëkohor po dëshmon përditë e më shumë dështimin e vazhdueshëm të të gjitha ideologjive dhe filozofive qasëse ndaj njeriut dhe jetës së tij. Në të njëjtën kohë, aktualiteti ynë po dëshmon për nevojën e madhe që kanë për zgjidhjet që ofron Islami dhe burimet e tij. E më konkretisht, faktorët e ligjërimit islam, duhet të besojnë thellësisht se Islami mbart në vetvete aftësinë e padiskutueshme, jo vetëm për ta përmirësuar gjendjen e popullit, shoqërisë dhe vendit tonë, por është i aftë që t’i dhurojë dhe mundësojë popullit shqiptar, me të gjithë përbërësit e tij, një vend dhe pozitë shumë të lavdishme ndër të gjithë popujt e tjerë.² Detyra e Muhamedit a.s. ishte ta komunikonte dhe përhapte mesazhin e Islamit. Njëherësh ky ishte edhe urdhër nga i Lartmadhërishti:

فَإِنْ أَعْرَضُوا فَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ حَفِيظًا ۗ إِنَّ عَلَيْكَ إِلَّا الْبَلَاغُ

“Nëse ata (idhujtarët) refuzojnë, Ne nuk të kemi dërguar ty rojë të tyre, ti ke për obligim vetëm komunikimin...” (Esh Shura, 48).

Ligjërimit apo veprimtarinë për thirrje, ai e filloi nga më të afërmit, më pas për të përfshirë të gjithë ata që shprehnin

² Sabahudin Jashari, *Hartë e ligjërimit islam bashkëkohor tek shqiptarët*, “Ardhmëria”, botim i parë, Tiranë, 2020, f. 237.

interesim për të dëgjuar. Personaliteti i tij si thirrës në rrugën e Allahut xh.sh. ishte mbi mësimet hyjnore. Kurani na e përshkruan Muhamedin a.s., si **“ftues dhe thirrës i Allahut”** (*El Ahzabë, 46*), duke vënë peshën e mesazhit mbi të me urdhëresat si: *“paralajmëro”, “thirr”, “fto”, “këshillo”, “komuniko”*. Krahas këtyre urdhrave, atij iu dha edhe obligimi i paralajmërimit (*indhar*) dhe dhënies së përgëzimit (*mubeshshir, beshir*) (Nexhm, 56; Sad, 65,70; Fatir, 23). Është me rëndësi të ceket për brezin e ri se, në këtë mision, i Dërguari a.s. nuk ka pranuar asnjë kompensim material për punën e bërë. Edhe pas vdekjes së tij, thirrjen në Islam, myslimanët e kanë pranuar si një detyrë të pashmangshme të tyre.³

Dijetarët myslimanë duhet t’i analizojnë tekstet islame, posaçërisht tekstet e hadithit të pastër pejgamberik, me qëllim që ta dijnë vlerën e asaj që e lexojnë. Dijetarët në fjalë duhet t’i pastrojnë tekstet nga ndërhyrjet (israilijate) e trilluara dhe të jenë sa më larg studimeve akademike, me qëllim që të jenë më të afërta për popullin, sepse në të kundërtën, literatura e tillë nuk do të ketë kurrfarë ndikimi efektiv. Literatura e tillë duhet të ketë metodologji, formë, transmetime tematike të qarta dhe të përmbajë studime historike objektive për periudhën e Shpalljes, për ambientin social e civilizues të kohës së Shpalljes dhe për sukseset që i korri gjenerata e parë islame. Për t’i kuptuar tekstet islame, posaçërisht ato të Sunetit dhe të historisë së gjeneratës së parë islame, duhet që

³ Onkal, Ahmet, *Rasulullah'in Islam'a Davet Metodu* (Letër thirrëse e Resullullahut ndaj Islamit), Konja, 1989; Mustafa Cagric, “Davet”, *DIA*, IX, 16-19; Sheuki Saka, “Kur'ana Gore Inanç Hürriyeti (Liria e besimit sipas Islamit)”, *Diyanet Dergisi*, Ankara, 1992, f. 127-137.

në to të dominojnë qartësia, përgjithësia, preciziteti dhe njohja e historisë së tyre, ngase vetëm në këtë mënyrë do të anulohen të kuptuarit e pjesërishëm dhe injoranca shkencore. Nëse veprohet kështu, atëherë do të kuptohen bazat e premisave islame në të gjitha sferat, dhe varësisht nga nevojat e realitetit, do të përfitohet fryma kreative civilizuese islame, si dhe do të realizohen qëllimet e mesazhit të Islamit.⁴

Në epokën e globalizmit, ligjërimi ynë islam, ka nevojë imediate për ndryshim dhe zhvillim, gjë që nuk nënkupton ndryshimin e perceptimeve konstante dhe objektivave islame, por aludon në ndryshimin e metodave të ligjëritit-thirrjes, mënyrave të shpjegimit dhe teknikave të mësimit. Kjo ngase ne jemi mësuar që t'i flasim vetvetes dhe të tjerët mos ta dëgjojnë zërin tonë. Mirëpo, sot, ajo që thuhet në një vend, arrin në të njëjtin moment në të gjitha anët e botës, ngase bota është shndërruar në një fshat të vogël. Dispozitat legjislativive islame, të cilat u tregohen myslimanëve, nuk janë të njëjta me ato që u tregohen jomyslimanëve, duke filluar me doktrinën e besimit islam, pastaj duke vazhduar edhe me çështjet e tjera. Ajo që i thuhet myslimanit që posa ka kaluar në Islam, nuk është e njëjtë me atë që i thuhet myslimanit që ka lindur në një familje myslimane. Po ashtu, edhe dialogu apo ligjërimi, dallon varësisht prej shkollës së cilës i përket dhe të cilën e përfaqëson thirrësi. Është më e preferuar që retorika e kësaj kohe ta sublimojë spiritualitetin mistik, ortodoksinë tradicio-

⁴ Abdullah Ahmed Ebu Sulejman, Kriza e të menduarit musliman, Logos-A, Shkup, 2012, f. 188.

nale, racionalitetin skolastik dhe natyrën shkencore të juristëve.⁵

Ligjërimi ynë nuk duhet të ketë ngjyra e thirrje në elementet nacionaliste, fanatizëm, apo të përmbajë gjuhë të urrejtjes, ngase kështu predikimi ynë çlirohet nga robërimi ndaj njëri-tjetrit, dhe si rezultat bëjmë nënshtrimin ndaj Krijuesit tonë. Thirrja e myslimanëve duhet të bëhet me urtësi dhe këshilla të mira. Urtësia nënkupton: absorbimin e provave shkencore bindëse dhe argumenteve logjike; t'u flasim njerëzve në atë nivel që e kuptojnë, e jo vetëm në gjuhën e tyre; t'u flasim njerëzve me gjuhën e realitetit të cilin ata e jetojnë, me gjuhën e problemeve, sfidave, nivelit, shpresave dhe vuajtjeve të tyre; të jemi të butë, duke e adoptuar metodologjinë e lehtësimit në fetva dhe përgëzimit në thirrje; të renditen së pari gjërat bazike dhe prioritare, e pastaj të kalohet në gjërat periferike; të fillohet me besimin dhe moralin, e pastaj gradualisht të kalohet në çështjet periferike dhe anësore.⁶

Mesazhi ynë islam duhet të marrë parasysh pozitën dhe vendin e auditorit (atyre që u drejtohet), gjendjen dhe mundësitë e tyre, që të komunikojë me ta në gjuhën që e kuptojnë, të përpiqet që t'i sqarojë, në mënyrë që përcjellja te ta të jetë e qartë siç bënë peygamberët:

⁵ Vendimet dhe Fetvatë e publikuar nga Këshilli Evropianë për Fetva dhe Gjurmime, Iliriprint, Prishtinë, 2021, f.77.

⁶ Po aty, f.77.

وَقَالَ الَّذِينَ أَشْرَكُوا لَوْ شَاءَ اللَّهُ مَا عَبَدْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ نَحْنُ
وَلَا آبَاؤُنَا وَلَا حَرَمْنَا مِنْ دُونِهِ مِنْ شَيْءٍ ۚ كَذَلِكَ فَعَلَ الَّذِينَ مِنْ
قَبْلِهِمْ ۚ فَهَلْ عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ

“Ata që i bënin shok Zotit (idhujtarët) thanë: “Sikur të kishte dashur Allahu, as ne, e as prindërit tanë nuk do të adhuronin asnjë send pos Tij, dhe nuk do të ndalonim (nuk do të konsideronim të ndaluar) asnjë send pos (ndalesave të) Tij. Kështu (këso gënjeshtër) bënin edhe ata që ishin para tyre. Po a mos kanë të dërguarit obligim tjetër, përveç që t’i njoftojnë qartazi?” (En Nahl, 35).

Është mjaft e rëndësishme që të kihet parasysh natyra e përafrimit, ajo që sot e ka bërë botën një lagje të vetme, specifikat e kësaj kohe që është shpejtë etj., aq sa sot flet nga një vend i vogël si Katari dhe të dëgjojnë anekënd botës sikur ta kesh atë pranë teje, duke të dëgjuar. Shih pra, sikur të ishe në kohët e mëparshme duke u falur në xhami, ti nuk do arrije të dëgjoje as zërin e imamit. Ata që kanë marrë përsipër të përcjellin mesazhin e Islamit, duhet të thellohen dhe të studiojnë mirë dhe jo të flasin në erë, se sot është e tërë bota që i dëgjon, i shikon dhe i analizon. Ky mesazh, sot, duhet të përmbledhë në vete një seri veçorish, përmes së cilave duhet të jetë i aftë të arrijë te njerëzit, duke i bindur ata me fakte, duke i afruar me të mirë, me komunikimin në formën më të bukur, e jo larg urtësisë.⁷

⁷ Jusuf Kardavi, *Hitabuna el ismai fi asril avleme*, Darush-shuruk, bot.1, Kajro, 2004, f.54.

Nuk është ligjërim i reformuar nëse e paraqet Islamin krahëthyer apo të çarmatosur (që nuk flet për çështjet ushtarake), (sigurisht se kur kërkohet nevoja dhe vendi ka nevojë për mbrojtje), apo se Islami është thjesht vetëm lidhje mes robit dhe Zotit, e nuk është program i përkryer jete për individin, familjen, shoqërinë dhe shtetin. Nuk është reformim i ligjërimin fetar nëse i lë anësh ajetet që flasin për disa që nuk pajtohen me ne, e as nëse i përjashton ndëshkimet nga e drejta penale, dhe as nëse e eliminon xihadin nga marrëdhëniet ndërkombëtare, apo t'i largosh betejat nga jetëshkrimi profetik.

Mesazhi apo ligjërimi ynë duhet të shfaq interes për aktualen, duke ruajtur pjesën origjinale të vlerave dhe civilizimit islam. As shpirtërorja e as materialja, nuk duhet të jenë në kurriz të njëra-tjetrës. Gjuha e komunikimit të sotëm duhet të adaptojë globalen pa e anashkaluar lokalen. Parimi i lehtësimin në ofrimin e fetvasë është më se i nevojshëm. Ai duhet të përmbajë lehtësimin e përgëzimin, sidomos kur dihet se njeriu i sotëm jeton nën presion të vazhdueshëm dhe shkalla e stresit vetëm sa rritet.

Paraqitja e dinjitetshme para njerëzve

Ligjëruesi - predikuesi i fesë islame, sot, duhet të ketë ndjesinë t'u flasë njerëzve për atë që u bën dobi dhe për atë çka u përgjigjet nevojave të tyre. Nuk është e nevojshme t'u flasë njerëzve për çështje të imta të doktrinës islame, për të cilat feja nuk i ka bërë detyrim që t'ua mësojnë njerëzve me hollësi, dhe as divergjencat e dijetarëve. Këto janë gjëra për të cilat ata shumë rrallë kanë nevojë. Nuk është gjithashtu e nevojshme që njerëzve t'ua përmendë shpesh armiqtë e Isla-

mit dhe intrigat e tyre ndaj fesë. Kjo i bën ata të jetojnë në një gjendje frike apo i shqetëson nga gjërat më themelore dhe më të rëndësishme, siç është mësimi, edukimi dhe forcimi i besimit; i largon ata nga ajo çka u bën dobi dhe i fut në gjëra të padobishme. Gjëra të tilla nuk mund të trajtohen nga pozicioni i ligjëruesit, pasi të tillat kanë një vend tjetër. Po kështu, nuk i takon pozitës së thirrjes islame që njerëzve t'u flitet për gjëra që nuk u interesojnë, si për shembull trajtimi nëpër vendet perëndimore të problemeve që ndodhin në vendet lindore, apo problemet për një mbret të largët, gjendja e të cilit nuk u intereson dëgjuesve as nga afër e as nga larg. Njerëzve është e detyrueshme t'u flitet me një gjuhë që e kuptojnë dhe në një mënyrë që u përshtatet.⁸

Në këtë aspekt, do të paraqesim edhe shembull nga jeta e Muhamedit a.s., se si ai ligjëronte me kujdes para masës. Aisheja r.a. ka thënë: *“Kur fliste i Dërguari i Allahut, çdokush mund t'ia numëronte fjalët, nëse do të donte.”*⁹ Po në këtë aspekt, edhe Enesi r.a. ka thënë: *“Kur i Dërguari i Allahut thoshte diçka, e përsëriste tri herë, që të kuptohej.”*¹⁰

Ky shembull na e lehtëson mënyrën e ligjërimit. Në këtë aspekt, pra në përçimin sa më të qartë të mesazhit të Islamit, predikuesi duhet të mos përdor një gjuhë të lartë apo mënyrë të koklavitur. Nën një prirje të tillë, disa nga mësimet e fesë janë shndërruar si të ishin kode që nuk i zbërthen dot veçse një specialist, dhe se nuk mundet njeriu t'i kuptoj, përveçse

⁸ Adnan Alaaraur, *Menhexh ed-da've fi dev'i el vaki el muasir*, botim i 1,2005, f.17.

⁹ Buhariu, 3567.

¹⁰ Buhariu, 95.

një i ditur. Në këtë pikë kërkohet që ligjëruesi të shfaq urtësi dhe mençuri, në mënyrë që njerëzit të tregojnë interesim për temën dhe vlerat islame në përgjithësi.

Duhet pasur parasysh se imazhi ynë është pjesë përbërëse e prezantimit apo ligjërimit tonë para masës. Një nga shkaqet e largimit të njerëzve është edhe paraqitja e keqe, në pamjen e jashtme, në veshje dhe në figurë, gjë që jep përshtypje te masa e njerëzve, veçanërisht tek ata bashkëkohorët, se ky person është i prapambetur dhe jeton jashtë rrethit të kohës, bile ndoshta e akuzojnë fenë se është ajo shkak për këtë, kur personi është prej besimtarëve.

Ligjëruesi duhet të vë në spikamë rëndësinë dhe brendësinë e ligjëratës, e cila duhet të reflektojë për atë çfarë zgjon interesim në mesin e shoqërisë islame, duke u munduar që të ofrojë zgjidhje dhe shtegdalje nga sëmundjet dhe dukuritë e padobishme që ekzistojnë në të. Shoqëritë islame, sot, kanë nevojë për predikues të mirë dhe të sinqertë, që janë pikëmbështetje e xhematit të tyre ku operojnë. Ata po ashtu shprehin interesim dhe kërkojnë që mos të humbet koha e tyre në gjëra që nuk iu duhen apo vetëm për sa t'u tubuar. Informacionet që prezantohen nga ligjëruesi duhet të jenë boshte të temës dhe që iu hynë në punë myslimanëve.¹¹

Pejgamberi a.s. tregonte kujdes që të ngrinte lart shijet dhe estetikën e shokëve të tij në figurën dhe paraqitjen e tyre, njësoj siç përpiquej edhe për ngritjen lart të anës së tyre të bre-

¹¹ Abdurrahim Muhamed el Magdhevi, *El usus el ilmije limenhexhi ed-da'veti-l-islamiye, dirasetun te'silijetun ala dav'i el vakië-l-muasir*, Darul-hadareti li-n-eshri ve -t-tevzi, botim 3, 2018, f. 868.

ndshme.¹² Një ditë, ai u tha shokëve të tij: *“Nuk do të hyjë në Xhenet ai që ka në zemrën e tij qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie.”* Një burrë i tha: *“O pejgamber i Zotit, mua më pëlqen shumë e bukura në çdo gjë, aq sa nuk dua që të ma kalojë askush qoftë edhe te këpucët. A bën pjesë kjo te mendjemadhësia?”* Ai i tha: *“Allahu është i bukur dhe i pëlqen e bukura. Mendjemadhësi është mohimi i të vërtetës dhe nënçmimi i njerëzve.”*¹³

Suksesi i arritur nga Pejgamberi a.s. në misionin e predikimit të fesë

Një studim krahasues i numrit të njerëzve të konvertuar nga pejgamberët e ndryshëm, do të zbulonte suksesin e jashtëzakonshëm të arritur nga Muhamedi a.s.. Duke gjykuar nga detajet përkatëse mbi këtë temë në Bibël, numri maksimal i të konvertuarve nga Isai (Jezusi) nuk i kalonte dyzet. Thuhet për Musain (Moisiun) se populli i tij, numri i të cilëve, sipas Biblës, ishte gjysmë milioni, i dha atij mbështetje të plotë, por ajo ishte e kufizuar vetëm në sigurimin e lirisë nga tirania e faraonit. Numri i të konvertuarve të vërtetë ishte pothuajse i parëndësishëm. Pas eksodit nga Egjipti, Musai iu kërkoi ndjekësve të tij ta pushtonin Palestinën, një dhuratë kjo e premtuar nga Zoti. Ata refuzuan me justifikimin se nuk mund t’i

¹² Jusuf Kardavi, *Es-s-ahve el islamije minel muraheka ila rrushdi*, Darushshuruk, bot. 3, Kajro, 2008, f. 174.

¹³ Hadith i transmetuar nga Ibën Mesudi, r.a., shih Muslim, “Iman”, 147, 149; Ebu Davud, “Libas”, 29, hadith nr. 4091; Tirmidhi, “Birr”, 61, hadith nr: 1998-1999; Ibën Maxhe, “Ifitah”, 9, hadith nr: 59; “Zuhd”, 16, hadith nr: 4173.

luftonin tiranët. Nëse Zoti do ta kishte dhënë premtimin, thanë ata:

قَالُوا يَا مُوسَىٰ إِنَّا لَن نَّدْخُلَهَا أَبَدًا مَّا دَامُوا فِيهَا ۗ فَادْهَبْ أَنْتَ
وَرَبُّكَ فَقَاتِلَا إِنَّا هَاهُنَا قَاعِدُونَ

“Ata thanë: “O Musa, ne kurrë nuk hyjmë në të derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu!” (El Maide, 24).

Me fjalë të tjera, e gjithë bashkësia nuk iu bind dhe refuzoi me vendosmëri të zbatonte urdhrin hyjnor. Kishte vetëm dy përjashtime, njëri ishte Haruni, vëllai i Musait, dhe tjetri ishte shërbëtori i tij, i cili më vonë u bë pejgamber, d.m.th. Joshea (Jusha). Përveç atyre të dyve, asnjë njeri nuk e ndoqi Musain. Isai a.s. (Jezusi) kishte dymbëdhjetë dishepuj besnikë. Njëri prej tyre ishte Shën Pjetri. Varri i tij ndodhet në Vatikan në Itali. Për të, Jezusi në Bibël thotë: “Shko! O Satan!” Kjo aktakuzë duhet të jetë për shkak të ndonjë veprimi të tij. Një dishepull tjetër ishte Jehuda, i cili u kthye në apostat. Ai e tradhtoi Jezusin tek autoritetet që po e kërkonin.

Krahasuar me këtë, numri i njerëzve që e përqaftuan Islam nga Pejgamberi a.s. është mizëri. Nuk kemi shifra të sakta, por një vlerësim i përafërt është i mundur. Në kohën e Haxhit të Lamtumirës, historianët llogarisin një turmë prej 140.000 vetash në fushën e Arafatit. Haxhi nuk është një obligim të cilin secili duhet ta kryejë çdo vit. Është e qartë se të gjithë myslimanët nuk ishin mbledhur atje. Duke supozuar se një, në çdo pesë, e kryente haxhin, totali do të shkonte në mbi gjysmë milioni. Shifra krahasohet mjaft mirë me totalin e dyzet të konvertuarve në krishterim gjatë jetës së Jezusit. Për më tepër, dukuria e apostazisë në historinë e Islamit ka

qenë shumë e rrallë. Ne hasim vetëm një ose dy raste të kësaj natyre gjatë jetës së Pejgamberit a.s..¹⁴ Por, thënë në mënyrë rigoroze, njerëzit në fjalë ishin hipokritë dhe jomyslimanë. Ata kishin vënë maskën e Islamit me qëllimin që ta përmbysin atë nga brenda. Vetëm kur ata nuk arritën qëllimin e tyre, ata deklaruan hapur mosbesimin e tyre.

Dijetari i kohës, dr. Jusuf Kardavit, Zoti qoftë i kënaqur me të, përpiloi 15 pika apo veçori të këtij mesazhi, të cilat janë: 1. Beson Allahun, por nuk e mohon njeriun (nuk e hedh poshtë); 2. Beson shpalljen, por nuk hedh poshtë logjikën; 3. Thërret për shpirtëroren, por nuk lë pas dore materialen; 4. I jep përparësi adhurimeve të ligjëruara, por nuk harron as vlerat morale; 5. Fton te krenaria nga besimi dhe përhapja e tolerancës dhe dashurisë; 6. Nxit me anë të shembujve (ndodhive), por nuk harron realitetin; 7. Fton për punë e seriozitet, por nuk harron kohën e lirë dhe argëtimin; 8. Ngulmon te gjithëpërfshirja botërore, por nuk harron veçoritë vendore; 9. Kujdeset për aktualen, por nuk harron të mbahet pas origjinale; 10. Sheh drejt së ardhmes, por nuk mohon të kaluarën; 11. Miraton lehtësimin në vendime dhe përgëzimin në thirrje; 12. Bën thirrje për kërkime (ixhtihad) duke mos i tejkaluar bazat konstante; 13. Hedh poshtë terrorizmin e ndaluar, por mbështet luftën e lejuar e të ligjësuar; 14. Ia njuh të drejtën gruas, por nuk i bën padrejtësi burrit; 15. Mbron të drejtat e pakicave, por nuk lë pas dore shumicën.¹⁵

¹⁴ Muhamed Hamidullah, *Ligjërata mbi zhvillimin e botëkuptimit, traditës intelektuale dhe qeverisjes civile islame*, përktheu Urim Poshka, Logos-A, Shkup, 2023, f. 339.

¹⁵ Jusuf Kardavi, *Ibid*, f. 55.

Gjuha e urrejtjes

Një fakt tepër me rëndësi gjatë ligjërimit është edhe mos përdorimi i gjuhës së urrejtjes në komunikimin publik, ndonëse ende nuk ekziston ndonjë përkufizim i pranuar universalisht i gjuhës së urrejtjes, pavarësisht përdorimit të shpeshtë të kësaj shprehjeje. Sikurse argumenton Gianmarco Gometz, sot, të gjithë e dënojnë përdorimin e gjuhës së urrejtjes, por askush nuk e di saktësisht se çfarë është gjuha e urrejtjes, duke pasur parasysh shkallën e pazakontë të paqartësisë që e karakterizon secilin nga përkufizimet që ekzistojnë.¹⁶ Shumë shtete në Evropë dhe përtej, kanë miratuar legjislacion që ndalon shprehjet që përbëjnë gjuhë të urrejtjes. Përkufizimet mund të dallojnë kur është fjala për përcaktimin se çfarë ndalohej, deri në ç'masë gjuha mund të jetë “fyese” dhe të përçojë “urrejtje”, dhe duke folur në përgjithësi, cila është në të vërtetë përmbajtja e gjuhës së urrejtjes.¹⁷ Gjuha e urrejtjes përfshin përdorimin e një apo shumë formave të caktuara të të shprehurit, përkatësisht avokimin, promovimin, ose nxitjen e denigrimit, urrejtjes, apo poshtërimit të një personi apo grupi të personave, si dhe ngacmimet, fyerjet, stereotipizimet negative, stigmatizimin apo kërcënimin e këtij personi apo personave dhe çdo arsyetim të të gjitha këtyre formave të të shprehurit që bazohen në listën jo përfundimtare të karakteristikave personale apo statusit që përfshin “racën”, ngjyrën, gjuhën, fenë ose besimin, kombësinë ose origjinën kombëta-

¹⁶ Gianmarco Gometz, *L'odio proibito: la repressione giuridica dello hate speech*, “Stato, Chiese e pluralismo confessionale”, n. 32, 2017, f. 1-38.

¹⁷ Nadine Strossen, Lira e shprehjes dhe barazia: A duhet të zgjedhim?, “Gazeta e ligjit dhe politikave”, 25 (1), 2016, f. 185-225.

re ose etnike, si dhe prejardhjen, moshën, aftësinë e kufizuar, gjininë. Përdorimi i formave të tilla si forma të shprehjes nuk ka për synim të nxisë kryerjen e akteve të dhunës, armiqësisë apo diskriminimit, por gjithashtu konsiderohet se e kanë atë efekt. Në këtë kontekst, shprehja kuptohet se mbulon të folurit dhe publikimin në çfarëdo forme, si dhe përhapjen dhe ruajtjen. Ajo mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të folura, apo çdo formë tjetër si fotografia, shenja, simboli, piktura, muzika, drama apo video. Gjithashtu, format e të shprehurit mund të përfshijnë edhe mohimin publik, uljen e rëndësisë, arsyetimin apo shfajësimin e krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës që gjykatat kanë konstatuar se kanë ndodhur, si edhe glorifikimin e personave që i kanë kryer këto krime.¹⁸

Një vështrim i përgjithshëm kritik dhe tërësor, ani pse jo i azhurnuar, i përkufizimeve të ndryshme të gjuhës së urrejtjes mund të gjendet në Sellars (2016), i cili, duke tentuar të sistematizojë shumësinë e qasjeve dhe këndvështrimeve ekzistuese, nxjerr disa koncepte nga ligjërimi akademik dhe ligjor për të përkufizuar gjuhën e urrejtjes.¹⁹ Tiparet kryesore që Sellars i identifikon, i referohen shënjestrimit të një grupi apo një individi si pjesëtar i grupit, në bazë të tipareve fizike,

¹⁸ Përtej përkufizimeve thirrje kundër gjuhës së urrejtjes - Një studim gjithëpërfshirës, Tiranë, nëntor 2021, f.105. mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli Evropian, <https://rm.coe.int/beyond-definitions-alb/1680a465f8>.

¹⁹ Andrev Sellars, Përkufizimi i gjuhës së urrejtjes, “Qendra Berkman Klein për Internetin dhe Publikimet Shoqërore”, Nr. 2016-20, Editoriali nr. 16-48, Shkolla e Drejtësisë në Universitetin Bostonit, Harvard 2016, f. 4 [tinyurl.com/y9mtp58r].

shoqërore, kulturore; pranisë së përmbajtjes që shpreh urrejtje, që shkakton lëndime, nxit veprime kriminale përtej vetë gjuhës dhe nuk ka qëllim shpagues, qëllimit për të lënduar ose ofenduar; natyrës publike të gjuhës etj.. Sikurse dihet, e drejta për lirinë e shprehjes njihet si e drejtë e njeriut sipas Nenit 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ) dhe njihet në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP). Mirëpo, nëse DUDNJ deklaronte se “të gjithë kanë të drejtën të kenë mendime pa ndërhyrje” dhe “të gjithë kanë të drejtën për lirinë e shprehjes”, kjo e drejtë përfshin lirinë të kërkojnë, pranojnë dhe përcjellin informacion dhe ide të të gjitha llojeve, pavarësisht kufijve, qoftë me gojë, me shkrim apo në mënyrë të shtypur, në formën e artit apo përmes mjeteve që i zgjedhin vetë. KNDCP-ja pretendon se ushtrimi i këtyre të drejtave bart “detyra dhe përgjegjësi të posaçme” dhe kështu mund “t’i nënshtrohet disa kufizimeve” kur është e nevojshme për respektimin e të drejtave apo reputacionit të të tjerëve ose për mbrojtjen e sigurisë kombëtare apo të rendit publik, ose të shëndetit apo moralit publik.²⁰

Po ashtu, Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, rendit në paragrafin 2 të tij, kufizimet e ushtrimit të kësaj të drejte të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të

²⁰ <https://tinyurl.com/7w7nu8s>; <https://tinyurl.com/tja32hsj>.

tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.²¹

Pra, liria e të folurit dhe e të shprehurit, mund të mos njihet si absolute dhe mund të mos mbulojë shpifjen, fjalorin e turpshëm, kryengritjen, nxitjen, fjalët grindëse, dinjitetin, pra shprehjet fyese ndaj individëve dhe shoqërisë. Kjo është arsyeja përse shumë këmbëngulin se është e nevojshme që “të këqijat e gjuhës së urrejtjes të merren seriozisht” dhe se “disa lloje të shprehjeve janë përtej tolerancës” kur janë të dëmshme për të tjerët.²²

Sa i përket prodhimit të përmbajtjes, shkëputja që krijohet kur ke mundësi të shkruash pa ndonjë detyrim për t’u shfaqur direkt, nënkupton se komunikimi virtual u mundëson njerëzve të ndjejnë liri më të madhe se si të shprehen. Mirëpo për fat të keq, kjo ka edhe një anë të errët, dhe media sociale është shndërruar në terren pjellor për diskutime të ashpra që shpesh rezultojnë në përdorimin e gjuhës fyese, poshtëruese dhe kërcënuese, ose me komente që gjenerojnë një ndjesi të rrezikut, kërcënimit dhe pasigurisë, duke shkaktuar kështu dëm të shënjestrat direkte, duke i sulmuar, poshtëruar dhe dehumanizuar ata. Lehtësia relative e ruajtjes së anonimitetit në një mjedis online, sigurisht që i ka kontribuar përkeqësimit të dëmit emocional ose psikologjik që u bëhet viktimave të gju-

²¹ European Convention on Human Rights
www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf

²² Raphael Cohen-Almagor, Gjuha e urrejtjes dhe raciste në Shtetet e Bashkuara: Kritikë, “Filozofia dhe Çështjet Publike”, 6 (1), 2016, f. 77- 123.

hës së urrejtjes dhe i ka shtyrë drejt diskutimit të vazhdueshëm për dhe kundër anonimitetit online.²³

Kur identitetet e vërteta të atyre që janë përgjegjës për bullizmin kibernetik apo mesazhet e urrejtjes që shpërndahen nëpër rrjete sociale janë të mbështjella nga veli i anonimitetit apo i pseudonimeve, vetë dyshimi se ata persona mund të jetojnë pranë viktimës apo të frekuentojnë të njëjtat rrethe shoqërore, arsimore apo profesionale, ka gjasa të shkaktojë shqetësim. Nga ana tjetër, shpeshherë krijohen mesazhe të urrejtjes edhe kur viktimat është krejtësisht e panjohur dhe shënjestra e vërtetë bëhet grupi të cilit ai/ajo i përket. Në këtë rast, qarkullimi i urrejtjes mund të jetë mënyra më e lehtë që autori i mesazhit, i cili në këtë rast nuk ka ndonjë interesim për t'u fshehur, të tërheqë vëmendje, pëlqime dhe shikueshmëri. Cilado qoftë arsyeja, kur mesazhet e urrejtjes qarkullohen përmes shërbimeve të rrjeteve sociale, amplifikimi që marrin ato mesazhe, bashkë me perceptimin se shpërndarja e tyre është e pakontrolluar, mund të rrisin nivelin e shqetësimit të viktimave. Mundësia që përmbajtja në dispozicion *online* të jetë e përhershme është gjithashtu një konsideratë e rëndësishme kur përcaktohet natyra dhe shkalla e dëmit të shkaktuar nga gjuha e urrejtjes. Shfaqja e gjuhës së urrejtjes *online* zakonisht është më e pakontrolluar sesa në ekuivalentet tradicionale, jo në internet. Qëndrueshmëria e përmbajtjes *online* mundësohet edhe nga linqet dhe aftësia për të kërkuar në internet. Pas shpërndarjes së saj origjinale, përmbajtja mbetet e gjurmueshme dhe kryesisht e rikuperueshme në një

²³ Joanne Frears, Online anonymity: the debate so far <https://tinyurl.com/enpd7nhx>, february, 2000.

masë të paparë kur del *online*, madje edhe kur përmbajtja fillestare është memorizuar ose larguar.²⁴

Mesazhi fetar ndërtohet mbi lehtësimin në vendime dhe përgëzimin në thirrje

Gjatë jetës së vet, Muhamedi a.s., asnjëherë nuk i ka pëlqyer e as përkrahur mendimet, qëndrimet dhe ligjërimet ekstreme. Ai qëndronte shumë larg ekstremeve dhe nuk u ndikua asnjëherë nga ndjenjat dhe sjelljet e tepruara. Ai gjithashtu i paralajmëronte sahabët për këtë çështje. Nuk i pëlqenin aspak sjelljet që mund të krijojnë fjalë për Islamin, që mund të bezdisin dhe lodhnin njerëzit, që mund t'i çonin njerëzit në urrejtje ndaj Islamit, po ashtu, nuk i pëlqenin veprimet që cenonin parimet themelore të Islamit. Kur i transmetoheshin ngjarje të tilla, mërzitej dhe zemërohej. Në raste të tilla mbante qëndrim të hapur dhe paralajmëronte ata që paraqisnin sjellje të tilla.²⁵

Në vazhdim do të sjellim një shembull të tij mbi këto çështje. Ndërkohë që njëri prej sahabëve po i printe faljes së namazit, e zgjati shumë namazin duke kënduar sure të gjata. Njëri prej xhematit ia transmetoi këtë situatë Pejgamberit a.s.. Pas kësaj, Pejgamberi a.s. u ngrit në këmbë dhe mbajti këtë fjalim të qartë për njerëzit që ishin aty: *“O ju njerëz! Ndër ju ka nga ata që bëjnë që populli të urrejë e të ftohet.*

²⁴ Alexander Brovn, *Pse gjuha e urrejtjes online është kaq e veçantë (krahasuar me atë offline)?*, “Etnicitetet”, 18 (3), 2018, f. 297-326.

²⁵ Ibrahim Saricam, *Hz. Muhamedi dhe mesazhi i tij universal*, përktheu Florida Kulla, Diyanet, Ankara, bot.1,2018,f.356-357.

Kur ndonjëri prej jush kalon në postin e imamit dhe i prin namazit të falur nga populli, namazin ta falë shkurt dhe në formë të përshtatshme. Sepse ndër ata ka të sëmurë, të moshuar dhe njerëz që kanë punë.” Sahabiu që e transmetoi këtë ngjarje tha se nuk e kishte parë ndonjëherë Pejgamberin a.s. aq të zemëruar sa gjatë fjalimit të asaj dite.²⁶

Kur delegacioni i Thekifit erdhi në Medine dhe u bënë myslimanë, ndër ata, anëtarin më të ri të delegacionit, Osman b. Ebi'l Asin, e emëroi prefekt dhe imam te fisi i tij. E këshilloi atë duke i thënë: *“Kur të jesh imam, lehtësoja namazin popullit, fale namazin duke mos e shkurtuar shumë. Ki parasysht situatën e atyre që janë më të dobët, të moshuarit ndër ta, të vegjlit, të dobëtit dhe ata që kanë punë.”²⁷*

Rezime

Uniteti duhet të jetë parimi themelor i secilit ligjërues. Ky faktor, së pari, tërheq kënaqësinë e Allahut xh.sh., kurse së dyti, ofron sukses dhe fitore në mesin e masës. Po ashtu ligjëruesi duhet ta kuptojë fikhun e realitetit, njohjen e jashtëzakonshme të mjedisit dhe çështjeve e faktorëve të tjerë, që janë prezentë në mjedisin e tij predikues. Kjo duhet të ndërtojë njohjen mes distancës së saktë, mes shpresave të dëshiruara dhe mundësive praktike dhe reale. Sipas praktikës së të Dërguarit a.s., karakteristika e ligjërimit dhe mesazhit fetar që iu përcillet masës, duhet të jetë model i lehtësimit në vendime e i përgëzimit në thirrje, duke u mbështetur në mak-

²⁶ Buhariu, 1, 31.

²⁷ Ibën Hisham, 11, 541.

simën “*Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos qortoni*”,²⁸ Sidomos duke marrë parasysh gjendjen, vështirësitë e tyre, pengesat që hasin, si dhe problemet sociale me të cilat ballafaqohen kur shoqëritë janë përzier e ngatërruar e ku izolimi është krejt i pamundur, sidomos në vendet perëndimore ku myslimanët përbëjnë pakicë.

Po ashtu, është tepër me rëndësi që secili ligjërues duhet të mësojë e të di qartë se “kush janë” dhe “çka duan” dhe në bazë të kësaj të përpilojnë plane dhe projekte ligjërimi. Nëse kuptohen këto elemente, atëherë dobia është tepër e madhe, por nëse ndodh e kundërta, atëherë fatkeqësia do të jetë e pashmangshme.

Do ta përfundojë me thënien e Sufjan Theuriut, i cili ka thënë: “Fikhu në të vërtetë është lehtësim nga i besueshmi, ndërsa për shtrëngime çdokush është i aftë.”

²⁸ Buhariu, 3/72.

Dr. Azmir JUSUFI

HUSEIN EF. GJOZO NË SHTYPIN E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË¹

Hyrje

Rrethanat e caktuara janë faktorë vendimtarë në formimin e personaliteteve të shquara, roli dhe rëndësia e të cilëve është e pamohueshme, kurse puna e tyre universale. Kjo sepse ata plotësojnë boshllëqet dhe nevojat duke ndjerë një detyrim të thellë moral në shpirtin e tyre, pavarësisht se në cilën periudhë kohore apo fazë historike jetojnë dhe veprojnë.

Këto elemente mund të gjenden në librat e historisë së të gjithë popujve, faqet e të cilave janë përplot me figura të rëndësishme që shënojnë një epokë të caktuar, qoftë si patriotë, heronj, kolosë dhe reformatorë. Fryma reformiste dhe ndryshimi i ndërgjegjes fillon me revolucionin e mendimit të një individi apo grupi që përpiqet të ngrejë vetëdijen e shoqërisë së tij. I njëjti mendim i tillë duhet të frymëzohet, sepse frymëzimi është shtytësi shpirtëror i njeriut, ndërsa shpirti reformues ushqehet me bindje ideologjike, artistike dhe fetare. Nuk është e pazakontë që një reformator të jetë teolog dhe

¹ Punimi i përgatitur për Tryezën shkencore “Me rastin e 110-vjetorit të lindjes së Husein ef. Gjozës”, të mbajtur në Bibliotekën e Gazi Husrev Beut në Sarajevë, më 17 dhjetor 2022.

mendimtar fetar. Ashtu siç rilind natyra në pranverën e hershme dhe sjell gjallëri dhe jetë, ashtu edhe Husein ef. Gjozo lulëzoi me idetë e tij kur populli i tij kishte më së shumti nevojë për një njeri të tillë.

Që në fillim të punimit përmendet shkurt biografia e Husein ef. Gjozos. Në vazhdim janë përmendur veprat e tij që janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe të botuara në shtypin islam në Kosovë; pas kësaj vjen ndikimi i fetvave të Husein ef. Gjozos te shoqëria kosovare; dhe në fund do të flitet për personalitetin dhe reformat e tij me reflektim në shoqërinë kosovare.

Biografia e Husein ef. Gjozos



Husein ef. Gjozo lindi në vitin 1912 në qytetin Bare² te Gorazhda - Bosnje dhe Hercegovinë. Pas shkollës fillore dhe të mesme, ai u regjistrua në Shkollën Gjykatëse të Sheriatit në Sarajevë dhe më pas në Al Azhar në Kajro. Pas kthimit në Bosnje, punoi si mësues i gjuhës arabe, dhe më pas si nëpunës i lartë në zyrën e Rijasetit. Megjithatë, nga viti 1945-1950, Husein ef. Gjozo, u dënuua me burg si element antikomunist. Vetëm pas vitit 1960, Gjozo do të kthehet në Bashkësinë Islame, ku do të punojë deri në vdekje. Ai ishte autor i shumë teksteve dhe librave. Me hapjen e Fakultetit Teologjik Islam në Sarajevë, u punë-

² Shih: Abdullah ‘Akil Sulejman el Akil, “Shejh Husein Xhozo (1912-1982) reformatori dhe filozof nga Bosnja“, përkthyer në shqip nga Shefki S. Voca, <http://islamgjakova.net/artikulli.php?id=12683>.

sua si profesor i tefsirit. Ai i përkiste shkollës së Afganit, Abduhusë, Meragit, Sheltutit. Njohës shumë i mirë i klasikes dhe modernes, racionales dhe tradicionales, me një shpirt të pandalshëm përballë sfidave politike dhe ideologjike. Me idetë e tij, ishte figura më me ndikim në qarqet islame në Ballkan gjatë shekullit XX. Vendet shqiptare e lexonin më shumë se çdo autor tjetër përmes revistave “Preporod” dhe “Glasnik” nga Sarajeva. Vdiq në vitin 1982 dhe u varros në Sarajevë, para një numri mbresëlënës njerëzish nga e gjithë Jugosllavia. Shumica e veprave të tij u botuan në gjuhën boshnjake në pesë vëllime të mëdha.³

Punimet e Husein ef. Gjozos të përkthyer në gjuhën shqipe në Kosovë

Husein ef. Gjozo lindi në një kohë kur sfidat e jashtme për botën myslimane ishin të shumta dhe problemet e brendshme ishin komplekse dhe dërmuese. Gjozo pati guximin të riinterpretonte mësimet e Kuranit dhe të hadithit (traditës) për një brez për të cilin të vërtetat dhe realitetet e Islamit janë të papërdorshme.

Si një dijetar mysliman që jetoi dhe punoi në një shoqëri evropiane, komuniste, multikulturore dhe multifetare, Husein ef. Gjozo dhe vepra e tij, na paraqesin një histori veçanërisht prekëse përmes së cilës ne mund të shqyrtojmë interpretimet novatore të Islamit. Për shembull, përmes një analize kritike të fetvave më domethënëse të Gjozës dhe materialeve të tjera relevante, shqyrtohet shkalla e fleksibilitetit të qenësishëm të

³ Shih: Nexhat Ibrahim, *Fjalor enciklopedik Islam*, “Husein Gjozo”, Logos-A, Shkup, 2017, f. 342.

ligjit islam dhe aftësia e tij për t'iu përgjigjur interesave myslimane në kushte të ndryshme socio-politike.

Husein ef. Gjozo ishte bartës i lëvizjes së frymës islame në kohën e tij. Mendimi i tij për ripërtëritjen islame dhe aktualizimin e gjithanshëm të jetës në Islam padyshim që gjeti përgjigjen më të frytshme në mendimin dhe përkushtimin e shumë njerëzve si diçka vetë-shpjeguese dhe e qartë.⁴

Disa e konsideruan atë një oportunist dhe gradualist, duke mbrojtur që myslimanët boshnjakë të përshtaten dhe të reformohen me rendin e ri shoqëror dhe ideologjik. Sipas disave, ai ishte një nacionalist mysliman boshnjak, i cili mbështeti dhe punoi për çdo gjë që forconte komunitetin mysliman boshnjak. Megjithatë, Husein ef. Gjozo, ishte një intelektual, fetar, patriot, altruist, tolerant në maksimum, edhe pse nga maja e piramidës shtetërore iu imponua e kundërta.

Edhe si student në Shkollën Gjykatëse të Sheriatit në Sarajevë, ai filloi të shfaqte një qëndrim të pavarur dhe rebel ndaj realitetit ekzistues të botës myslimane dhe largimit të saj drastik nga ideali islam i jetës. “I goditur” dhe “i këshilluar” ekzistencialisht nga kërkesat e Kuranit dhe hadithit të Muhamedit a.s., ai që atëherë i ndjeu shkaqet e dekadencës dhe fatin historik të ndeshjes së botës myslimane në shurdhimin e myslimanëve ndaj shumë urdhrave të qarta të Islamit. Pasi shkoi në Egjipt për të studiuar të drejtën e Sheriatit, në lëvizjen e ripërtëritjes islame, ai jo vetëm që gjeti konfirmimin e rebelimit të tij, por edhe drejtimin dhe kornizën e angazhimit të tij jetësor.⁵

⁴ Hilmo Neimarlija, “Otvoreno djelo Huseina Doze”, *Glasnik* (PLI në RSFJ), Sarajevë, 1982, f. 243.

⁵ Po aty, f. 246.

Edhe pse një punë e vështirë dhe e rrezikshme, ai shkruante tekste në gjuhën arabe dhe i botoi në revista në vendet arabe. Këto punime (6 sa u gjetën) së fundi u botuan të tëra në librin “Ese në gjuhën arabe”,⁶ të përgatitur nga akademiku Enes Kariq. Kjo vepër do të botohet edhe në gjuhën shqipe.⁷ Temat kryesore që ai shqyrtoi ishin: *kritika e pasimit të autoritetit dhe medhhebeve; avokimi për reformën e interpretimit të Sheriatit dhe; ripërtëritja e të menduarit islam në frymën e epokës moderne*.⁸

Siç thotë profesori Miftar Ajdini⁹, veprat e Gjozos u pritën me padurim dhe lexoheshin me kënaqësi edhe nga lexuesit kosovarë. Krahas temave për interpretimin e Kuranit dhe tema të tjera islame, rubrika e tij me pyetje dhe përgjigje

⁶ Esetë janë si më poshtë: “*Thashethemet, ushqim i papërshtatshëm për këtë brez mysliman*”; “*Po, ka dy lloje [njerëzish], për fat të keq (arsyeja dhe feja nuk janë në konflikt)*”; “*Pengesat në rrugën e davetit islam*”; “*Konfrontim në vend të dialogut*”, “*Me shkencë e jo me sy të datohen muajt arabë*” dhe “*Jurisprudenca e medhhebeve nuk korrespondon me kohën tonë*”.

⁷ Vepra do të përkthehet nga gjuha arabe nga prof. dr. Ziber Lata, profesor i shkencave islame dhe gjuhës arabe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup dhe profesor honorar i gjuhës arabe në Fakultetin e Orientalistikës në Tetovë, dhe do të botohet nga shtëpia botuese LOGOS-A në Shkup.

⁸ Husein Đozo, *Eseji na arapskom*, redaktuar nga: Enes Karić, FIN, Sarajevë, 2022, f. 10.

⁹ Në bashkëbisedim me prof. Miftar Ajdini (ish-kryeimam i KBI Prizren, më pas koordinator dhe profesor i gjuhës arabe në Medresenë “Alauddin” në Prizren), me datë: 14.10.2022, me rastin e shkrimit të këtij punimi, M. Ajdini shprehet si më poshtë: “Të dhënat e para për dijetarin e madh Husein ef. Gjozo i kam marrë që në kohën e studimeve (në Libi). Madje kam lexuar në shtypin arab për personalitetin e tij si “mendimtar” dhe “revolucionar” islam nga Ballkani. Më pas kur u punësova në Këshillin e Bashkësisë Islame në Prizren (në vitin 1983) si kryeimam, mësova më shumë për të dhe “u miqësova” me personalitetin, veprimtarinë dhe tekstet e tij”.

(fetva) në “*Glasnik*” ishte shumë e njohur dhe e lexuar në Kosovë. Imamët në Kosovë i përkthenin punimet e tij dhe i përdornin për ligjëratat dhe predikimet e tyre në xhamitë e tyre. Ai ishte protagonist i kryesor i shtypit islam në gjuhën boshnjake si autor i shumë punimeve dhe veprave.

“*Islami në kohë*”¹⁰ dhe disa artikuj e fetva në revistat “Edukata Islame”, “Dituria Islame” dhe “Takvim” në Kosovë janë përkthyer edhe në gjuhën shqipe, gjë që është e pamjaftueshme për një kolos të mendimit islam siç ishte Husein ef. Gjozo.

Përkthimet e mëposhtme të teksteve të Husein ef. Gjozos të botuar në revistën “Edukata Islame” në Kosovë:

1. Husejn Xhozo, “Islami - Besimi në një Zot”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 6/1972, f. 11-21. (*Glasnik*, XXXIV/1971, Nr. 5-6, f. 225-231).
2. Husejn Xhozo, “Islami - Muhamedi a.s. pejgamber i Zotit xh.sh.”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 7/1973, str. 12-24. (*Glasnik*, XXXIV/1971, Nr. 7-8 f. 337-343).
3. Husejn Xhozo, “Islami - namazi”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 8/1973, f. 11-21. (*Glasnik*, XXXIV/1971, Nr. 9-10, f. 446-451).
4. Husejn Xhozo, “Islami - zekati”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 9-10/1974, f. 37-52. (*Glasnik*, XXXIV/1971, Nr. 11-12, f. 557-564).
5. Husejn Xhozo, “Islami - agjërimi”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 14/1975, f. 16-28. (*Glasnik*, XXXV/1972, Nr. 1-2, f. 1-8).

¹⁰ Bëhet fjalë për veprën: Husein Gjozo, *Islami në kohë*, përkthyer nga Hamdi Iljazi, Shoqata e Ilmijes së Maqedonisë, Shkup, 1993.

6. Husejn Xhozo, “Islami - haxhi”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 15-16/1976., f. 12-27. (*Glasnik*, XXXV/1972, Nr. 3-4, f. 113-121).
7. Husejn Xhozo, “Islami - njeriu”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 17/1976, f. 35-48. (*Glasnik*, XXXV/1972, Nr. 5-6, f. 213-221).
8. Husejn Xhozo, “Islami - Kurani”, përktheu: Jetish Bajrami, Nr. 18/1976., f. 19-33. (*Glasnik*, XXXV/1972, Nr. 7-8, f. 309-317).
9. Husejn Xhozo, “Problemi i prapambeturisë së përgjithshme”, përktheu: Ismail Rexhepi, Nr. 67/2002., f. 151-162. (*Glasnik*, XXXIII/1970, Nr. 11-12, f. 543-551).
10. Husejn Xhozo, “Etika si element shumë i rëndësishëm i lumturisë dhe kënaqësisë së përgjithshme”, përktheu: Ismail Rexhepi, Nr. 73/2004., f. 33-42. (*Glasnik*, XII (XXIV) 1961, Nr. 7-9, f. 246-251).
11. Husejn Xhozo, “Njeriu - misioni dhe esenca e qenies së tij “, përktheu: Avni Aliu, Nr. 77/2005., f. 11-21. (*Glasnik*, XLII/1979, Nr. 2, f. 117-124).
12. Husejn Xhozo, “Kurani”, përktheu: Hajrullah Hoxha, Nr. 87/2008., f. 101-115.¹¹ (*Glasnik*, XXXV/1972, Nr. 7-8, f. 309-317).¹²

¹¹ Ramadan Shkodra, *Bibliografi e revistës “Edukata Islame” (1971-2016)*, Prishtinë, 2017.

¹² Është përkthyer edhe teksti “Mbi varrin e Muhamedit a.s.”, të cilin në shqip e ka përkthyer: Nexhat Ibrahimimi dhe e ka botuar në “Takvim” të Prishtinës në mesin e viteve 80 të shekullit të kaluar, dhe në: <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=49>. Teksti “Imani dhe Islami” është përkthyer edhe në shqip nga: Shpend Hulaj, dhe është publikuar në: <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=965>.

Ndikimi i fetvave të Husein ef. Gjozos në shoqërinë kosovare

Sipas Husein ef. Gjozos, mendimi islam duhej të studiohej vazhdimisht, dhe bazuar në burimet e tij të vetme, Kuranin dhe Synetin. Asnjë nga interpretimet e tij nuk duhet marrë si përfundimtar për të gjitha kohërat dhe si fjalë përfundimtare, siç ndodhi fatkeqësisht. Interpretimin e tij të mëparshëm, të pasqyruar përmes tefsireve, fikhut apo ndonjë disipline tjetër shkencore islame, ne e pranuar si përfundimtar dhe u sillem në atë rreth deri më sot, duke u munduar ta zvogëlojmë dhe kornizojmë jetën tonë brenda kufijve të vendosur nga Ebu Hanifja, Imam Shafiu, Maliku dhe Ahmed ibën Hanbeli. Nëse sot ne po përpiqemi të dalim nga ky rreth vicioz, duke dashur t'i japim mendimit islam një interpretim të ri, më modern, ne besojmë se kemi çdo të drejtë për ta bërë këtë dhe se askush nuk mund ta kundërshtojë atë, sepse kështu po e kryejmë një amanet të shenjtë ndaj Islamit në Bashkësinë Fetare Islame.¹³

Në bazë të asaj që u tha, duhet kuptuar se Husein ef. Gjozo, ndoqi mendimet e shkollës reformuese në Egjipt, të Afganiut, Abduhusë, Ridasë. Për shembull, Abduhu ishte i mendimit se Kurani i është zbritur mbarë racës njerëzore dhe se çdo brez është i detyruar, sipas mundësive të tij, ta interpretojë Kuranin në frymën e kohës dhe nevojave të tij, dhe se myslimanët duhet t'i qasen përsëri leximit të Kuranit, për ta lexuar atë jashtë kanuneve ekzegjetike të vendosura nga

¹³ Husein Đozo, *Prijevod Kur'ana s komentarom – Prvi džuz*, „Umjesto predgovora“, PLI në SFRJ, Sarajevë, 1966.

shkollat juridike të themeluara prej kohësh dhe medhhebet e themeluara prej tyre.¹⁴

Gjatë leximit të literaturës për Husein ef. Gjozon, në “*Veprat e tij të zgjedhura*” të botuara nga El Kalem dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë, në librin e katërt dhe të pestë gjetëm 49 përgjigje (fetva) për pyetjet e bëra nga lexuesit nga mbarë Kosova.

Në *Librin e katërt* (Fetvatë I)¹⁵ janë 30 fetva, në faqet: 57-62, 80-86, 122-124, 186 dhe 291.

Në faqen 57, Mehmed Zhinipotoku nga fshati Krushevc, afër Prishtinës - Kosovë, parashtron pyetjen se: *A e njeh Islami skllavërinë?* Husein ef. Gjozo, u përgjigj se një nga qëllimet themelore dhe kryesore të mësimëve islame është çlirimi i njeriut nga të gjitha llojet e skllavërisë dhe shfrytëzimit dhe lufta për mobilizimin dhe aktivizimin e plotë të të gjitha forcave në drejtim të luftës për liri dhe dinjitet njerëzor.

Në vijim, i njëjti lexues parashtron pyetjen: *Cili është qëndrimi i Islamit ndaj shkrimit të hajmalive, talismanëve dhe tregimit të fatit?* Husein ef. Gjozo, u përgjigj se Islami e ndalon rreptësishtë magjinë dhe shkrimin e hajmalive e talismanëve, dhe çrrënjësja e besëtytnive, e cila sigurisht përfshin shkrimin e hajmalive dhe magjinë, është një proces kompleks dhe i gjatë, i cili nuk mund të shfuqizohet vetëm me dekret, dhe se shkenca është arma më efektive në këtë ballafaqim.

¹⁴ Enes Karić, *Muhammed 'Abduhu – život i komentatorski prinosi*, op. cit., f. 14-15.

¹⁵ Husein Đozo, *Izabrana djela (Knjiga Četvrta -Fetve I)*, El Kalem dhe FIN, Sarajevë, 2006.

Në vazhdim i njëjti lexues parashtron edhe këto pyetje: *Kush është Dexhalli dhe ku është tani?; Çka është Dabbetul-erd? dhe A lejohet leximi i Kuranit në duet?*

Në faqen 80, I.R. në fjalë, nga Kaçaniku-Kosovë, parashtron pyetjen: *Në zonën e Kosovës dhe Metohisë ekziston zakoni i shitblerjes së grave, ku gratë shiten për një milion e më shumë dinarë të vjetër; dhe ekziston edhe një zakon i shkëmbimit, kur vajza ose motra jepen për grua përmes shkëmbimit, si e sheh Islami këtë? Gjozo përgjigjet se shitja dhe shkëmbimi i grave është një nga zakonet shumë të dëmshme dhe të shëmtuara të rënduara nga disa komunitete të prapambetura në disa nga rajonet tona.*

Në faqet 80-86, Ahmed A. Cej, nga fshati Stanoc i Posh-tëm, afër Vushtrrisë - Kosovë, parashtron 16 pyetje, nga të cilat do të veçojmë: *A lejohet aborti, parandalimi i ngjizjes, kontracepsioni, etj.? Dy vëllezër jetojnë në një familje dhe janë të pasur, të dy janë të detyruar të prenë kurban apo vetëm njëri? A mund të falet namazi i nafiles bashkërisht (me xhemat) sidomos gjatë Ramazanit? A lejohet leximi i Kuranit i shtrirë? Sipas rregullave islame, a lejohet të mbahet zi për të vdekurin në formë të veshjes së zezë, të bëhet gosti pas shtatë e dyzet ditësh, gjashtë muajsh dhe një viti? Vizita e varrit të Sulltan Muratit në Kosovë për festën e Shën Gjergjit dhe t'i kërkosht ndihmë? etj..*

Me këtë rast do të përmendim përgjigjet e shkurtra të Hussein ef. Gjozos për dy pyetjet e fundit. Sa i përket pyetjes së parafundit, Gjozo përgjigjet: Islami rekomandon që familjes së të ndjerit t'i shprehen ngushëllimet brenda tri ditëve, dhe në momentin e vdekjes dhe riteve të varrimit dhe më vonë, nuk lejohen zijafteti dhe konsiderohet bidat, si dhe çdo lloj

zifajeti gjatë të shtatëve, dyzetave, gjashtë muajve dhe përvjetorëve dhe nuk rekomandohet të vishen tesha të zeza në shenjë zie. Ndërsa, sa i përket pyetjes së fundit, Gjozo është përgjigjur se vizita e varrit të Sulltan Muratit në Kosovë në mënyrën e përmendur është mëkat i rëndë. Islami e ndalon rreptësishtë vizitën e tyrbes në kuptimin e kërkimit të ndihmës nga të vdekurit.

Në faqet 122-124, Hajdin Kelmendi nga Bardhi afër Prishtinës parashtron këto pyetje: *A mund të shkojë myslimani në haxh në Mekë me paratë që ka fituar në bixhoz? A mund të bëhet haxhi me para të huazuara? Ndodh që eprori në punë të shajë Zotin, a vuaj ndonjë pasojë unë si mysliman që e dëgjoj? Ndodh në shkolla, apo në punë, që individët të përpiqen të detyrojnë ata që agjërojnë të prishin agjërimin? Si e sheh Islami artin?*

Në faqen 186, nxënësit e Medresesë në Prishtinë parashtruan pyetjen: *Para Bajramit u mbajt një konferencë në Këshillin e BFI-së në vendin M. Në konferencë morën pjesë rreth 80 imamë, në takim u fol edhe për shkrimin në "Glasnik" për mbajtjen e beretës dhe adhurimin me beretë në kokë, dhe thuhej se është "kufër" dhe se "Glasniku" dezinformon besimtarët?*

Në përgjigje të kësaj pyetjeje, Gjozo thotë se çështja e beretës, tregtia me leximin e Kuranit të vdekurve, devr e tal-kin, dhe çështje të tjera konkrete, ku ky konflikt del në pah, janë vetëm çështje të trashëgimisë së epokës së dekadencës dhe se forcat progresive islame duhet të angazhohen më fort dhe të përfshihen në ato procese. Në territorin e Kosovës ka shumë probleme më të mëdha dhe më të rëndësishme me të cilat duhet të merret ilmijja vendore dhe të kërkohet zgjidhjen

e tyre, si: gjakmarrja; shitblerja e grave; emigracioni; prapambetja kulturore; edukimi i fëmijëve femra; problemi i personelit fetar dhe literaturës; besëtytnia etj..

Në *Librin e Pestë* (Fetvatë II)¹⁶, janë gjithsej 19 fetva, në faqet 52, 76-80, 126-129, 143-145, 163-165, 168-170, 201-202, 432-433.

Në faqen e 52, Hasan Vuçitërna nga Rahoveci - Kosovë, bën një pyetje lidhur me masat gjatë shfaqjes së pandemisë së lisë dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe faljen e xhumasë në rrethana të tilla? Husein ef. Gjozo, jep përgjigjen se në rrethana të tilla, myslimanët janë të detyruar të respektojnë urdhrat dhe masat e marra nga autoritetet sanitare, kështu që ata nuk janë të detyruar të falnin namazin e xhumasë, sepse kjo do të ekspozohej ndaj infeksionit dhe do të mundësonte përhapjen e sëmundjeje së rrezikshme, sepse vetë Muhamedi a.s., në rastet e epidemive e ndalonte rreptësishtë largimin nga zonat e rrezikuara.

Në faqen 76, Beqir Vejselović nga Peja - Kosovë, parashtron 5 pyetje, prej të cilave do t'i përmendim vetëm 2. Pyetja e parë ka të bëjë me leximin e Kuranit për para, sepse në "*Glasnik PLI*" theksohet se është e ndaluar, ndërsa medreseja e Gazi Husrev Beut në Sarajevë dhe Medreseja "Alaudin" në Prishtinë veprojnë në kundërshtim me këtë qëndrim? Në pyetjen e parashtruar, Gjozo u përgjigj se kishte përmendur shumë herë qëndrimin e Islamit ndaj leximit të Kuranit të vdekurve për para, dhe se është e ndaluar, dhe ndryshimi i emrit dhe shndërrimi i pagave në hedije (dhuratë) është histo-

¹⁶ Husein Dozo, *Izabrana djela (Knjiga Peta -Fetve II)*, El Kalem dhe FIN, Sarajevë, 2006.

ria më e zakonshme, *hilei-sherija*, dhe spekulime të papranueshme. Rekomandohet që në vend të hatmeve dhe teuhidit, të dërgohen kontribute në Medrese me kusht që sevapi i atyre kontributeve të shkojë për shpirtin e të ndjerit, edhe në këtë e forcojmë dhe është në përputhje me mësimet e Islamit.

Pyetja e dytë ka të bëjë me dhënien e *sadekatul-fitrit* dhe *zekatit* dhe *fetvasë* së Pleqësisë së Lartë Islame në Sarajevë, që e gjithë kjo t'i jepet Fondit të Medresesë dhe hapjes së Fakultetit Islam në Sarajevë? Në përgjigjen e tij, Gjozo thekson se *Pleqësia e Lartë Islame në Sarajevë*, si *ulu-l emër e Bashkësisë Islame në Jugosllavi*, ka nxjerrë një fetva plotësisht legjitime dhe se të gjithë zyrtarët dhe organet e Bashkësisë Islame janë të obliguar t'ua shpjegojnë këtë fetva myslimanëve dhe ta zbatojnë në mënyrë rigorozë në praktikë.

Në faqen 126, lexuesi i rregullt i "*Glasnikut*" dhe "*Preporodit*" P.P. nga Rahoveci - Kosovë, i kërkon Gjozos të shkruajë për lëvizjen e Ahmedive (Kadijanive)? Gjozo shkruan shkurtimisht për këtë lëvizje, ide, mësim dhe ndikim negativ e rrezik në mbarë botën islame.

I njëjti lexues shkruan si në vijim: *Në numrin e fundit të "Glasnikut" iu përgjigjët pyetjes së një lexuesi për faljen e 10 rekateve pas xhumasë, unë e bëj kështu, megjithatë, ulemaja këtu ende punojnë sipas të vjetrës dhe nuk e pranojnë shpjegim, madje thonë: "A deri më tani, kaq shumë teologë dhe ulematë nuk e dinin se të gjithë myslimanët në botë e bëjnë këtë, nga doli që ai (duke iu referuar juve) të jetë më i mençuri." Këtu në Kosovë, disa, të cilët e konsiderojnë veten ulema të ditur, mendoni se ndonjëherë ju e "teproni" në disa qëndrime. Çfarë mendoni për këtë?*

Gjozo shkruan se e kupton rezistencën dhe pranimin e ngadaltë të korigjimit të gabimeve dhe mbijetesës së mirë-kuptimeve, por që kjo nuk duhet dramatizuar, nuk mund të ndryshohet brenda natës, sepse këto gabime dhe keqkuptime janë mbështetur dhe miratuar në heshtje prej shekujsh. Ne kemi deklaruar qëndrimin e saktë islam, se askund në botën arabe nuk i falin këto 10 rekate dhe se me përfundimin e far-zit të xhumasë, imamët e përfundojnë namazin e xhumasë.

Personaliteti dhe reformat e Husein ef. Gjozos dhe reflektimet në shoqërinë kosovare

Husein ef. Gjozo ishte reformist dhe modernist, por shpeshherë e përmendi Imam Gazaliun dhe mendimet e tij përmes veprës së tij *Ihja ulumid-din*, të cilën, siç thotë prof. Nexhat Ibrahim, Gjozo e kishte gjithmonë mbi tavolinën e tij.¹⁷ Ai ishte jo vetëm teoricien, por edhe praktikant dhe në asnjë rast nuk ua imponoi mendimet e tij studentëve në Fakultetin Teologjik Islam në Sarajevë.

Me kundërshtimin dhe kërkesën e Nexhat Ibrahimit, Senaid Bistriq, atëherë kryeredaktor i "*Preporodit*", u dha dy faqe të mesme të revistës bashkëpunëtorëve në gjuhën shqipe që t'i botonin punimet e tyre në gjuhën boshnjake dhe shqipe. Punimet u botuan për rreth një vit, sepse lufta në Bosnje dhe Hercegovinë e bëri të veten.

¹⁷ Patëm një intervistë me profesor Nexhat Ibrahimin më 04.11.2022, me rastin e shkrimit të këtij punimi.

Sipas Ibrahimit, ka pasur premtime dhe vullnet të shprehur, madje është marrë vendim nga Rijaseti që të iniciohet “Glasniku” në gjuhën shqipe, në të cilin do të trajtohen punimet e përbashkëta dhe ato specifike të fushës dhe që do të redaktohet nga prof. Nexhat Ibrahim, dr. Ismail Ahmedi dhe Bahri Aliu. Megjithatë, kjo ide nuk u zbatua kurrë në praktikë edhe për shkak të luftërave në Ballkan.

Në kohën kur në krye të Rijasetit të Bashkësisë islame në ish-Jugosllavi ishte reisi Jakub Selimovski, u mor vendimi që të përcaktohen shumat për *sadekatul-fitrin* dhe *zekatin* në tërë Rijasetin dhe këtë iniciativë e ka marrë Husein ef. Gjozo. Në fillim, kjo iniciativë u ndesh me rezistencë nga vetë punonjësit (imamët) në Rijaset, mirëpo, kjo pengesë më vonë u hoq dhe kjo iniciativë e Husein ef. Gjozos u pranua për aplikim edhe sot e kësaj dite Bashkësitë Islame të ish-Jugosllavisë e praktikojnë.

Sipas Ibrahimit, përcaktimi i sasisë së *sadekatul fitrit* dhe *zekatit* ka qenë i lartë dhe i ulët, të gjitha në bazë të standardeve në Bosnje e Hercegovinë dhe Kroaci, kurse rrethanat në të cilat ka jetuar shoqëria kosovare nuk janë marrë parasysh, e që kjo e fundit jetonte në standard më të ulët, në krahasim me vendet e përmendura.

Nga iniciativat e veçanta të Husein ef. Gjozos, është edhe tubimi i kurbaneve të organizuara nga Bashkësitë Islame, për nevojat e institucioneve islame brenda Bashkësisë Islame. Kjo iniciativë zbatohet edhe sot, bashkë me mbledhjen e lëkurës së kurbanit.

Roli i Husein ef. Gjozos, të cilin e kishte referent fetar dhe arsimor në Pleqësinë e Lartë Islame në RSFJ, pasqyrohet në dinamizmin e punës fetare e arsimore të mbarë Bashkësisë

Islame në Jugosllavi, si te boshnjakët ashtu edhe te shqiptarët. Mund të thuhet se në dyzet vitet e fundit pas vdekjes së tij, Bashkësia Islame ka ndjekur në masë të madhe projektet dhe idetë arsimore dhe reformuese të avokuara nga profesori, Husein ef. Gjozo.¹⁸

Sipas Ibrahimit, në Këshillin e Bashkësisë Islame në Prizren ishin të regjistruar rreth 350 abonentë për “*Preporod*” (nga të cilët 80% shqiptarë dhe 20% boshnjakë), 150 abonentë për “*Islamska misao*” dhe 150 abonentë për “*Takvim*”. Këto revista (dhe literatura tjetër islame e shtypur në Sarajevë) rregullisht vinin në Këshillin e Bashkësisë Islame në Prizren, prej nga u shpërndaheshin abonentëve të tyre me postë deri në vitin 1992. Pas luftës në Kosovë, këto revista vinin përmes shtëpisë botuese “El Kelimeh” nga Novi Pazari, por me një vonesë të gjatë, deri në vitin 2008, kur Nexhat Ibrahim i kaloi për të punuar si profesor i Filozofisë islame dhe Akaidit në Medresenë “Alauddin” në Prizren.

Nga teksti i Gjozos “Vëzhgime nga rruga nëpër Sanxhak, Kosmet dhe Maqedoni”, i cili është botuar në “*Glasnik*”, shihet se ai ka vizituar edhe Kosovën (Kosmetin) në periudhën prej 12 qershor deri më 13 korrik 1967, kështu që do të përmendim këtu vetëm disa detaje nga kjo vizitë Kosovës.

Para së gjithash, ai vuri në dukje se myslimanët në rajonet e përmendura, meritojnë kujdes të veçantë nga autoriteti i Bashkësisë Islame, sepse ata kanë jetuar në rrethana të ndryshme historike. Nuk duhet harruar se ata ishin nën sundimin Osman deri në vitin 1912 dhe gjatë Jugosllavisë së vjetër më së shumti aplikohej diskriminimi, i cili shumë shpesh merrte

¹⁸ Husein Dozo, *Eseji na arapskom*, op. cit., f. 11.

formën e gjenocidit. Ishte e qartë se, siç thotë Gjozo, politika hegjemoniste e asaj kohe, e frymëzuar nga shovinizmi ekstrem serbomadh, kishte për qëllim likuidimin e plotë të popullsisë myslimane të kombësisë “turke” dhe “shqiptare”.¹⁹

Nga teksti i përmendur kuptohet se në vitin 1933, reisu-l-ulemaja i atëhershëm, haxhi hafëz Ibrahim ef. Maglajliq, gjatë vizitës së tij në Sanxhak, Kosovë dhe Maqedoni, duke parë situatën e përgjithshme dhe pozitën e pa të drejtë të myslimanëve në ato rajone, ishte aq i emocionuar dhe indinjuar, saqë duke mos pritur të kthehej, ndërsa ishte ende rrugës, dha dorëheqjen si një shenjë proteste ndaj pozitës së reisu-l-ulemasë dhe kërcënoi se nuk do të tërhiqej derisa të korrigojohen padrejtësitë atje.²⁰

Kur Gjozo e vizitoi Prizrenin, atij iu drejtuan imamët e Këshillit të Prizrenit, të cilët i treguan për gjendjen e popullit dhe të Bashkësisë islame me autoritetet shtetërore, të cilët po konfiskonin pasurinë e vakëfit, duke i kërkuar Gjozës që të ndërhynte në një nivel më të lartë të qeverisjes, në mënyrë që qeveria t'ua kthejë atë pasuri të vakëfit. Husein ef. Gjozo (duke e ditur se kjo është e pamundur) iu drejtua me fjalë me përqeshje: “Nëse keni nevojë për Islam, jepni vakëfe dhe nëse keni nevojë për xhami, ndërtoni ato...”.

Dikush mund të pyesë pse Husein ef. Gjozo u përgjigj në këtë mënyrë? Nëse mendojmë më thellë, Gjozo ishte një vizionar dhe e njihnte shumë mirë situatën në shoqëri dhe në një

¹⁹ Husein Dozo, “Zapažanja sa puta po Sandžaku, Kosmetu i Makedoniji“, *Izabrana djela - Knjiga 4 (Publicistički radovi)*, El Kalem dhe FIN, Sarajevë, 2006, f. 210.

²⁰ Po aty, f. 211.

nivel më të lartë të qeverisjes, duke ditur se njerëzit mendonin se Bashkësia Islame kishte para dhe pasuri të mjaftueshme dhe se nuk kishte nevojë për paratë e njerëzve, pagesa e anëtarësimit, dhënia e *zekatit*, *sadekatul-fitrave*, *kurbaneve*, etj.. Kur njerëzit ta kuptojnë se Bashkësia Islame ka nevojë për ndihmë materiale, atëherë ata vetë do të luftojnë me realitetin dhe do të qëndrojnë pranë Bashkësisë Islame, duke e përkrahur materialisht dhe në çfarëdo mënyre tjetër, duke përfshirë ndërtimin e xhamive, medreseve dhe objekteve të tjera fetare.

Sipas Gjozos, edhe pse gjatë vizitës së tij në këto rajone gjendja ishte shumë më e mirë në fushën fetare sesa në kohën kur reisul-ulemaja Maglajliq i sipërpërmendur i vizitoi këto rajone, historia me siguri do t'i shkruajë në mëkat të pafalshëm përfaqësuesve politikë dhe fetarë për mos angazhim për zgjidhjen e problemeve të tyre.²¹

Konkluzione

Nga gjithçka e përmendur në punim, mund të nxjerrim konkluzione të mëposhtme:

- Se Husein ef. Gjozo ishte një nga personalitetet fetare më të njohura në Ballkan;
- Se investoi shumë përpjekje në fushën e ndërgjegjësimit fetar të njerëzve, përmes një rikthimi Kuranit dhe mësimave të tij;
- Se me punën e tij të palodhur arriti të bëjë reforma të rëndësishme në fushën e arsimit, të forcojë rolin e Me-

²¹ Po aty, f. 216.

dresesë dhe të themelojë Fakultetin e Teologjisë Islame në Sarajevë;

- Se ka pasur ndikim të madh me fetvatë e tij për Ballkanin në përgjithësi dhe në shoqërinë kosovare në veçanti;
- Se shtypi islam, “Glasnik”, “Islamska misao”, “Preporod” dhe literatura tjetër islame e shtypur në Sarajevë pritej dhe lexohej me kënaqësi në Kosovë;
- Se punimet e Husein ef. Gjozos u përkthyen edhe në gjuhën shqipe dhe u botuan në shtypin islam në Kosovë, veçanërisht në revistën islame “*Edukata Islame*”;
- Se reformat që Husein ef. Gjozo i inicio në kuadër të Rijasetit të Bashkësisë Islame me seli në Sarajevë u aplikuan edhe në Bashkësinë Islame në Kosovë dhe disa aplikohen ende.

Dr. Besir NEZIRI

JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE E MEHMET AKIF ERSOJIT

Hyrje

Me pranimin e Islamit dhe me hyrjen në administrimin e Perandorisë Osmane, populli shqiptar, bëri një kthesë të madhe në çdo aspekt të jetës. Kjo ngase osmanët, në trojet shqiptare, sollën një sistem të ri shoqëror, kulturor e mbi të gjitha sollën fenë islame. Shqiptarët gjatë kësaj periudhe u integruan lehtë në Perandorinë Osmane dhe dhanë kontribut të pazëvendësueshëm në kulturën dhe qytetërimin osman. Thënë më ndryshe, shqiptarët luajtën një rol të rëndësishëm në çdo sferë të jetës në periudhën osmane, si në administrim, në jetën fetare, arsim, kulturë, art, por edhe në fushën e letërsisë, ku kemi një numër të madh të poetëve shqiptarë, që dhanë një kontribut të veçantë në letërsinë turke-osmane, siç janë: Prishtineli Mesihu, Suzi Prizreni, Jahja Beu nga Tashlixha, Dugagjinzade Ahmed Beu, etj.. Njëri ndër poetët e letërsisë turke me origjinë shqiptare është edhe Mehmet Akif Ersoji.

Mehmet Akif Ersoji është një ndër personalitet më të njohura të letërsisë turke, i cili me poezitë dhe shkrimet e tij, e veçanërisht me Marshin Kombëtar të Republikës së Turqisë, ka fituar zemrat jo vetëm të turqve, por të gjithë ymetit myslimanë në botën islame.

Mehmet Akifi me poezinë e tij, intelektualizmin, qasjen ndaj ngjarjeve shoqërore dhe politike, mbrojtjen e atdheut dhe kombit dhe mendimet e tij të thella për letërsinë dhe artin, është një nga poetët kryesor të letërsisë turke. Dashuria për kombin dhe atdheun, heroizmi, pavarësia, vetëdija e ymetit, ndërgjegjja islame, idetë e qytetërimit islam, janë vetëm disa nga faktorët që ndikuan në formimin e personalitetit të tij.

Jeta e Mehmet Akifit

Mehmet Akif Ersoji lindi në dhjetor të vitin 1873 në Stamboll, në lagjen Sarıgüzel të komunës Fatih. Babai i tij është shqiptari Mehmet Tahit Efendiu nga fshati Shushicë i Pejës, i cili e kreu shkollimin në medresenë në Stamboll dhe u bë një nga dijetarët e kohës, si dhe myderriz i medresesë Fatih. Ndërsa nëna e tij ishte Emine Sherife Hanëm, e cila vinte nga një familje nga Buhara, që ishin vendosur në qytetin Tokat të Turqisë.

Mehmet Akifi, mësimet e para filloi t'i merrte në mejtepin e lagjes Emir Buhari, ku vazhdoi për dy vjet, dhe më pas, në vitin 1879, u regjistrua në mejtepin Iptidaije (fillore) pranë Muvakkithanes Fatih. Po në këtë vit, filloi të mësonte edhe arabishten nga babai i tij, Mehmet Tahir Efendiu. Pas përfundimit të shkollës fillore trevjeçare, në vitin 1882, filloi shkollën e mesme të ultë në mejtepin qendror Rushtije në Fatih. Gjatë kësaj kohe, ai vazhdonte të mësonte arabishten nga babai i tij dhe njëkohësisht ndiqte mësimet e persishtes në xhaminë "Fatih" ku shpjegohej "Mesnevia" dhe "Gjylistani". Ai gjithashtu ishte shumë i shkathët edhe në mësimet e gju-

hës turke dhe franceze.¹ Më 1885, regjistrohet në shkollën e mesme në mejtepin Mylkije (civile). Pasi përfundoi ciklin e ultë tre vjeçar të këtij mejtepit, ai menjëherë filloi në ciklin e lartë. Por, me vdekjen e babait të tij dhe një vit më vonë me djegien e shtëpisë së tij nga zjarri i madh që kishte kapluar lagjen Fatih, familja e tij mbeti në një gjendje të dobët ekonomike. Por, falë ndihmës së nxënësit të babait të tij, Mehmet Akif, e ndërtoi një shtëpi të vogël në të njëjtin oborr.

Në atë kohë, për Mehmet Akif Ersojin ishte e nevojshme të kishte një punë dhe t'i vazhdonte mësimet në një shkollë me konvikt. Për këtë arsye, ai u detyrua që ta ndërpres mësimin në mejtepin Mylkije dhe të regjistrohet në Shkollën e Bujqësisë dhe Veterinarisë, e cila ishte shkolla e parë civile veterinare e porsahapur në ato vite. Qëllimi i regjistrimit në këtë shkollë ishte që të gjente punë menjëherë pas diplomimit në këtë shkollë katër vjeçare.² Gjatë këtyre viteve ai kishte interes të madh edhe për sportin, ku mësoi sportin e mundjes nga shoku i tij, Kajëxhë Osman Pehlivan dhe mori pjesë në garat për ecje të gjatë, vrapim dhe hedhje të gjyleve. Ndërsa në dy vitet e fundit në këtë shkollë u fokusua më shumë në poezi.³

Menjëherë pas përfundimit me sukses të lartë të shkollës së Bujqësisë dhe Veterinarisë, ai u emërua ndihmës inspektor në Ministrinë e Bujqësisë. Për katër vjet sa ishte në këtë po-

¹ M. Ertuğrul Düzdağ, *Mehmed Akif Ersoy*, 2. Baskı, T.C. Kültür Bakanlığı Yayınları, Ankara 1997, fq. 6.

² Po aty, fq. 8.

³ Celal Gülşen, "Mehmed Akif Ersoy'un Eğitim Anlayışı", *Neë Era International Journal Of Interdisciplinary Social Researches*, 2021, fq. 24.

zitë, Mehmet Akifi udhëtoi shumë në Rumeli, Anadoll, në tokat shqiptare dhe Arabi për të kryer kërkime mbi sëmundjet e kafshëve. Në këtë mënyrë ai u njoh nga afër me njerëzit dhe me problemet e tyre. Falë kësaj njohjeje dhe vëzhgimit nga afër, Mehmet Akifi, pothuajse në çdo poezi të tij në “Safahat”, paraqiti gjendjen e njerëzve dhe fshatarëve me përshkrime reale. Gjatë kësaj periudhe ai përmirësoi edhe gjuhën franceze, memorizoi Kuranin brenda 6 muajve dhe filloi të botonte poezi dhe gazele në revistat si “Hazine-i”, “Funun” dhe “Mektep”. Në vitin 1898 u martua dhe nga kjo martesë kishte pesë fëmijë.⁴

Mehmet Akif Ersoji, dashurinë dhe interesimin për letërsinë e vazhdoi duke shkruar poezi dhe kryer profesionin e mësuesit të letërsisë. Botoi shkrime dhe poezi në gazeta dhe revista të ndryshme. Në vitin 1906, emërohet mësues i turqishtes në mejtepin “Ziraat”, ndërsa në vitin 1908, emërohet profesor i letërsisë osmane në degën e Letërsisë në Darulfunun (sot Universitetin e Stambollit).⁵

Më 27 gusht 1908, Mehmet Akif, filloi të botoi në revistën “Siratimystakim”, në të cilën më vonë emërohet si kryeredaktor. Pasi që emërohet kryeredaktor, të gjitha poezitë dhe shkrimet e tij i botoi në këtë revistë. Poezitë e Mehmet Akifit të botuara në revistë “Siratimustekim” në vitin 1911 botohen një libër me emrin “Safahat”. Nga 8 marsi 1912, revista

⁴ Po aty.

⁵ Osman Cebeci, *Mehmet Akif Ersoy'un İslamcılıkla İlişkisi (1873-1936)*, Erciyes Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yayınlanmamış yüksek lisans tezi, Kayseri 2019, fq. 80.

ndryshoi emrin dhe vazhdoi të botohej me emrin “Sebilurreshad”.

Me fillimin e Luftës Ballkanike, Mehmet Akifi, nga data 11 maj 1913, filloi të mbajë vaze/predikimet në xhaminë “Bejazit”, “Fatih” dhe “Sulejmanije”. Të gjitha këto ligjërata janë botuar në revistën “Sebilurreshad”.

Në muajt e parë të vitit 1919, veçanërisht pas pushtimit të Izmirit nga grekët, filloi rezistenca e parë kundër forcave greke në Anadollin Perëndimor, e cila shënoi edhe fillimin e Luftës Kombëtare në pjesën e Anadollit. Mehmet Akifi gjatë Luftës Kombëtare vizitoi shumë qytete të Anadollit për të inkurajuar popullin me ligjërata nëpër xhami, hytbe dhe she-she, si dhe i inkurajonte ata me deklarata nëpër gazeta që të luftonin për këtë kauzë për ta mbështetur Luftën Kombëtare. Predikimet apo vazet që mbante nëpër xhamia u shtypën dhe u shpërndanë në të gjitha cepat dhe frontet në Anadoll për t’u dhënë mbështetje morale popullatës në Luftën Kombëtare.⁶ Veç kësaj, Mehmet Akifi, kontribuoi edhe me poezitë e tij. Prandaj, populli, Mehmet Akifin, e shpalli “hero shpirtëror” i Luftës Kombëtare.⁷

Në vitin 1920, Mehmet Akif, zgjidhet deputet i qytetit Burdur në Asamblenë e Parë Kombëtare në Ankara, ku edhe nga këtu vazhdoi të inkurajonte njerëzit të luftonin për Luftën Kombëtare.

⁶ M. Ertuğrul Düzdağ, *Mehmed Âkif Ersoy*, Kapı Yayınları, İstanbul 2013, fq. 113.

⁷ Hikmet Özdemir, “Mehmet Âkif’in Sanatı ve Fikriyatı”, *Vefatının 75. Yılında Uluslararası Mehmet Âkif Ersoy Sempozyumu Bildiriler Kitabı*, (Haz.: Vahdettin Işık), Zeytinburnu Belediyesi Yayınları, İstanbul 2011, fq. 33

Në fundit të vitit 1920, me kërkesë të Shtabit të Përgjithshëm (Erkan-ı Harbiye), Ministria e Arsimit, organizoi një konkurs për shkrimin e një himni kombëtar. Në këtë konkurs u paraqitën shumë poezi, por asnjë poezi nuk zgjonte ndjenjën dhe dashurinë për atdhe e komb. Më pas, ministri i Arsimit, Hamdullah Suphi, i bëri një kërkesë të veçantë Mehmet Akifi për të marrë pjesë në këtë konkurs. Por Mehmet Akifi e refuzoi këtë kërkesë, duke thënë se nuk mund të shkruaj poezi për para. Në fund, kur iu premtua Mehmet Akifit se nuk do të paguhej kur të fitonte konkursin, ai pranoi të shkruante poezinë për himni kombëtar.⁸ Mehmet Akifi e shkroi poezinë për himnin kombëtar në teqenë “Taxheddin” në Ankara dhe kjo poezi, më 1 mars 1921, iu lexua deputetëve në parlament nga Hamdullah Suphi. Ndërsa në mbledhjen e Kuvendit, më 12 mars 1921, u pranua zyrtarisht si tekst i himnit kombëtar.⁹

Më vonë, me ftesë të princit egjiptian, Abbas Halim Pasha, ai shkoi në Egjipt dhe në vitin 1926, u emërua profesor i turqishtes në Fakultetin e Letërsisë në Universitetin e Egjiptit në Kajro. Në vitin 1925, Mehmet Akifi, filloi të punonte në përkthimin dhe interpretimin e Kuranit, të cilin e kishte porositur Kryesia për Çështje Fetare e Turqisë. Në vitin 1931, e përfundoi përkthimin e Kuranit, por nga frika se ky përkthim do të përdorej në vend të origjinalit të Kuranit, refuzoi ta do-

⁸ Ayşe Türk, *Cumhuriyet Dönemi Türk Edebiyatında Mehmed Âkif'e Dair Yazılmış Eserlerdeki Değerlendirmeler*, Fatih Sultan Mehmet Vakıf Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Yayınlanmamış yüksek lisans tezi, İstanbul 2018, fq.7.

⁹ Po aty.

rëzonte përkthimin, gjë për të cilën e kishte njoftuar zyrtarisht Ankaranë zyrtare.¹⁰

Teksa ishte në Egjipt, ai diagnostikohet me sëmundjen e cirrozës.¹¹ Pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, ai kthehet në Stamboll për t'u mjekuar, por për fat të keq, sëmundja e mundi, dhe më 27 dhjetor 1936 ndërroi jetë. Ai u varros në varrezat Edirnekapi me një pjesëmarrje të madhe të studentëve dhe popullit.¹²

Personaliteti

Në formimin e personalitetit të Mehmet Akifit rol të rëndësishëm kanë luajtur tre faktorë:

1. Një shtëpi me Kuran;
2. Sporti; dhe
3. Shkolla e shkencave pozitive.

Institucioni i parë që ndikon drejtpërdrejt në formimin e personalitetit të njeriut është familja. Personat më të rëndësishëm dhe të parët që kanë qenë me ndikim në jetën e Mehmet Akifit janë padyshim nëna dhe babai i tij. Mehmet Akifi, edukatën e parë fetare, dashurinë dhe njohuritë për Kuranin, të cilin e mbrojti gjatë gjithë jetës së tij, e bëri filozofi të jetës, e pasqyroi në artin e tij dhe e bëri bazë të personalitetit të tij, i mori nga familja e tij, ku faleshin pesë kohët e namazit

¹⁰ Düzdağ, *po aty*, fq. 140.

¹¹ Mustafa Karabulut, "Mehmet Âkif Ersoy Hayatı, Şahsiyeti ve İstiklal Marşı", *12 Mart İstiklal Marşı'nın Kabûlünü ve Mehmet Akif Ersoy'u Anma Günü*" *Konulu Konferans (12 Mart 2012)*, fq.2.

¹² M. Orhan Okay, M. Ertuğrul Düzdağ, "Mehmed Âkif Ersoy", *TDV İslâm Ansiklopedisi*, c. 28, İstanbul 2003, fq. 435.

dhe lexohej Kurani kerim. Këtë e cek edhe vetë Mehmet Akifi, ku thotë: *“Edukimin tim të parë fetar e kam marrë nga mësimet në shtëpi, lagje, shkollë fillore dhe të mesme. Në mënyrë të veçantë, shtëpia (familja) ka luajtur rol të rëndësishëm në edukimin tim. Nëna ime ishte një grua shumë e devotshme dhe e kujdesshme për të mos rënë në mëkate; po ashtu edhe babai... Ata shijuan ekstazën, kënaqësinë dhe entuziazmin e adhurimit.”* Mehmet Akifi është rritur duke dëgjuar ajetet e Kuranit të recituara nga nëna e tij Emine Sherife Hanëm me zërin e saj të ëmbël dhe shpjegimet dhe mendimet e babait të tij, Tahir Efendiut. Pra kjo shtëpi apo familje, e lidhur fortë me Kuranin, ndikoi në formimin e personalitetit të Mehmet Akif Ersojit, i cili ishte i lidhur me Kuranin, e kishte mësuar përmendsh dhe më vonë e kishte përkthyer në gjuhën turke.¹³

Faktori i dytë që ndikoi në formimin e personalitetit të Mehmet Akif Ersojit është sporti. Sporti kishte vend të rëndësishëm në jetën dhe personalitetin e Mehmet Akifit, i cili ishte i interesuar nga afër për sportet si, mundja, noti, hedhja e gurëve dhe vrapimi. Por interesim të veçantë kishte për sportin e mundjes, ku kishte marrë pjesë në garat për mundje që organizoheshin në lagje, shkollë, madje edhe në fshatrat dhe qytetet përreth. Mehmet Akifi, sportin e mundjes nuk e konsideronte thjesht si një sport, por si një “virtutet i trupit”. Sipas tij, ata që merren me sportin e mundjes janë njerëz të pastër që nuk njohin alkoolin dhe prostitucionin. Sportet me të cilat merrej Mehmet Akifi, veçanërisht mundja, ia lehtë-

¹³ Recep Duymaz, *Mehmet Akif Ersoy'un Edirne Yılları*, T.C. Edirne Valiliği Yayınları, Edirne 2019, fq. 100-101.

suan atij të rritej si një person i fortë për nga trupi, i mirë për nga morali dhe vendimtar për sa i përket vullnetit.¹⁴

Faktori i tretë që ndikoi në formimin e personalitetit të Mehmet Akif Ersojit është Shkolla e shkencave pozitive. Gjatë shkollimit të mesëm të ultë, ndikim të madh në formimin e personalitetit të Mehmet Akifit, pati mësuesi i turqishes, Hoxha Kadri, i cili ishte nga personalitetet liridashëse në periudhën e Abdylhamitit. Këtë e thotë edhe vetë Mehmet Akifi: *“Ky person ka qenë shumë mbresëlënës për mua për sa i përket gjuhës...”*. Pas përfundimit të shkollës së mesme të ultë, nëna e tij, Emine Sherife Hanëm, dëshiroi që djali i saj t’i vazhdonte mësimet në medrese, ndërsa babai i tij, Tahir Efendiu, i cili ishte myderriz në medrese, e kundërshtoi duke thënë: *“Zonjë, unë do t’ia mësoj djalit tim në shtëpi atë që do të mësojë në medrese”* dhe ai e regjistroi të birin në mejtepin Mylkije (shkollë e shkencave pozitive). Për shkak të kushteve të rënda ekonomike, veçanërisht pas vdekjes së babait të tij, ai detyrohet të kalojë në shkollën e Bujqësisë dhe Veterinarisë me qëllim që të gjente punë më lehtë pas diplomimit.¹⁵

Mehmet Akifi, në këtë shkollë për herë të parë njoftohet me shkencat eksperimentale, nga të cilat mësoi t’i shikonte gjërat dhe ngjarjet me disiplinën e shkencës. Këtë disiplinë shkencore, Mehmet Akifi, e kishte mësuar nga profesori i tij,

¹⁴ Selçuk Özdağ, Savaş Duman, “Mehmet Akif Ersoy’un Sporcu Kişiliği, Sporun Akif’in Kişiliği ve Mısraları Üzerindeki Etkisi”, *Muğla Sıtkı Koçman Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi*, Sayı 29 (Güz 2012), fq. 131.

¹⁵ Duymaz, *po aty*, fq. 104.

Rifat Husamettin Pasha. Kjo dashuri dhe interesim i thellë për shkencat eksperimentale i dha Mehmet Akifit aftësinë për ta vëzhguar saktë realitetin dhe ta përshkruajë saktë atë në veprat e tij. Mësimi i vëzhgimit, njohurive dhe mendimit në shkollën e Bujqësisë dhe Veterinarisë, programi i së cilës bazohet kryesisht në shkencat eksperimentale, ia lehtësoi zhvillimin e personalitetit të tij ndaj përkushtimit për realitetin dhe e bëri atë një nga poetët kryesor realist në letërsinë turke.¹⁶

Personalitetin e Mehmet Akifit e kanë përshkruar edhe miqtë dhe shokët e ngushtë të tij. Sipas tyre, Mehmet Akifi, ishte një person besnik, me mendje të lirë, kundërshtar i madh i fanatizmit, tiranisë, injorancës dhe dëshpërimit, tolerant në çështje të fesë dhe jo tolerant ndaj padrejtësive, i vendosur, njeri i fjalës, që nuk i donte ligësitë dhe poshtërsitë, por e donte bujarinë dhe përlësinë, i dhënë pas kaligrafisë dhe muzikës dhe që i jepte rëndësi të ardhmes.¹⁷

Krijimtaria letrare

Mehmet Akifi është një personalitet shumë i njohur dhe i pëlqyer si në gjeografinë turke, ashtu edhe në atë islame. Mehmet Akifi është një poet që artin dhe krijimtarinë letrare të tij e ka vënë në dispozicion të shoqërisë. Ai, dhimbjet dhe vuajtjet e shoqërisë në kushtet sociale e politike të kohës së tij, i ndjeu thellë në shpirtin e tij dhe i shprehu si në krijimtarinë letrare të tij, ashtu edhe në të gjitha shkrimet e tjera.

¹⁶ Po aty, fq. 105.

¹⁷ Po aty, fq. 105.

Duke qenë i vetëdijshëm se kombi i tij po kalonte një periudhë të vështirë e depresive, Mehmet Akifi, në të gjitha poezitë dhe shkrimet e tij u fokusua në temat që do të jenë të dobishme në shpëtimin e kombit të tij dhe që do të ngjallin shpresë tek ata.

Në qendër të krijimtarisë letrare të Mehmet Akifit mbizotëronte koncepti “Kuran dhe jetë”. Shkrimtari dhe intelektuali i njohur turk, Nurettin Topçu, këtë aspekt të Mehmet Akifit, e përshkruan kështu: *“Muza e dashurisë dhe frymëzimit të Mehmet Akifit rrjedh nga Kurani. Thirrjet e shpirtit të tij janë të përziera me Kuran”*.¹⁸

Mehmet Akifi mbrojti idenë se letërsia duhet t'i shërbejë shoqërisë dhe të mbushë një boshllëk në shoqëri. Për këtë arsye, sipas tij, koncepti “arti është për art” është një koncept i gabuar. Arti fiton vlerë vetëm nëse është në shërbim të shoqërisë. Ndryshe, arti që nuk i sjell ndonjë përfitim shoqërisë, nuk konsiderohet art.¹⁹

Sipas Mehmet Akifit, një vepër letrare duhet t'i plotësojë tri kritere:

- Vepra letrare duhet të jetë në shërbim të shoqërisë. Duhet t'i tregojë shoqërisë të metat e saj dhe ta paralajmërojë atë. Duhet ta ngrit moralisht shoqërinë.
- Vepra letrare duhet të jetë vendore dhe kombëtare. Një vepër letrare duhet të përshkruajë jetën e kombit të cilit

¹⁸ Nurettin Topçu, *Mehmet Âkif*, 2. baskı, Dergâh Yayınları, İstanbul 1998, fq. 23.

¹⁹ Ahmet Yıldıztaş, Ayşe Dinç, “Mehmet Akif Ersoy’un Şahsiyeti, Sanatı Ve Eserleri (1873-1936)”, *Türk & İslam Dünyası Sosyal Araştırmalar Dergisi* 5 / 17, Haziran 2018, fq. 439.

i përket. Ajo duhet të përfitojë nga metodat dhe teknikat e letërsisë perëndimore, por përmbajtja e saj duhet të jetë vendore dhe kombëtare.

- Vepra letrare duhet të pasqyrojë realitetin. Poeti dhe shkrimtari duhet të shkruajë atë që sheh. Përshkrimi në veprën letrare duhet të jetë në përputhje me realitetin dhe natyrën.²⁰

